



DITURIA



Botim i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve
Published by Albanian-American Academy of Sciences and Arts

Nr. 16, Qershor - Shtator 2026 - Kryeredaktor Av. Halil Rama – Mjeshër i Madh



Personaliteti i Prof. Dr. Skënder Kodrës është i njohur në SHBA, në vende të ndryshme të Evropës dhe në të gjitha trojet shqiptare

Prof. dr. SKËNDER KODRA “NDERI” I KOMUNËS SË PEJËS



MESAZHET E
SHABAN GASHIT
SI TESTAMENT
ATDHEDASHURIE



KOLEGJI
UNIVERSITAR I
BIZNESIT - LIDER
NË ARSIMIN
PROFESIONAL



DR. SALI KURTI,
PORTRETI I
NJERIUT FISNIK



BUJANA MALAJ,
SHKRIMTARE,
HUMANISTE DHE
MISIONARE E
PAQES

Ndër të tjera në brendësi

- **DOMOSDOSHMERIA HISTORIKE E RIKTHIMIT TË TOPONIMIT “DARDANI”** - Nga Prof. dr. Eshref Ymeri
- **ADEM JASHARI, HEROI I LIRISË** - Nga Akademik Prof. dr. Flori Bruqi
- **KOSOVA NË NATO, KËSHTJELLË E INTERESAVE TË SHBA NË RAJON** - Nga Gjeneral ® Piro Ahmetaj
- **ING. IKBAL KURTI, GRUAJA QË NDËRTOI MATIN - DREJTUESE, BASHKËSHORTE E NËNË SHEMBULLORE**
- **JERONIM DE RADA: ARKITEKTI I RILINDJES SHPIRTËRORE SHQIPTARE** - Nga Alban Daci
- **TREGIME** - Nga Prof. dr. Fatmir Terziu dhe Sakip Cami
- **TRIPTIK** - Poezi nga Emmy Krosi
- **ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS** - Prof. dr. Eshref Ymeri

**BOTIM I AKADEMISË SHQIPTARO-AMERIKANE TË SHKENCAVE
DHE ARTEVE**

DITURIA

Revistë periodike, shkencore, historike, kulturore, politike

Nr. 16, Qershor - Shtator 2026

Botues: Prof.Dr. Skënder Kodra Phd, Kryetar i Akademisë

Kryeredaktor: Av. Halil Rama – “Mjeshtër i Madh”

KËSHILLI BOTUES:

**Prof. dr. Flori Bruqi Ph.D
Alban Daci**

**Prof. dr. Eshref Ymeri
Prof. dr. Besa Kadriu Ph.D
Halil Teodori**

**Akademik/e Sanie Selita
Prof. dr. Arjan Hamiti**

**Emmy Krosi, shkrimtare&kritike letrare
Prof.dr. Astrit Memia**

**Akademik Xhelal Marku
Prof. Agim Dauti**

**Akademik Nikoll Kola
Akademik Xhavit Lashi**

**Akademik/e Rajmonda Maleçka
Poete Bujana Malaj**

**Akademik Hysen Kosovrasti
Av. Halil Rama**

Botimi i kësaj reviste u sponsorizua nga Z. Shaban Gashi

Design & layout: Dashamir Vraniçi

**@Të gjitha të drejtat i takojnë Akademisë Shqiptaro-Amerikane të
Shkencave dhe Arteve**

**Adresa: E-mail: halilrama9@gmail.com
Telefon: 00355 674070402**

PASQYRA E LËNDËS

NDERIMI

- PROF. DR. SKËNDER KODRA “NDERI” I KOMUNËS SË PEJËS
Nga akademik Prof. Dr. Flori Bruqi 5
- MENDIMI SHKENCOR I PROF. DR. SKËNDER KODRA DHE ANGAZHIMI HUMAN
NË SHËRBIM TË SHOQËRISË - Nga Akademik Rajmonda Maleçka 7
- AAAS, “ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE” PËR KRYETARIN E KOMUNËS PEJË,
Z. GAZMEND MUHAXHERI 8

REFERATI

- DOMOSDOSHMERIA HISTORIKE E RIKTHIMIT TË TOPONIMIT “DARDANI”
- Nga Prof. dr. Eshref Ymeri 10

JUBILARE

- MESAZHET E SHABAN GASHIT SI TESTAMENT ATDHEDASHURIE 15
- Nga KORAB DRINI 15

INTERVISTA

- KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT – LIDER NË ARSIMIN PROFESIONAL 19
- Nga Halil Rama – Mjeshtër i Madh 19

FJALA

- NË MBROJTJE TË SË VËRTETËS HISTORIKE PËR MASAKRËN E TIVARIT 25
- Nga Ismet Sylejmani 25

REAGIMI

- SHKUPI PËRZIEN BOTËN SERBE ME ALBANOFOBINË 27
- PADREJTËSIA HISTORIKE E EVROPËS NDAJ SHQIPTARËVE
- Nga Shahbaze Vishaj- Grajçevci 29
- KUR TRANZICIONI BËHET SISTEM - Nga Agred Tafaj 30
- BASHKIA PËRMET SHPALL QYTETAR NDERI XHEVAT LIMANIN!
PO STRUGA ÇFARË PRET? - Nga Akademik Agim Dauti 31

INTEGRIMI

- SHQIPËRIA NË PRAGUN E EVROPËS - Nga Spartak Fikaj 32
- KOSOVA NË NATO, KËSHTJELLË E INTERESAVE TË SHBA NË RAJON
- Nga Gjeneral Piro Ahmetaj 34

OPINION

- ADEM JASHARI, HEROI I LIRISË - Nga akademik Prof. Dr. Flori Bruqi 36

ESSE

- INVALIDI I UÇK -së I FIKSUAR NË NJË FOTOGRAFI NË SHESHIN “SKËNDERBEJ”?
- Nga Kolonel Sefer PASHA 37
- KËNGËT E HIMARËS DHE POEZIA E FATOS ARAPIT PËR ZVËRNECIN
- Nga Sefer Pasha 38

REFLEKSIONE

ÇAMËRIA NUK ËSHTË THJESHT NJË KUJTIM NË HISTORI - Nga Akademik Arjan Hamiti	40
--	----

ARGUMENTE SHKENCORE

VARREZAT E USHTARËVE GREKË NË SHQIPËRI DUHET TË TRANFEROHEN NË GREQI - Nga Prof.Dr.Bardhyl Çipi	41
--	----

PERSONALITETE

JERONIM DE RADA: ARKITEKTI I RILINDJES SHPIRTËRORE SHQIPTARE - Nga Alban Daci	45
--	----

60-VJETORI

NJË VIZITË MALLËNGJYESE NË QYTETIN E PESHKOPIË - Nga Akademik Xhavit LASHI	48
---	----

PERSONAZH

ING.IKBALE KURTI, GRUAJA QË NDËRTOI MATIN -DREJTUESE, BASHKËSHORTE E NËNË SHEMBULLORE - Nga Kimete BERISHA	49
---	----

PROMOVIMI

DR. SALI KURTI – PORTRETI I NJERIUT FISNIK	53
--	----

KRIKA LETRARE

BUJANA MALAJ – PROFILI I SHKRIMTARES, HUMANISTES DHE MISIONARES SË PAQES - Nga Halil Rama- Mjeshtër i Madh	59
---	----

LETRAT

BËLBËZIMA - Tregim nga Fatmir Terziu	63
GURI I SHALËS - Tregim nga Sakip Cami	65
TRIPTIK - Poezi nga Emmy Krosi	67

REÇENSION

ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS - Prof. dr. Eshref Ymeri	71
--	----

NDERIMI

Personaliteti i Prof. Dr. Skënder Kodrës është i njohur në SHBA, në vende të ndryshme të Evropës dhe në të gjitha trojet shqiptare

PROF. DR. SKËNDER KODRA “NDERI” I KOMUNËS SË PEJËS



Nga akademik PROF. DR. Flori Bruqi

- **Figura poliedrike e Prof. Dr. Skënder Kodra, është kthyer në një simbol për komunitetin shqiptar në SHBA, Kosovë dhe Shqipëri, si një njeri me energji të pashtershme humane e patriotike**

Këshili i Komunës së Pejës, Kosovë i ka akorduar Prof. Dr. Skënder Kodrës (akademik) titullin e Mirënjohjes “Nderi i Komunës”, me motivacionin *“Për kontributin e dhënë në ndihmë të shkencës dhe diasporës shqiptare, për tolerancën dhe paqen në nivel ndërkombëtar”*.

Çertifikata përkatëse (MAJ 2026) është firmosur, me mirënjohje të thellë dhe respect të veçantë nga Kryetari i Komunës/Mayor Gazmend Muhaxheri.

I ngazëllyer nga vlerësimi plotësisht i merituar, Kryetari i Akademisë Shqiptaro-amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, Prof. Kodra ka shpërndarë në rrjetet sociale një falenderim të veçantë për Komunën e Pejës dhe kryetarin e saj Z. Gazmend Muhaxheri. Prof. Kodra vlerëson kontributin e kryekomunarit Muhaxheri për realizimin e një programi zhvillimor ambicioz për Pejë. Ndërkohë ai ka marrë urime nga dhjetra akademikë, anëtarë të Akademisë Shqiptaro - amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, ndër të cilët veçjmë: Dibran Fylli, Tajar Domi, Av.Nikollë Kola, Prof.dr. Sali Kurti, Sali Kodra Rama, Dr.Arjan Hamiti, Yllka Mercuri, Gani Lami, Dritan Korumi, Iljaz Bobaj, Halil Rama

– Mjeshtër i Madh, Pleurat Lati Zhara, Pjetër Cara, Njazi Halili, Ibrahim M.Kodra, Lindita Alkaj Hoxha, Serbeze Gashi Kondirolli, Mhill Krasniqi, Ilirida Ismaili, Smajl Bytyçi, Shpend A. Loci, Sehit Beluli, Ali Zalli, Esat Ahmeti, Zani Asllanaj, Cindy G Loqkita, Lutfi Brami, Hatixhe Berani Grbeshi, Hys Hasa, Mehdi Hysenaj, Prof. dr. Astrit Memia, Bujana Malaj, Ali Kelmendi, Xhemile Adili, Musa Limani, Avdi Gashi, Shefqet Mili Rugovaj, Hasan Domi, Adrian Grajqevci, si dhe qindra personiletet tjera akademike.



Dhe nëse Mjeshtri i Madh Halil Rama e vlerëson Prof. Kodrën një figurë poliedrike me rrezatim e kontribute të shquara mbarëkombëtare, për akademik Arjan Hamitin është: “Një jetë e tërë në shërbim të dijes, shkencës, kombit dhe vlerave humane. Prof. Dr. Skender Kodra është shembull i përkushtimit, patriotizmit dhe profesionalizmit që nderon shqiptarët kudo në botë. Respekt dhe mirënjohje për kontributin e jashtëzakonshëm në psikologji, arsim dhe çështjen kombëtare. Qofshi gjithmonë i vlerësuar për

gjurmët që keni lënë në historinë tonë i nderuar dhe i respektuar Pr Dr Skender Kodra”.

Urimet e miqve të shumtë të Prof. Kodrës nga e gjithë hapësira mbarëshqiptare në botë kanë një emërues të përbashkët: *“Nderim dhe vlerësim i merituar për një personalitet të shkencës të përku-shtuar tërësisht ndaj çeshjes kombëtare shqiptare, si dhe për kontributin që ka dhënë dhe jep për vendllindjen e tij”*.



Figura poliedrike e Prof. Dr. Skënder Kodra, është kthyer në një simbol për komunitetin shqiptar në SHBA, Kosovë dhe Shqipëri, si një njeri me energji të pashtershme humane e patriotike.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e Akademikut tonë Prof. Dr. Skënder Kodra, Ph. D e ka dekoruar me titullin **"Kalorësi i urdhërit të Skënderbeut"**!

KUSH ËSHTË AKADEMIK PROF.DR. SKËNDER KODRA

Akademik Prof. Dr. Skënder Kodra u lind më 13 maj 1946 në Istog të Kosovës, ku kreu shkollën fillore.

Shkollën e mesme e vazhdoi në Gjakovë dhe

Pejë. Autoritetet qeveritare serbe e burgosen për motive patriotike.

Në shumë raste kaloi nëpër burgjet e Pejës , Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt, Suharekës në Burgun famëkeq CZ -në e Beogradit.

Më 1969 emigroi në Itali e pas një viti në SHBA, ku edhe mori statusin e refugjatit politik. Në SHBA më 1980 mbaron shkollën e mesme.

Më 1986 përfundon shkëlqyeshëm studimet e larta në Universitetin “Mercy College”, në de-gën e psikologjisë dhe pas një viti kreu studimet pasuniversitare në “Long Island University” dhe laureohet me titullin Master degry.

AKTIVITETI AKADEMIK

Në vitin 1991 mbron doktoraturën me temën *“Shkaqet që çojnë në skizofreni”* dhe merr titullin më të lartë shkencor në SHBA PH.D.

Më tej u specializua në një profil më të ngushtë në fushën e Psikologjisë Klinike.

Veprimtaria e tij është e larmishme si profesor, psikolog e shkencëtar.

Ligjëron në tri universitete me studentë nga e gjithë bota. Ai ka një veprimtari të begatë veçanërisht në Psikologjinë klinike, të cilën e ka pasuruar dhe me përvojën e madhe në spitalet ushtarake të psikiatrisë në New York, ku punoi për dhjetë vjet me pacientë të Luftës së Dytë Botërore dhe të Luftës së Vietnamit.

Diturinë dhe përvojën e tij si psikolog dhe shkencëtar, Prof. Dr. Skënder Kodra e ka përcjellë në tetë libra si: *Evoluimi i Trurit Dje, Sot dhe Nesër* Library of Congress (June 11. 2001) *Definition of personality.* Tiranë (Library of Congress (2003) *Drugs and its Impact.* Tirane Library of Congress (June, 11.2004) *Road Map Opportunities in Cilinical Psychology,* Tiranë Library of Congress (June 12.2006) *Library of Congress 101 Independence Ave, S.E. Uashington D.C. 20559-6000.*

I brumosur me ndjenja të larta atdhedashurie dhe si intelektual i përgatitur në SHBA, Akademiku i mirënjohur shqiptaro-amerikan Prof. Dr. Skënder Kodra ka dhënë një kontribut të çmuar dhe për popullin shqiptar.

Në vitin 1995 ai themeloi Akademinë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në New York dhe vazhdon të jetë aktiv si kryetar i kësaj Akademie. Me ndryshimet

demokratike në Shqipëri, Prof. Dr. Skënder Kodra vazhdoi të kontribuoj edhe në dheun amë.

Ai punoi dy vjet në Tiranë si klinikist pranë Klinikës psikiatrike të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, ku përgatiti dhe ligjëroi leksione të ndryshme.

Me kënaqësi ai i dhuroi kësaj klinike një bibliotekë të pasur me literaturë masive të psikiatrisë klinike amerikane. Gjatë kësaj kohe në Radio Tirana ai mbajti një rubrikë të përjavshme me temë nga psikiatria.

Në këtë periudhë Prof. Dr. Skënder Kodra viziton sërish vendlindjen e tij Kosovën, ku zhvillon një veprimtari të dendur shkencore dhe patriotike, aq sa siç thoshin dhe vendasit, klinika e tij u kthye në një istikam lufte. Pushtuesit serb ia bastisën klinikën dhe e arrestuan për ta detyruar të pajisej me dokumente serbe. Zoti Skënder Kodra nuk pranon dhe largohet i detyruar nga atdheu i tij. Në verën e vitit të Luftës në Kosovë, Prof. Dr. Skënder Kodra shkoi në ndihmë të të dëbuarve kosovarë, në kampet e shumta në Shqipëri, si dhe në spitalin Ushtarak në Tiranë.

Djali i tij Isai ushtarak dhe i lindur në SHBA, u radhit në radhët e UÇK-së në Kosovë, ashtu si dhe shumë të tjerë nga të afërmit e familjes Kodra.

Personaliteti i Prof. Dr. Skënder Kodra është i njohur në SHBA, në vende të ndryshme të Evropës dhe në të gjitha trojet shqiptare.

Ai ka qenë këshilltar pranë Ministrisë së Shëndetësisë në Shtetin e New Yorkut, është anëtar i Shoqatës së Doktorëve në Shtetin e New Yorkut, Anëtar i Shoqatës të sëmundjeve psikike “Sigmund Frojd” të Austrisë, nënkryetar i Akademisë së Intelektualëve Shqiptarë të Shkencës dhe Artit në Kosovë, anëtar i Shoqatës së Psikiatërve në Shqipëri, etj.

Prof. Dr. Skënder Kodra vazhdon të jetë aktiv si mjek, si pedagog, si shkencëtar. Ai vazhdon të publikojë libra dhe studime shkencore në revistën “Dituria”, organ i Akademisë Shqiptaro-Amerikane me qendër në New York, Akadmi të cilën e drejton me pasion dhe profesionalizëm, si dhe në shumë revista e gazeta prestigjioze në SHBA dhe Shqipëri.

Akademikët e Akademisë së shkencave Shqiptaro-Amerikane më seli në New York, me degët e saja në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup si dhe opinionin mbarëkombëtar shqiptar i uron Z. Skënder Kodra, shëndet, jetë të gjatë në vazhdimësi.

Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptaro - Amerikane New York, Prishtinë, Tiranë dhe Shkup.

MENDIMI SHKENCOR I PROF. DR. SKËNDER KODRA DHE ANGAZHIMI HUMAN NË SHËRBIM TË SHOQËRISË



Akademik Rajmonda Maleçka

- **Në planin institucional, themelimi i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve përfaqëson një kontribut me rëndësi të veçantë. Kjo platformë ka shërbyer si një hapësirë**

për promovimin e dijes, shkëmbimin akademik dhe forcimin e lidhjeve midis diasporës dhe vendeve të origjinës. Nën drejtimin e tij, Akademia ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit shkencor dhe kulturor shqiptar në një kontekst ndërkombëtar

Në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore të mendimit shkencor shqiptar në diasporë, figura e Prof. Dr. Skënder Kodrës paraqitet si një ndërthurje e rrallë e formimit akademik të avancuar, përvojës jetësore dhe angazhimit të vazhduar

VLERËSIMI

AAAS, “ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE” PËR KRYETARIN E KOMUNËS PEJË, Z. GAZMEND MUHAXHERI



Akademia Shqiptaro - Amerikane e Shkencave dhe Arteve Nju Jork, ka vlerësuar kryetarin e Komunës Pejë, Z. GAZMEND MUHAXHERI, me Çertifikatë Mirënjohje, me motivacionin “Për kontributin e dhënë në përkrahjen e të drejtave

dhe lirive themelore të njeriut dhe popullit të Kosovës në komunitetin e Pejës, për mirëqënien dhe rritjen në nivel akademik të intelektualëve dhe për ndihmën bujare ndaj atyre që kanë nevojë. Për kontributin, seriozitetin e gjestin human në detyrën që ju fisnike në krye të komunës që ju drejtoni”.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast në një nga zyrat e komunës Pejë, Çertifikata e Mirënjohjes iu dorëzua z. Muhaxheri nga anëtarët e Akademisë Shqiptaro - Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, akademikët Xhevaire Gjellaj dhe Zymer Lulaj, ndërsa ishte i pranishëm edhe Z. Skënder Hasangjekaj, punonjës në komunën e Istogut.

Vijon nga fq. 7

shëm shoqëror e kombëtar. Ai përfaqëson modelin e intelektualit që e koncepton shkencën jo thjesht si fushë studimi, por si një instrument të drejtpërdrejtë në shërbim të njeriut dhe të progresit shoqëror.

Formimi i tij në Kosovë u zhvillua në rrethana të vështira historike, të karakterizuara nga kufizime të theksuara politike dhe shoqërore. Përndjekjet dhe burgosjet për motive patriotike nuk përbëjnë vetëm një aspekt biografik, por një element formues që ndikoi drejtpërdrejt në ndërtimin e profilit të tij etik dhe profesional. Këto përvoja kontribuan në zhvillimin e një ndjeshmërie të veçantë ndaj çështjeve të shëndetit mendor dhe traumës psikologjike, duke ori-

entuar më tej rrugëtimin e tij drejt psikologjisë klinike.

Zhvillimi i tij akademik në Itali dhe më pas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shënon një etapë të rëndësishme në konsolidimin e tij si studiues dhe profesionist. Në një mjedis akademik kërkues dhe konkurrues, Prof. Kodra arriti të ndërtojë një profil të qëndrueshëm shkencor, të kurorëzuar me doktoraturë në fushën e psikologjisë. Qasja e tij studimore karakterizohet nga një integritet i metodave bashkëkohore me përvojën empirike, duke reflektuar një perspektivë të gjerë dhe ndërdisiplinore.

Hulumtimet e tij mbi faktorët që ndikojnë në zhvillimin e skizofrenisë përfaqësojnë një



kontribut të rëndësishëm në kuptimin e kësaj patologjie komplekse. Duke shmangur reduksionizmin biologjik, ai propozon një model që përfshin ndërveprimin e faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe socialë. Kjo qasje është në përputhje me zhvillimet më të fundit të psikologjisë klinike dhe psikiatrisë moderne.

Përvoja profesionale e tij në institucionet psikiatrike ushtarake në New York përbën një komponent thelbësor të formimit të tij klinik. Puna me veteranë të luftës dhe individë të ekspozuar ndaj traumave të rënda psikologjike i ka dhënë atij një perspektivë të thelluar mbi çrregullimet e stresit post-traumatik dhe ndikimin afatgjatë të dhunës në strukturën psikike të individit. Kjo përvojë është reflektuar jo vetëm në praktikën e tij klinike, por edhe në kontributet teorike.

Veprimtaria e tij shkencore përfshin një sërë botimesh të regjistruara në Library of Congress, të cilat trajtojnë tema të ndryshme, nga neuropsikologjia dhe zhvillimi i personalitetit deri te përdorimi i substancave psikoaktive dhe orientimi profesional në psikologjinë klinike. Këto punime dëshmojnë për një angazhim të vazhdueshëm në kërkimin shkencor dhe në edukimin e brezave të rinj.

Në planin institucional, themelimi i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve përfaqëson një kontribut me rëndësi të veçantë. Kjo platformë ka shërbyer si një hapësirë për promovimin e dijes, shkëmbimin aka-

demik dhe forcimin e lidhjeve midis diasporës dhe vendeve të origjinës. Nën drejtimin e tij, Akademia ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit shkencor dhe kulturor shqiptar në një kontekst ndërkombëtar.

Kontributi i Prof. Kodrës shtrihet edhe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, ku ai ka vepruar si ligjërues dhe kontribues në jetën publike dhe akademike. Aktiviteti i tij përfshin ligjërata universitare, trajnime profesionale dhe mbështetje konkrete për zhvillimin e literaturës në fushën e psikologjisë. Gjatë periudhave të vështira historike, përfshirë luftën në Kosovë, angazhimi i tij humanitar dëshmon për një përkushtim që tejkalon kufijtë e profesionit.



Prof. Dr. Skënder Kodra përfaqëson një model të intelektualit bashkëkohor shqiptar në diasporë: një studiues i përkushtuar, një profesionist me integritet të lartë dhe një kontribues aktiv në shërbim të shoqërisë. Veprimtaria e tij dëshmon se shkenca, kur ndërthuret me përgjegjësinë etike dhe angazhimin human, shndërrohet në një forcë të rëndësishme për zhvillimin dhe mirëqenien e komunitetit.

REFERATI

Shumë intelektualë të njohur dardanë, në analizat e tyre, përdorin vazhdimisht toponimin “Dardani”

DOMOSDOSHMERIA HISTORIKE E RIKTHIMIT TË TOPONIMIT “DARDANI”



Prof. dr. Eshref Ymeri

- Kanë kalur 18 vjet që nga dita e shpalljes së Pavarësisë së popullit dardan, por askush nga elita politike dardane as që e ka vrarë mendjen absolutisht për flakjen e toponimit sllav “Kosovë” dhe zëvendësimin e tij me toponimin e lashtë arbëror “Dardani”. Për fat të keq, askush edhe nga elita politike e atdheut amë - Republikës së Shqipërisë, - s’e ka vënë kurrë ujët në zjarr për këtë problem me rëndësi mbarëkombëtare

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, në mjetet e informimit masiv kanë qarkulluar mendime dhe janë hedhur ide për ndryshimin e emërimit të kësaj treve arbërore, për t’i rikthyer asaj toponimin tradicional shumëshekullor pellazgoilirian “Dardani”.

Shumë intelektualë të njohur dardanë, në analizat e tyre, përdorin vazhdimisht toponimin “Dardani”. Këtu mund të përmendim intelektualin e shquar dhe analistin e formatit nationalist, Skënder Kapitin, Prof.dr. Flori Bruqin, Prof.dr. Mehdi Hysenin, anëtarin e mirënjohur të Ligës Shqiptaro-Amerikane, analistin e talentuar Hafiz Shala etj.

Për çudi, kanë kalur 18 vjet që nga dita e shpalljes së Pavarësisë së popullit dardan, por askush nga elita politike dardane as që e ka vrarë mendjen absolutisht për flakjen e toponimit sllav

“Kosovë” dhe zëvendësimin e tij me toponimin e lashtë arbëror “Dardani”. Për fat të keq, askush edhe nga elita politike e atdheut amë - Republikës së Shqipërisë, - s’e ka vënë kurrë ujët në zjarr për këtë problem me rëndësi mbarëkombëtare.

Këto vitet e fundit kanë rënë në sy dy analizat e Skënder Kapitit dhe një analizë e Fejzulla Berishës, titujt e të cilave po i përmendim në vijim:

Skënder Kapiti. “Republika e Kosovës të quhet Republika e Dardanisë”. (Faqja e internetit “Zemra Shqiptare”, 12 prill 2021).

“Dardanët, populli më i motivuar patriotikisht në Europë”, (botuar në disa faqe interneti më 28 mars 2026).

Intelektuali i njohur atdhetar, zotëria i nderuar Fahri Dahri, shprehet në përkrahje të Skënder Kapitit në të njëjtat faqe interneti.

Fejzulla Berisha. “Ndryshimi i emrit zyrtar të Republikës së Kosovës në “Dardani” - Një perspektivë strategjike dhe historike”. (Faqja e internetit e gazetës “Dielli”, 28 dhjetor 2024).

Edhe në analizat që kam botuar për vite me radhë, kam ngritur zërin vazhdimisht për flakjen sa më parë në koshin e historisë të toponimit “Kosovë”, si njëra nga mbeturinat e shpifura të sundimit sllav mbi trojet arbërore.

Në përkthimin nga serbishtja, *kosovo* do të thotë *toka e mëllenjave të zeza*. Rrënja *kos* në serbisht përdoret në kuptimin *mëllenjë e zezë*, kurse në greqisht *μετοχή* do të thotë *ngastër kishtare*. Në gjuhët e tjera sllave, fjala *kosovo* përdoret si toponim, në kuptimin *qendër banimi*.

Nga hulumtimet që kemi bërë, ja çfarë ka rezultuar në secilën nga këto gjuhë, sipas vendeve përkatëse:

Në Bullgari, me këtë toponim janë emërtuar *një fshat* në komunën *Bregovo* të qarkut të Vidinskut, *një fshat* në komunën *Treklano* të qarkut të Kystendiskut, *një fshat* në komunën *Asenovgrad* të qarkut të Plovdivit, *një fshat* në komunën

Kaspiçan të qarkut të Shumenskut.

Në **Poloni**, me këtë toponim janë emërtuar: *një fshat* në qarkun Naklo, *një fshat* në qarkun Svjeçe, *një fshat* në qarkun Tuhola, *një fshat* në qarkun ushtarak të Pomeranskut, *një fshat* në qarkun Gnjezno, *një fshat* në qarkun Gostin.

Në **Rusi**, me këtë toponim janë emërtuar: *një fshat* në rajonin Mezhdureçenski të qarkut të Vollogodskut, *një fshat* në qarkun e Kalluzhs-kut, *një fshat* në rajonin e Shahovskut të qarkut të Moskës, *një fshat* në qarkun e Novgorodit, *një fshat* në famullinë e Borkovskit të rajonit të Velikollukskut në qarkun e Pskovit, *një fshat* në qarkun e Tvjerskut, *një fshat* në rajonin e Dan-jillevskut të qarkut të Jaroslavit.

Harta e Dardanisë e vitit 1482



Në **Bjellorusi**, me këtë toponim është emërtuar *një qytet* në rajonin e Ivaçevickut të qarkut të Brestskut.

Në **Maqedoninë e Veriut** ekziston *një qendër e vogël banimi*, që është emërtuar *Kosovo Dabje* dhe që shtrihet në Bashkinë Delçevo.

Pra, në pesë shtete sllave, 19 qendra banimi janë të emërtuara me toponimin “kosovo”.

Vetvetiu shtrohet pyetja:

Si pati ndodhur që toponimi “Dardani” qe flakur nga faqet e historisë dhe qe zëvendësuar me toponimin antikombëtar sllav “Kosovo”?

Kësaj pyetjeje i është përgjigjur në një mënyrë tejet shtruese Profesori Enver Bytyçi, një personalitet i shquar ky elitari në fushën e studimeve historiografike dhe të analizave të çështjeve ndërkombëtare. Ja çfarë ka deklaruar ai në njërin nga veprat e veta të shquara:

“Mënyra si të futen shqjetë (serbët) në shtëpi është e veçantë. Ata s’bëjnë kurrë luftëra të mëdha, veç të vogla. Të madhen e bëjnë kur e dinë se të kanë mirë përfund. Kur s’mund të të thyejnë, futen si bujq, shërbyes, skllevër. Vetëm sa të fusin kokën. Por në atë çast kur janë të sigurt

për fitoren, shpërthejnë luftën shkatërrimtare, pa pyetur për asnjë marrëveshje që kanë nënshkruar vetë.

Vini re se ç’bëjnë kur shkelin në një vend të huaj: Ata s’pyesin kurrë se si quhet qyteti, lumi, mali a fusha. Shohin në shpat të një mali një qytet me shtëpi të bardha dhe ia venë emrin Berat! Përshkojnë një fushë të madhe, e quajnë Velipojë! Kalojnë një lum të rrëmbyeshëm dhe e pagëzojnë Bistricë! I ngjiten një mali të zhveshur, e thërrasin Gollobordë! Pushojnë tek një burim i zi, e quajnë Çorovodë! Dhe s’e kanë për gjë të ta ndërrojnë edhe emrin që ta ka vënë nuni, duke e përkthyer nashke (serbisht). Kur emri është i papërkthyesëm, të ngjisin mbrapa një “viç”, që ta kesh në vend të bishtit gjithë jetën.

Në turrin e parë të marrin plaçkën a tokën që i kanë vënë syrin. Po t’u thyesh hundët, tërhiqen menjëherë: - Keqkuptim, keqkuptim, - thërrasin. Në qoftë se mjaftohesh me protesta, të nxjerrin argumente nga më të pabesueshmit. Po t’i kërcënosh, e presin hovin dhe të thonë: - Ne jemi për paqen, ne jemi për bisedime, le t’i shtrohemi pleqnisë! Po e hëngre të bisedosh me ta, e tjerin punën tortë, sa të vjen te hunda! N’u tregofsh i fortë në bisedime, ata lidhin paqe me ty! Por si rezultat i paqes, ata s’dalim kurrë me humbje, sepse ti harron që në sofër të bisedimeve është malli yt, jo i tyre! E shumta, e shumta, ata do të humbasin atë që të kanë grabitur në fillim, gjë që s’është humbje. Ose pranojnë të ndajnë thelën përgjysmë me ty dhe atëherë të thonë me të qarë, se po bëjnë një sakrificë për hir të paqes! Kështu ata ndahen me fitim dhe përgatiten për një grabitje të re! Një këso paqeje kanë nënshkruar edhe Uroshi i Dytë me perandorin e Bizantit, Andronik, duke vënë në sofër të bisedimeve trojet tona! (Citohet sipas: Enver Bytyçi. “Shqiptarët, serbët dhe grekët”. Shtëpia botuese “Koha”. Tiranë 2005, f. 348-349).

Për dijeninë e lexuesve të nderuar, rreth tre vjet më parë, Kryetari i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe të Arteve, Prof.dr. Skënder Kodra, dhe Nënkryetari, Prof.dr. Mehdi Hyseni, i qenë drejtuar me një Përkujtesë Presidentes Vjosa Osmani dhe Kryeministrit Albin Kurti, në të cilën propozonin, që, në Kuvendin e Republikës së Kosovës të shtrohej për diskutim dhe të merrej një vendim i prerë për heqjen e toponimit Kosovë dhe për zëvendësimin e tij me toponimin

tradicional pellazgoilirian “Dardani”. Për fat të keq, as Presidentja, as Kryeministri, nuk reagues absolutisht, qoftë edhe me një përgjigje negative. Është me të vërtetë e çuditshme, se si ka mundësi, që, të dy krerët kryesorë të shtetit, e patën shpërfillur krejtësisht propozimin e drejtuesve të asaj akademie?! Tani, vetvetiu, lind një shqetësim me interes mbarëkombëtar: trualli ynë arbëror, Dardania arbërore, a duhet vallë të vazhdojë të mbajë emërtimin sllav “Kosovo”, të imponuar shekuj më parë me dhunë dhe mizori nga ana e barbarëve serbosllavë, apo atë emërtim duhet ta flakë në përgun e mbeturinave të së kaluarës historike? Si është e mundur, që, elita politike dardane, të vazhdojë të heshtë edhe pas 17 shkurtit 2008 për këtë problem me rëndësi të jashtëzakonshme, mbarëkombëtare?! Vallë nuk e kuptuaka ajo elitë, që, toponimi “Kosovo” në kushtetutën kriminale të Serbisë fashiste, përbën një fyerje të rëndë për dinjitetin kombëtar të popullit dardan?! Në këto kushte, ç’duhet bërë? Përderisa kryeshtetarët dhe krejt elita politike dardane s’çajnë kokën fare për rikthimin e toponimit “Dardani”, vendimin duhet ta marrë vetë populli dardan. Nuk e kemi informacionin e duhur, nëse në të gjitha tekstet mësimore të shkollave të të gjitha cikleve dhe në tekstet universitare, a është pasqyruar e vërteta për toponimin “Dardani”, të cilin serbosllavët e kanë flakur nga historia jonë kombëtare dhe e kanë zëvendësuar arbitrarisht me toponimin e tyre “Kosovo”?

Me këtë rast, po ju drejtohem me një thirrje të gjitha shtresave të popullsisë dardane, duke filluar nga nxënësit e shkollave, rinia studentore, profesorati i universiteteve, elitat intelektuale të të gjitha fushave të dijes, forcat e armatosura, familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës, pensionistët, vajzat dhe zonjat dardane, me qëllim që të krijojnë një grup pune dhe t’i drejtohen me një peticion të posaçëm Kuvendit të Republikës së Dardanisë për zhvillimin e një referendumi me pyetjen: “A jeni për ruajtjen e toponimit “Kosovë”, apo për rikthimin e toponimit të lashtë arbëror “Dardani”?

Thirrjen e mësipërme e vlerësojmë si tejet të arsyeshme dhe me shumë vend, sepse kemi parasysh një porosi shumë të çmuar të mendimtarit, personalitetit politik, filozofit dhe shkrimtarit italian *Nikolo Makiaveli* (*Niccolò di Bernardo dei Machiavelli 1469-1527*), Ai ka thënë:

“Populli gjithmonë është më i zgjuar, më i vendosur dhe më i arsyeshëm, sesa kryeshtetari”.

Me siguri që për zëvendësimin e toponimit “Kosovë” me toponimin “Dardani”, do të ketë edhe kundërshtarë, të cilëve ua ka infektuar ndërgjegjen politike propaganda e Serbisë fashiste. Një ndër këta kundërshtarë është edhe Agim Vinca, i cili, në artikullin fyes kundër meje, me titull “*Kryqëzata e kalorësit kallp*”, të cilin Portali “*Kosova Sot*” e ka botuar me shumë kënaqësi më 06 mars 2026, mua më qorton, duke deklaruar:

“Republikën e Kosovës nuk e quan me emrin e saj kushtetues, por “Republika e Dardanisë”!”.

Pra, Agim Vinca nuk shqetësohet absolutisht që trualli arbëror dardan mban mbi kurriz toponimin e neveritshëm sllav “Kosovë” edhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, dhe, si një intelektual i fushës së letrave dhe i botës akademike, në vend që të kishte ngritur zërin me kohë për rikthimin e toponimit arbëror “Dardani”, i ka mbetur qejfi që unë nuk respektoj emërtimin sipas kushtetutës. Domosdo që Agim Vinca, si servil i regjur i Enver Hoxhës dhe i Titos, nuk mund të reagojë ndryshe, sepse ai dhe të gjithë enveristët e tjerë në Republikën e Dardanisë, janë rritur dhe edukuar në frymën e dashurisë për Enver Hoxhën, i cili s’ishte gjë tjetër, veçse pjellë Titos, nën kujdesin e drejtëpërdrejtë të “mamive” Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha. Pikërisht këto dy “mami” e formuan Enver Hoxhën si agentin e Beogradit, si kryediktatorin e Republikës së Shqipërisë dhe si armikun e popullit dardan. Prandaj edhe jo më kot Titoja e pati nderuar Enver Hoxhën me medaljen më të lartë, “Hero i popujve të Jugosllavisë”. Ndërkohë, në faqen e parë të Abetares së vitit 1947, me qëllim helmatosjen e ndërgjegjes së njomëzakëve të klasë së parë të shkollës fillore, me porosi të Enver Hoxhës, qe shkruar: “*Tito luftëtar, Tito çlirimtar, Tito shpëtimtar i popullit tonë*”. Që enveristët në Republikën e Dardanisë të binden njëherë e mirë se Enver Hoxha ka qenë armik i popullit dardan, në vijim po rendisim disa fakte konkrete:

Së pari: Miladin Popoviçi, pasi mori në dorë Rezolutën e Konferencës së Mukjes në Panarit të Korçës, ku ndodhej udhëheqja e lartë e partisë dhe Shtabi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e zhubraviti, e bëri shuk dhe ia përplasi në fytyrë Enver Hoxhës. Dhe Enver Hoxha, si një servil i pështrë i emisarit jugosllav, për turpin e tij dhe

të Partisë Komuniste të Shqipërisë, nuk mundi të reagonte siç i takonte një njeriu me dinjitet kombëtar. Përkundrazi, ai heshti tamam si ndonjë qen i rrahur para agait të tij serbomadh. Këtë fakt të turpshëm për biografinë e Enver Hoxhës, e ka zbuluar në Arkivin e Shtetit Prof.dr. Muharrem Dezhgiu. Por le të lexojmë një informacion më të hollësishëm për këtë ngjarje poshtëruese në historinë e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe në jetëshkrimin e udhëheqësit të saj, kukullës së Beogradit Enver Hoxha, që tërhiqej zvarrë para shovinistit Miladin Popović:

“Xhelal Staravecka, i pranishëm në momentin kur erdhi letra e Ymer Dishnicës për Marrëveshjen e Mukjes, ka sjellë si dëshmi atmosferën që krijoi ky lajm:

“Gjendeshim me shokët e KQ, në mes të të cilëve ishte dhe Miladini, kur arrin korrieri dhe solli Proklammatën e Marrëveshjes së Mukjes. Hapëm Proklammatën dhe e lexuam. Të gjithëve na u ndezën fytyrat nga gëzimi për arsye se u mbërrit bashkimi. Mandej, gjysmë shqip e gjysmë serbisht (për arsye se unë nuk di serbishten e Miladini nuk di shqip) disi i shpjegova çka ishte shkruar në Proklammatë. Fytyra e Miladinit menjëherë u ndryshua dhe tha:

“Ky bashkim (i Kosovës me Shqipërinë) nuk mund të pranohet. Ne gjithnjë e më tepër forcohemi dhe do të fillojmë me u ra me shpata e jo bashkime me qej(qenër). E mandej ajo Shqipëria etnike! Nanën e saj!”

Fytyrat tona menjëherë u errën dhe u detyruam me thanë:

Po, po! Do të shohin këta nacionalistë për disa ditë, derisa ne të organizohemi edhe më mirë...dhe do u themi:

Qe Shqipëria juaj Etnike! Sigurisht, shprehja jonë në fytyrë duhet të ndryshojë gjithmonë sipas shprehjes së fytyrës së Miladinit” [V. Dedijer, Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare (1939-1948), Beograd,1949, f.112. Citohet sipas: Prof.dr. Muharrem Dezhgiu. “Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)”. Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”. Tiranë, 2005, f. 316].

Së dyti: Në Plenumin e Beratit të muajit nëntor të vitit 1944, emisari jugosllav, Velimir Stojnić, deklaroi:

“Shqipëria jo që nuk e rrit dot ekonominë e saj, por as e zhvillon dot atë, sepse imperializmi do ta gëlltiste; ...e vetmja zgjidhje e saj është të bashkohet në një konfederatë me Jugosllavinë”

(Stefanaq Pollo, Arben Puto. *“The History of Albania from its origins to the present day”*. Routledge & Kegan Paul Ltd. 1981, f. 245. Citohet sipas: Mërgim Korça. *“Kush e shkruan historinë”*. Gazeta *“Metropol”*. 17-18 korrik 2012).

Së treti: Prof.as.dr. Elmas Leci, drejtor i Institutit të Studimit të Problemeve të Sigurimit dhe të Mbrojtjes në Tiranë, në shkrimin e tij *“A e shiti Enver Hoxha Kosovën”*, shkruan:

“Në shtëpinë e tij, në verën e vitit 1999, Fadil Hoxhës i bëra pyetjen: “A kishte kontaktuar dhe a ia kishte bërë ndonjëherë prezent Enver Hoxhës çështjen e rëndë të Kosovës?”. Fadil Hoxha m'u përgjigj: Po, kam shkruar te Enver Hoxha në Tiranë në dhjetor të vitit 1945, inkonjito, pa lejen e Titos, së bashku me Zekeria Rexhën, dhe i kam shtruar si gjendjen e rëndë nën Serbi ku ndodhen kosovarët, ashtu edhe se çduhet të bënim. Kjo ishte bisedë shqiptarësh, e mendoj, për shqiptarët. Biseda e zhvilluar në kabinetin e Enverit, në vend që të bëhej preokupim i qeverisë shqiptare, kishte mbërritur, para kthimit tim, te Titoja”.

Kështu e mbylli deklarin e tij ish-udhëheqësi kryesor i Kosovës dhe në një periudhë kohe edhe President i Jugosllavisë, Fadil Hoxha” (Citohet sipas: Xhafer Leci: “Fadil Hoxha nuk e meriton ngritjen e një përmendoreje”. Faqja e internetit “Tribuna Shqiptare”. 05 mars 2014).

Së katërti: Enver Hoxha, në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të Partisë më 15 dhjetor të vitit 1947, ka deklaruar shprehimisht:

*“...Duhet ta fitojmë kohën e humbur e të bëjmë sa më shpejtë bashkimin de fakto të Shqipërisë me Jugosllavinë në të gjitha fushat, (parti, ekonomi, ushtri, etj.), se Shqipëria nuk mund të qëndrojë si shtet i pavarur dhe aq më pak të ndërtojë socializmin, pa u bashkuar me Jugosllavinë...” (Citohet sipas: Mërgim Korça. “Ku gënjen Paskal Milo. Replikë me historianin “e nderuar”. Gazeta *“Metropol”*. 14 korrik 2012).*

Me këtë porosi të prerë që jepte tradhtari Enver Hoxha për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, ai çonte në vend urdhrin e Beogradit, të këtij armiku shekullor të kombit shqiptar, për gllabërimin sa më të shpejt të vendit tonë nga ana e shovinizmit serbomadh, urdhër ky, të cilin Velimir Stojnić ia përcolli tre vjet më parë Partisë Komuniste të Shqipërisë në Plenumin e 2-të të Beratit që u përmend më lart. Kjo kërkesë e ngutshme për bashkimin sa më të shpejtë të

Shqipërisë me Jugosllavinë, dëshmon për natyrën prej frikacaku dhe prej njeriu të pakarakter të Enver Hoxhës, i cili nuk kishte kurrfarë besimi në forcën krijuese dhe në shpirtin e paepur të popullit shqiptar, i cili mund të bëjë me të vërtetë mrekullira kur udhëhiqet nga politikanë me vetëdije të lartë kombëtare. Si një njeri pa shtyllë kurriore, Enver Hoxha kërkonte t’ia vishte edhe popullit shqiptar tiparet e tij prej langoi të Beogradit.

Së pesti: Pas kthimit nga vizita në Bullgari në dhjetor të vitit 1947, në mitingun e organizuar në Sheshin “Skënderbej”, Enver Hoxha iu drejtua të pranishmëve me thirrjen:

“...Të rrojë bashkimi dhe vëllazërimi me popujt e mareshalit Tito” (Gazeta “Bashkimi”, 20 dhjetor 1947. Cithet sipas: Dr. Vasfi Baruti. “28 nëntori i tretë”. Botim i Qendrës së Pavarur Sociologjike “Eureka”. Tiranë 2006, f. 32).

Së gjashti: Pas takimit që nacionalisti i shquar kosovar Halim Spahia pati me Titon pas luftës, i cili e refuzoi kërkesën e tij për ribashkimin e Kosovës me Shqipërinë, ai vendosi të vinte në Shqipëri.

“Në të kthyer nga Beogradi në Gjakovë e Prizren, ku kishte takime sekrete me anëtarët e KQ të LNDSH dhe patriotë të njohur, udhëtoi për në Tiranë për t’u takuar me Enver Hoxhën (me të cilin njihej mirë qysh më herët). Në këtë takim me Enver Hoxhën, në prezencën edhe të sllavomaqedonit Koçi Xoxe, kërkoi përkrahjen e Enver Hoxhës për këtë çështje me rëndësi jetike për ardhmërinë e Kosovës dhe të kombit shqiptar, por pa dobi, pasi nuk gjeti mirëkuptim dhe as mbështetje të duhur”. (Cithet sipas: “Halim Spahia - Uikipedia”. Faqja e internetit, 07 shtator 2010).

Siç dihet, ky nacionalist i shquar, gjatë kohës që ndodhej në Shqipëri, arrestohet me urdhër të Enver Hoxhës dhe u dorëzohet autoriteteve jugosllave, të cilat e pushkatuan në vitin 1946, bashkë edhe me disa nacionalistë të tjerë.

Së shtati: Në një takim që përfaqësuesi i misionit amerikan në Tiranë Jakobs ka pasur me Enver Hoxhën më 16 tetor 1946, i ka thënë këtij të fundit se Shqipëria mund të shtrojë si çështje futjen në axhendën e Konferencës së Paqes në Paris të kërkesës për rajonin e Kosovës. Madje ai e ka pyetur ballazi:

“A nuk mendoni ju se, të paktën, kërkesa juaj duhet të diskutohet dhe të studiohet?”.

Dhe Enver Hoxha, si tradhtar i popullit shqiptar të Kosovës, dha këtë përgjigje:

“...ne nuk jemi duke shtruar kërkesën për rajonin e Kosovës nga aleatja jonë, Jugosllavia” (Cithet sipas: Prof.dr. Beqir Meta. “Tensioni greko-shqiptar 1939-1949”. GEER. Tiranë 2002, f. 516).

Konferenca e Paqes e vitit 1946 në Paris, ishte një rast shumë ideal që Shqipëria të kërkonte ribashkimin e Kosovës me Shqipërinë, duke pasur edhe përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por Enver Hoxha, si tradhtar i popullit shqiptar të Kosovës dhe vegël e verbër e Titos, nuk deshi ta shfrytëzonte këtë rast fatlum në të mirë të interesave tona kombëtare.

Së teti: Në takimin me Molotovin, ministrin e jashtëm të BRSS, takim ky që u zhvillua në Varshavë më 24 qershor 1948, Enver Hoxha deklaroi:

“Letra e KQ PKP(b) e shpëtoi Shqipërinë nga një rrezik i madh. Shqipëria dhe Partia Komuniste e Shqipërisë u ndodhën në një rrezik të madh si rezultat i veprimeve të drejtuesve të Jugosllavisë” (Cithet sipas: “Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse”. Botimet TOENA. Tiranë 2006, f. 174).

Para gjashtë muajsh, Enver Hoxha kërkonte ta bashkonte Shqipërinë me çifligun jugosllav të agait Tito. Gjashtë muaj më pas, ai braktisi çakallin jugosllav, për të përfunduar në strofkën e ujkut rus.

Së nënti: Në letrën që Enver Hoxha i dërgonte Stalinit në vitin 1949 për Kosovën, deklaronte:

“Shqiptarët e Kosovës duhet ta mësojnë mirë se armiku i tyre i pamëshirshëm... është imperializmi amerikan...” (po aty, f. 257).

Me këtë deklaratë, Enver Hoxha, si një servil i regjur, binte në bark para agait të Kremlinit, duke mohuar në mënyrën më të paturpshme kontributin e jashtëzakonshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe personalisht të Presidentit Uillson në Konferencën e Paqes në Paris pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë, të cilën ujqit evropianë kërkonin ta copëtonin përfundimisht, duke e fshirë një herë e mirë nga harta e Evropës, për interesat e shovinizmit serbogrek. Ky kontribut i Shteteve të Bashkuara të Amerikës u manifestua në mënyrën më të shkëlqyer edhe në mbrojtje të Kosovës në gjashtëmujorin e parë të vitit 1999.

JUBILARE

AKADEMIA SHQIPTARO-AMERIKANE E SHKENCAVE DHE ARTEVE ME SELI EDHE NE PEJË

MESAZHET E SHABAN GASHIT SI TESTAMENT ATDHEDASHURIE

Nga KORAB DRINI

250-vjetori i Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i njohur edhe si Semikentnari (*Semiquincentennial*) shënon një moment historik që kulmon më **4 korrik 2026**. Kjo datë shënon 250 vite nga nënshkrimi i Deklaratës së Pavarësisë më 4 korrik 1776, duke festuar shkëputjen e 13 kolonive nga Britania e Madhe.



Shqiptaro - amerikani i devotshëm Shaban Sali Gashi, përfaqësues dinjtoz i diasporës shqiptare të SHBA, një muaj para kësaj date historike nisi përgatitjet për t'i dhënë shkëlqimin që meriton në vendlindjen e tij, qytetin e Pejës së Kosovës.



Dhe jo rastësisht, por sepse me këtë jubile të 250-vjetorit të SHBA-ve përkon edhe ditëlindja e tij e 77-të, si dhe përrurimi i selisë të Degës të Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve për Kosovën.

Një akt i rrallë ky i këtij atdhetari të flaktë, i cili një kat të vilës së tij në qytetin e Pejës, qytet i mbuluar nga hijeshia e maleve të Rugovës, e ka shndërruar në seli të kësaj akademie.

Një vilë e bukur kjo që i ngjan Shtëpisë së Bardhë, ndërtuar sipas arkitekturës së ngjashme të saj, si investim i këtij atdhetari që e do me shpirt e zemër vendlindjen, me pamje të mahnitshme që ndërthur natyrën e paprekur me historinë e lashtë të familjes së tij.



DHOMA MUZE...

Koridorin si dhe një dhomë të katit të tretë të “Shtëpisë së Bardhë” (të Pejës), Shaban Gashi i ka shndërruar në një muze të pasur.

Qindra fotografi të personaliteteve amerikane e të kombit shqiptar, letra falenderimi të Presidentëve të SHBA për kontributin e Shabanit si urë lidhëse e diasporës shqiptare me autoritetet amerikane etj, janë dëshmia më autentike e rolit që ai ka luajtur dhe luan si shqiptaro-amerikan i devotshëm.

I emocionuar nga ky arkiv, i ndërtuar sipas kriteresh arvikove shkencore, sytë më mbeten tek një foto ku janë fokusuar portretet e dy personaliteteve: Shaban Gashi në krah të akademik Prof. Skënder Kodrës.


“Para 30 vitesh mësova se në Nju Jork ekzistonte dhe funksiononte Akademia greko - amerikane e Shkencave dhe Arteve. E mendova mirë e mirë dhe i propozoj Prof. Kodrës që edhe ne të krijojmë Akademinë tonë – Akademinë Shqiptaro-amerikane të Shkencave dhe Arteve... Akademiku ynë i nderuar Skënder Kodra, me kontribut të jashtëzakonshëm akademiko-shkencor, sidomos në mbrojtje të çështjes kombëtare shqip-

tare u entuziazmuam nga ky propozim. Kështu, evidentum persona të tjerë me shtetësi e banim në SHBA, me tituj e grada shkencore, plotësuam dokumentacionin e duhur ligjor dhe legjitimuam Akademinë Shqiptaro - amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork”, tregon Shaban Gashi.

Më tej ai flet për aktivitete të rëndësishme të organizuara nga Bordi drejtues i kësaj Akademie nën drejtimin vizionar të Prof. Kodrës, në Nju Jork, dhe jo vetëm, por edhe në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Tetovë, Strugë etj, si në përkujtim të 550 vjetorit të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, për shenjtoren tonë Nënë Tereza,




për festat e pavarësisë së Shqipërisë e Kosovës, sesione shkencore e akademi përkujtimore, duke e shndërruar Akademinë tonë në institucion vlerash.



Undala gjatë të kjo foto, si emblemë e AAAS, por gjithkush që viziton këtë dhomë muze, do të mahnitej nga galeria pafund e fotove artistike. Shaban Gashi ka vendosur në faqet e mureve të kësaj dhome dhjetra korniza. Ndër ta, letrat e falenderimeve e foto në takimet e tij me presidentët e SHBA Bush, Klinton, Obama, Biden e Tramp; me ish-presidentët e Shqipërisë e Kosovës Prof. Dr. Sali Berisha e Dr. Ibrahim Rugova; foto të protestave të disaporës shqiptare para selisë së OKB e Shtëpisë së Bardhë për sensibilizimin e autoriteteve amerikane e botërore ndaj dhunës, represionit e genocidit serb që po përjetonte popullsia e pafajshme kosovare; në mbrojtje të UÇK etj, ku vetë ai ka qenë ndër protagonistët kryesorë. Foto që flasin sa një mijë fjalë dhe që dëshmojnë aktivitetin patriotik të shqiptarit të madh Shaban Sali Gashi. Ai e ka shpallur këtë objekt si seli të një institucioni të rëndësishëm që promovon vlerat amerikane në Kosovë.

Një vit më parë, në 249-vjetorin e Pavarësisë së SHBA-së, Shaban Gashi nga Peja ka ndërtuar një shtëpi që imiton Shtëpinë e Bardhë. Ai e

ka shpallur këtë objekt si seli të një shoqate që promovon vlerat amerikane në Kosovë, duke e quajtur “degë të Akademisë shqiptaro-amerikane të Shkencave dhe Arteve”.



“Ia kam kushtuar çështjes kombëtare shqiptare dhe miqësisë me SHBA-në”, thotë Gashi për revistën DITURIA'. “Në këto fotografi janë të gjitha aktivitetet e familjes sime, e cila në 35 vitet e fundit është marrë me çështjen kombëtare, fil-luar me aktivitetet përpara Shtëpisë së Bardhë. Nuk kemi kursyer asnjëherë asgjë. Kur ka qenë e nevojshme kemi protestuar edhe përpara OKB-së dhe Shtëpisë së Bardhë. Qëllimi ynë ka qenë që të arrijmë këtu ku kemi arritur – deri tek pavarësia e Kosovës e cila nuk do të arrihej kurrë pa mbështetjen e SHBA-së”, thotë Gashi.

Para 9 vitesh, në 4 korrik 2016 ai organizoi në sheshin “Nënë Tereza” të Prishtinës fotoekspozitën me 100 fotografi të shkrepura përgjatë përpjekjeve shumëvjeçare të luftës për çështjen kombëtare shqiptare e sidomos në mbështetjen të UÇK e pavarësisë së Kosovës.

Shaban Gashi dallohet dukshëm në krah të Presidentit Klinton gjatë vizitës në Prishtinë me rastin e përrurimit të përmendores së tij në nderim të kontributit madhor për çlirimin dhe “vulosjen amerikane” të pavarësisë së Kosovës.

Gjithsesi ai ndjehet më krenar se kurrë këtu



në vendlindjen e tij, Pejën me histori të pasur ndër shekuj, duke reflektuar rëndësinë strategjike, kulturore dhe historike të këtij qyteti në rajon. Si një vendbanim i hershëm, Peja ka kaluar nëpër periudha të ndryshme historike që e kanë formuar atë si një qytet të rëndësishëm të Kosovës.

HISTORIA E SHABAN GASHIT, SI TESTAMENT ATDHEDASHURIE

Ndonëse ka lindur në Pejë më 2 korrik 1949, Shaban Sali Gashi ndjehet krenar për origjinën e familjes e të fisit të tij nga Gashi i Tropojës së Malësisë së Gjakovës. Këtu në qytetin e Pejës mori shkollimin bazë fillor e 8-vjeçar si dhe dy të mesme: për mekanik maqinist dhe për konstruktor teknik. Punoi fillimisht në ndërtimin e Fabrikës së Automjeteve në Pejë dhe më pas për afro dy dekada po në këtë fabrikë në specialitetin e tij. Por gjithsesi, i etur për arsim e dije, Shabani nuk mund të mjaftohej vetëm me arësimin e mesëm. Në harkun kohor të viteve 1979-1981 ndjek studimet e larta ku diplomohet si Inxhinier elektromaqinist në Qendrën e Arsimit për Jugosllavi. Po ashtu ka kryer edhe shkollën politike të asaj kohe në Prishtinë dhe në Pejë, duke u formuar edhe në këtë aspekt.

Bashkëkohësit e mbajnë mend si

mbështetësin e protestave studentore të viteve '80 të shekullit të kaluar, që shpërthyen si vullkan dhe që ndikuan në thyerjen e barrikadave dhe nisjen e një epoke të re.

Pikërisht, për aktivitetin e tij patriotik do të survejohej e ndëshkohej nga policia sekrete serbe, ku si rezultat edhe do të sajohej një gjyq politik ndaj tij. Që kjo arsyeja, pra ftesa e gjykatës speciale, që në vitin 1990 e detyroi Shaban Gashin të largohej nga Peja për në Hannover të Gjermanisë, ku qëndroi familjarisht për 18 muaj. Ndërkohë, për hakmarrje, serbët i dogjën banesën e familjes së tij në Pejë.

Por kontaktet e vazhdueshme me shokun e mikun e fëmijërisë Prof. Skënder Kodra, që kishte avancuar me studimet e arritjen e karrierës akademike në SHBA, e ndihmuan që edhe ai të kryente disa vizita ardhje - ardhje në Amerikë, derisa para 30 vitesh vendoset përfundimisht bashkë me familjen në Nju Jork. Këtu, pas një aksidenti të rëndë në punë fiton pension për gjithë jetën, ndërsa djemtë e tij integrohen në jetën amerikane duke arritur standardet e këtij sheti ndër më të fuqishmit e botës. Veçanërisht ai nuk e fsheh krenarinë për vajzën e tij, Antigona e doktoruar për shkenca politike në Sharlot, Virgjina. Nga selia e degës së AAAS të Kosovës këtu në Pejë, në 250 vjetorin e pavarësisë së SHBA, mesazhi i Shaban Gashit (*Themelues & anëtar dhe këshilltar politik për botën e jashtme pranë Akademisë Shqiptaro – amerikane të Shkencave dhe Arteve*) për gjeneratët e ardhshme, është që të kontribuojnë për bashkimin kombëtar, të shkruajnë realisht historikun e familjes së tij dhe që pas ndarjes nga jeta, tek varri t'i vendosin dhuratat e çmuara të Presidentit Klinton.



INTERVISTA

Eksluzive për “DITURIA” e Prof. dr. Ylber Bezo - Rektor i KUB

KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT – LIDER NË ARSIMIN PROFESIONAL



Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

I themeluar para 15 vitesh, Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) është shndërruar në Lider të Arsimit Profesional në Shqipëri. Këtë e dëshmojnë arritjet e këtij institucioni cilësor të arsimit të lartë, ndër më të mirët në vendin tonë. Më së miri e argumenton rrugëtimin e suksesshëm të këtij universiteti, rektori Prof. Dr. Ylber Bezo në këtë intervistë eksluzive për revistën “DITURIA”.



I diplomuar në vitin 1979 në Fakultetin e Ekonomisë Agrare, UBT, (Intituti i Lartë Bujqësor), në degën Kontabël, me Titullin, Ekonomist i Lartë Kontabël, Bezo falë përkushtimit dhe aftësive profesionale të spikatura, do t'i ngjiste me meritë shkallët e karrierës akademike, duke u renditur me personalitete të elitës kombëtare në këtë fushë.

Pas titullit “Doktor i Shkencave Ekonomike”, fituar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2015 ka mbrojtur titullin akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Universiteti Bujqësor të Tiranës.

Prof. Bezo është pjesëmarrës në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara në fushën e financës, kontabilitetit dhe auditimit.

Ai ka një eksperiencë të gjatë në fushën ekonomike dhe me pozicione të rëndësishme si: Drejtor i Drejtorisë së Kontabilitetit, Ministria e Financave përgjatë viteve 1998-2010, trajner dhe ekspert i certifikuar nga Bordi i Londrës në standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Profesional dhe Analizës, Themelues, Auditues, Ekspert-Konsulent për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar.

Ka botuar shumë artikuj shkencorë, ekonomik, profesional dhe libra të fushës së edukimit universitar për ngritjen e kapaciteteve tekniko-profesional. I prirur nga deviza “Elitat krijojnë universitete”, Prof Bezo guxoi dhe para 15 vitesh krijoi Kolegjin Universitar i Biznesit (KUB), i cili sot konkurren denjësisht në tregun e arsimit profesional jopublik shqiptar.

-Prof. Bezo, si do ta profilizonit shkurtimisht Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), që ju e drejtoni prej 15 vitesh?

Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) si institucion i arsimit të lartë jopublik, ka një eksperiencë 15 vjeçare, ku studiojnë rreth 1500 studente. KUB shënon fillesat e veta të veprimtarisë në sistemin e arsimit të lartë shqiptar në vitin aka-

demik 2011-2012 me emrin “Akademia Profesionale e Biznesit” (KUB). APB, lindi si një iniciativë e sipërmarrjes së lirë, duke u mbështetur në kushtet e rrethanat e krijuara, si një mundësi reale, për të dhënë një kontribut me vlerë në filozofinë e arsimit shqiptar, me standarde bashkëkohore dhe me synimin e qartë për të kontribuar me seriozitet dhe dinjitet në arsimimin e brezave të rinj si dhe për të kontribuar në rritjen e prosperitetit, mirëqenies dhe zhvillimit në vendin tonë. APB është krijuar në zbatim të ligjit Nr. 9741, datë “21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (LAL)” dhe ka funksionuar bazuar në VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 “Për licencimin e “Akademisë Profesionale të Biznesit”(Sot, Kolegji Universitar i Biznesit(KUB)) si Institucion i Arsimit të lartë. Me Urdhër nr. 3, datë 05.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (MASH), APB është pajisur me leje për fillimin e veprimtarisë mësimore e kërkimore dhe akademike të programeve të studimit në përputhje me licencën e dhënë, duke filluar veprimtarinë e tij akademike qysh në fillim të vitit mësimor 2011-2012, në të dy fakultetet e saj (Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Drejtësisë). Në përputhje me vizionin dhe zhvillimin strategjik, KUB zgjeroi misionin e tij duke ofruar Studimet e Larta Profesionale me një njësi kryesore, Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP), i cili filloi veprimtarinë e tij me urdhër të MASR Nr. 139 datë 23.03.2018, tashme riorganizuar ne “Fakulteti i Studimeve te Aplikuara dhe Profesionale” (FSAP), dhe ne vitin 2024, ne kuader te nje Riorganizimi te KUB, u licencua edhe Fakulteti i Inxhinierise dhe Shkencave Kompjuterike, me 5 Programe e dege ne ciklin Bachelor dhe 3 ne ciklin Master i Shkencave, kur disa te reja jane ne proces miratimi e lincencimi.

Aktualisht te gjitha programet mësimore të KUB ofrohen nga:

- Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;
- Fakulteti i Inxhinierise dhe Shkencave Kompjuterike (FISHK)
- Fakultetit i Studimeve te Aplikuara dhe Profesionale (FSAP),

JANË TË LICENCUARA DHE TE AKREDITUARA.



-Cilat janë programet mësimore dhe diplomat që ofron Kolegji Universitar i Biznesit (KUB)?

KUB në këto vite të veprimtarisë së tij, është rritur si nga pikëpamja cilësore, ashtu edhe nga pikëpamja sasiore. Në saj të këtyre vlerave, KUB tashmë ka një emër në tregun e arsimit të lartë por edhe në tregun e punës. KUB deri tani ka diplomuar shumë ekonomistë, juristë, të cilët janë të punësuar mbi 95% e tyre dhe te angazhuar në funksione e detyra me përgjegjësi deri në institucionet e qeverisjes qëndrore, në kryeministri, ministri dhe struktura të tjera të qeverisjes vendore, kompani dhe biznese private, etj..

Nderkohe, KUB ka diplomuar profesionistë në programe profesionale 2 vjeçare të studimit, të cilët janë punësuar në biznese, si: Asistent Administrativ, Finance, Ligjore, Agjenci udhëtimi, hoteleri, ose si Teknik i Larte me 3 Programe me nga 3 profile ne Fushat e Sherbimeve Teknike, si: Fushen e sherbimeve te Automobilave, Elektrike dhe Kompjuterike, shume te kerkuara ne tregun e punes, ku jane punesuar mbi 96% e tyre.

Mbështetur në këto themele, pasuri dhe vlera didaktike, akademike, ligjore, strukturore, infrastrukurore, tradicionale dhe novatore, KUB punon me përkushtim duke e realizuar misionin e tij, për të qënë një institucion gjithnjë atraktiv, konkures dhe elitar në tregun e arsimitit e të punësimit. Ai ka ndërtuar vit pas viti, marrëdhënie bashkepunimi me subjektet e ndryshme private e shtetërore, kombëtare e ndërkombëtare në funksion të arsimitit dhe kualifikimit të studentëve të tij, por edhe të përmirësimit dhe përditësimit të kurrikulave të programeve të studimit.

Duke vlerësuar trendin në rritje te kërkesës

për të ndjekur studimet në programet e orientuara rreth digjitalizimit, kompjuterizimit, automatizimit, inovacionit, teknologjisë së informacionit, Informatikës Biznesit, **Inxhinierisë kompjuterike, softuare te aplikuar, inxhinierisë elektronike e digjitale** etj, bazuar edhe në Strategjinë e KUB dhe atë Kombëtare, për zhvillimin e Arsimit të Lartë në vend, si dhe të kërkesave të Tregut të Punës, Kolegji Universitar i Biznesit në vijimesi ndjek dhe përaftron Programet e studimit dhe Kurrikulat përkatëse të këtyre programeve me ato të trendeve të zhvillimit rajonal e global, dhe kënaq kërkesat e të rinjve tane si me ato të bashkëmoshatareve të tyre të huaj.

A. Ne “Fakultetin e Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale,

Tregu i punës vendas, rajonal dhe evropian ka nevojë, për burime njerëzore të kualifikuara në fushën e ekonomisë, administrim biznesit, manaxhimit, marketingut, financë kontabilitetit, raportimit financiar e auditimit, sipas standardeve dhe kodeve më të përparuara të Europës perëndimore;

Anëtarësimi në union i Vendit tone, është një proces në të cilin do të kryhen disa hapa dhe etapa të cilat do të angazhojnë burime njerëzore dhe staf të kualifikuar krahas të tjerash edhe me njohuri në fushat e ekonomisë, drejtësisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

KUB është IAL, veprimtaria e të cilës është realizuar me sukses duke patur parasysh standarde të larta akademike në fushën e mësimdhënies gjë e cila mund të vërehet edhe në % e punësimit të studentëve të diplomuar në këtë Kolegj Universitar që varion në shkallën 95-98%.

KUB vijon prej disa vitesh që në Nivelin e punësimit të studentëve, të kryesoje IAL në vend. Studentet që diplomohen në Fakultetin e Ekonomisë, në Master i shkencave në Kontabilitet Financë, Kontabilitet Auditim, Informatikë Biznesi, niveli i punësimit tejkalon 95%. Ky tregues mbështetet natyrisht në një Proces mësimor serioz, në kurrikula të orientuara shumë mire me kërkesat e Tregut të punës, kur shërbimet e mësimdhënies iu ofrohen nga një staf akademik nga më të mirët që kemi në vend. Për disa lëndë dhe module mësimdhënie ofrohet nga Ekspertë, që punojnë në Kompani ndërkombëtare kon-

sulence me zyra të tyre në Shqipëri, (Big Four) të Kontabilitetit dhe Auditimit si Deloitte, PËC, KPMG, Ernest Jong, apo Grand Thornton etj. Në këto kushte, shumë nga studentët tane rekrutohen çdo vit dhe punësohen pranë këtyre kompanive ndërkombëtare, ku ata performojnë me shumë sukses tashmë si ekspertë ndërkombëtarë në fushat profesionale të tyre.

Këto pika të forta, kanë bërë të mundur që çdo vit në Programet e Studimit Master në KUB ndjekin studimet shumë studente, që vec studentëve tane të ciklit bachelor vijne dhe rreth 40-50 %, të numrit edhe nga Fakultetet e universiteteve publike e private.

Referuar statusit të Shqipërisë si dhe rrugës për anëtarësimin në Bashkimin Europian konstatohet se të rinjtë shqiptarë po diplomohen me kurrikula evropiane e perëndimore duke u përgatitur si specialistë të fushave përkatëse dhe të aftë ta gjejnë veten në tregun evropian të punës;

Duke diplomuar specialistë të kësaj natyre dhe njohës të mirë të strategjive ekonomike dhe politike, të së drejtës evropiane dhe marrëdhënieve ndërkombëtare KUB kontribuon në rritjen e profesionalizimit të punonjësve të administratës publike apo private të cilët mbajnë funksione në lidhje me politikën publike, institucionet e evropiane dhe vetë Bashkimin Europian.

B “Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike” në KUB, funksionon me:

a. *Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit*

b. *Departamenti i Informatikës së aplikuar në Ekonomi.*

c. *Qendra e Kërkimit, Projekteve dhe Inovacionit*

Krahas programeve ekzistuese në **Informatikë Biznesi dhe Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)**, fushën e kompjuteristikës, pranë këtij Fakulteti është hapur dhe funksionon shumë mire edhe programi i studimit **Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”,** me profile:

Inxhinieri Kompjuterike.

Inxhinieri Softuerike e Aplikuar

Inxhinieri Elektronike dhe Digjitale.

Ndërkohe nevojitet të nënvizohet fakti se, **nga studimet e kryera edhe në vendin tonë, rezulton se, të rinjtë e sotëm, kanë tendencën të shfaqur**

qartazi per te studjuar në Programet e studimit të Inxhinierive në përgjithësi, duke besuar më tepër tek kurrikulat më të plota dhe serioze të studimeve, të cilat garantojnë edukim më të fuqishëm dhe të thellë tek të rinjtë tanë dhe që, nesër ata mund të konkurojnë në tregjet jo vetëm kombëtare e rajonale, por në nivel global.



KUB mbështet **Fakultetin e Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike** me të gjitha kapacitetet e nevojshme akademike, intelektuale, teknike, laboratorike dhe infrastrukturore për të siguruar sukses dhe standard misionin e vet të edukimit të studenteve.

Tregu i punës në të gjithë botën po ndryshon, duke shfaqur profesione të reja, kryesisht të lidhura me teknologjinë e informacionit, kjo e bën fushën e studimeve të Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike të pafundme. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike po orienton studimet e të rinjve duke i pasuruar ata me info të lëndëve të reja, që përbejnë trendet e momentit si Cloud Computing, Cybersecurity, Blockchain, Internet of Thing, Big Data dhe Business Intelligence, Fin Tech etj;

KUB referuar studimeve të tregut, beson fort se, për të punësuar specialistë të sistemeve inxhinierike dhe informatike, nevojitet një formim i gjere ne sherbim te shume industrish. Të diplomuarit në këto fusha do të kenë një gamë mundësish për të zgjedhur midis disa mundësive të punësimit duke filluar që nga kompanitë që ofrojnë shërbim në teknologji informacioni, në kompani menaxhimi dhe konsulence, në fushën e shërbimeve financiare, ne firma auditimi si dhe ne industri apo shërbime qeveritare;

Ekonomia globale ndikohet dukshëm nga teknologjitë e reja të automatizimit dhe informatizimit të proceseve operacionale dhe kjo e bën

atë më të integruar dhe më të ndërvarur, por njëkohësisht më pak të qëndrueshme dhe të sigurtë. Ndaj besojmë fort se të diplomuarit në këtë fushë do të japin kontributin e tyre në drejtim të zgjidhjes së problemeve teknike në sistemet e informacionit, problemeve ekonomike, të marketingut dhe menaxhimit, në proceset e modelimit dhe analizimit në biznes apo institucione publike etj. Ne kete kuader KUB, per kete vit ka aplikuar dhe pret per tu licencuar dhe **2 Programe te reja studimi ne Ciklin Master i Shkencave ne:**

- Master i shkencave ne “Fin Tech” dhe
- Master i shkencave ne “Cyber Security & IA”.

Fakulteti i Studimeve te Aplikuara dhe Profesionale(FSAP),

Fakulteti funksionon shume mire me rreth 300 studente, me 5 programe studimi profesionale me 14 Dege/profile, qe kerkohen teper nga tregu i punes. Ne kuader te riorganizimit Fakulteti ka aplikuar per Licencim 2 Programe Studimi cikli Bachelor: 1. Inxhinieri elektrike, 2. Arte dixhitale dhe grafik dizajn.

Eshte miratuar aktualisht Bachelor 3 vjecar, Inxhinieria ELEKTRIKE, ku priten regjistrimet kete vit. Nderkohe jemi ne pritje edhe miratimet e tjera nga Ministria e Arsimit.

-Pse duhet të zgjidhet kub nga maturantët?

SEPSE:

1. KUB prej disa vitesh listohet në 10 Universitetet më të mira në vend.
2. KUB eshte emër i njohur dhe i respektuar në Rrjetin e Shkollave të larta në vend.
3. KUB i ka te gjitha Programet dhe Profilet/ Deget të Akredituara.
4. KUB ka Programe studimi të kerkuara nga Tregu I Punes.
5. KUB I ka të Diplomuarit e vet prej vitesh, 95-98 % të punësuar në profesion.
6. KUB ka nje Staf Akademik cilësor dhe të dedikuar fort ndaj studentit.
7. KUB ka mbi 120 Marreveshje me kompani e studio profesionale, ku studentet bejnë Praktikat profesionale dhe punësohen.
8. KUB ka mbi 65 Marrveshje me Universitetet të huaja, me te cilët shkëmben studente dhe pedagoge, ne kuader te Programit “Erazmus Plus”.

9. Studentet në KUB dalin të gatshëm për të filluar një punë pa u trembur prej saj.
10. KUB ofron një Infrastruktura Moderne për zhvillimin e procesit mesimor.
11. KUB ka **TARIFA Vjetore Studimesh, konkurruese**, (tarifa vjetore e Fakultetit të Ekonomisë e Drejtësisë dhe Fakultetit të Studimeve të Aplikuara e Profesionale 200 Mije leke/viti, ndërsa Fakultetit Inxhinierisë e Shkencave Kompjuterike 220 mije leke/viti. Pagesa me këste.
12. Maturantët me mesatare 8.5 e lart përfitojnë Bursa për 4 fasha Note Mesatare, deri 100% .
13. KUB ofron Bursa për TALENTET E CDO FUSHE.
14. Tarifa të reduktuara, për studentët me nevojë socio-ekonomike.
15. Diplomat e fituara në KUB njihen kudo në Europë dhe SHBA.
16. KUB ofron studime në 7 programe në gjuhë të huaja (Anglisht). Në **Ciklin Bachelor**, Administrim Biznesi, Finance Kontabilitet, Informatikë Biznesi, Marrëdhënie Nderkombëtare, ndërsa në **Ciklin Master I Shkencave**, Manaxhim Biznesi, Kontabilitet Finance dhe Informatikë Biznesi.
17. Këtë vit presim të rekrutojmë studente të huaja për të ndjekur studimet në KUB.
18. Me **Diplomen tuaj 3 vjeçare Bachelor të KUB**, të njohur plotësisht nga **Ëëbster University SHBA, Filiali Athinë**, Ju mund të vijoni studimet, për rreth 1 vit, dhe **fitoni edhe Diplomen Amerikane 4 vjeçare**, me Tarifa 50% me të uleta.

- Cila është oferta akademike dhe financiare e kolegjit universitar të biznesit për vitin akademik 2026-2027?

Për Maturantët dhe studentët - KUB Vitin 2026-2027 Ofron Programet/Deget si më poshtë:

A. FAKULTETI I EKONOMISË, DREJTËSISË E SHKENCAVE SOCIALE ofron programe studimi në:

a) Bachelor (3 vite akademike 180 kredite/ECTS në:

1. Financë Kontabilitet, 3 vite 180 kredite, **Ofrohet edhe në gjuhën anglese.**

2. Administrim Biznesi, 3 vite 180 kredite,



Ofrohet edhe në gjuhën anglese.

3. Banka dhe Finance, 3 vite 180 kredite
4. Marrëdhënie Nderkombëtare, 3 vite 180 kredite, **Ofrohet edhe në gjuhën anglese.**
5. Drejtësi (studime të integruara 5 vite akademike, 300 kredite/ECTS)

b) Master i Shkencave (2 vite akademike 120 kredite/ECTS) në:

1. Kontabilitet Financë; **Ofrohet edhe në gjuhën anglese.**
2. Kontabilitet Auditim;
3. Menaxhim Biznesi; **Ofrohet edhe në gjuhën anglese.**
4. Menaxhim në Marketing;
5. Administrim Publik;
6. E Drejtë Civile e Tregtare

B. FAKULTETI I INXHINIERISË DHE SHKENCAVE KOMPJUTERIKE.

a). Bachelor (3 vite akademike 180 kredite/ECTS në:

1. Inxhinieri Kompjuterike.
2. Inxhinieri Softuerike e Aplikuar në ekonomi
3. Inxhinieri Elektronike dhe Digjitale.
4. Informatikë Biznesi, **Ofrohet edhe në gjuhën anglese.**
5. Teknologji Informacioni

b) Masteri i Shkencave në Shkenca Informatike (2 vite akademike 120 kredite/ECTS) në:

1. MSc. Informatikë Biznesi, **Ofrohet edhe në gjuhën anglese.**
2. MSc. Teknologji Informacioni
3. MSc. E-Commerce dhe Inovacion
4. Master I Shkencave në FIN TECH, (në proces licencimi).
5. Master i Shkencave në “CYBER SECURITY

& IA”. (ne proces licencimi).

C. KOLEGJI I STUDIMEVE TË APLIKUARA DHE PROFESIONALE ne:

PROGRAME/DEGE PROFESIONALE 2 VJECARE, Ne:

a) Program Profesional “Asistent i Lartë” 2 vite me profile:

1. Asistent i Larte Administrativ
2. Asistent i Larte Ligjor
3. Asistent i Larte Finance

b). Program Profesional “Hoteleri Turizem” 2 vite me profile:

1. Hoteleri
2. Agjenci Udhetimi

c). Program Profesional “Teknik i Lartë Automobilash” 2 vite me profile:

1. Teknik i Larte Automobilash - Automekanike
2. Teknik i Larte Automobilash – Autotronike
3. Teknik i Larte Automobilash – Hibride-Elektrike

d). Program Profesional “Teknik i Lartë Elektrik” 2 vite me profile

1. Teknik i Larte Elektrik – Energjitike
2. Teknik i Larte Elektrik – Automatizim Industrial
3. Teknik i Larte Elektrik – Elektromekanik

e). Program Profesional “Teknik i Lartë” 2 vite me profile:

1. Teknik i Larte - Sistemesh Kompjuterike
2. Teknik i Larte - Teknologji Informacioni e Komunikimi (TIK)
3. Teknik i Larte - Grafik, Ëeb, Multimedia Dizajn.

f). Programe studimi cikli pare bachelor 3 vite, 180 ects.



1).Inxhinieri elektrike 2).Arte dixhitale dhe grafik dizajn, (ne proces licencimi)

PS. Ne programet Profesionale 2 vjecare nuk kerkohet per note mesatare ne pranim!

A. BURSA STUDIMI:

TARIFA VJETORE E STUDIMEVE NE KUB ESHTË 200 mije Leke/viti, PER TE GJITHA PROGRAMET, NDERSA VETEM NE INXHINIERITE dhe Informatike ESHTË 220 MIJE leke/viti.

a. Për MATURANTET me mesatare te larte ofrohen BURSA STUDIMI:

- Per Note Mesatare mbi 9.8 deri 10:00 jepet 100% Bursë Studimi
- Per Note Mesatare mbi 9.5 deri 9.79 jepet 80% Bursë Studimi
- Per Note Mesatare mbi 9 deri deri 49 jepet 50% Bursë Studimi
- Per Note Mesatare mbi 8.5 deri deri 8,99 jepet 30% Bursë Studimi

b. Studentet qe rregjistrohen ne Master, dhe që kane perfunduar Ciklin Bachelor në KUB, fitojne ulje te tarifes Vjetore per 25 mije leke ne vit.

c. Fitojne ulje prej 20% te gjithe maturantet qe pararegjistrohen deri ne daten 31 Korrik.

PS. Kujdes!

1. Bursat perfitohen nga Maturantet qe rregjistrohen ne vitin e pare Bachelor dhe qe bejne pararegjistrim deri ne fillim te Fazës së Pare te Rregjistrimeve.

Ju ftojme te shpejtoni per ne KUB pasi ofertat dhe kuotat jane te limituara.

E. PER STUDENTE ME TRANSFERIME DHE PROGRAME TE DYTA.

1. Ne KUB pranohen Studente, qe duan te Transferojne Studimet
2. Pranohen studenta qe duan te ndjekin nje Program te Dyte studimi, ne te gjitha DEGET qe ofron KUB duke perfituar 25% ulje tarife.

JU MIREPRESIM !

Prof. Dr. Ylber BEZO, Rektor KUB.

FJALA

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës demaskon çdo tendencë se shqiptarët kryejnë masakra mbi shqiptarët, sepse ato i kanë kryer dhe i kanë bërë serbët

NË MBROJTJE TË SË VËRTETËS HISTORIKE PËR MASAKRËN E TIVARIT



Ismet Sylejmani

- **Është hera e parë që këtu në Tiranë, në kryeqytetin e Shqipërisë, mbaj fjalim për masakrën e Tivarit.**

E falënderoj nga zemra akademikun e madh shqiptar e mikun tim Hakif Bajramin, për të dhënë ekskluzive që mi ka dhënë gjatë takimit me 24 Maj 2026 në banesën e Tij dhe në restaurant Villa Natyra në Dardani në Prishtinë.

Mbi popullin shqiptar janë ushtruar shumë masakra dhe ato janë në masë të madhe në truallin e Kosovës. Nga të gjitha masakrat, vetëm masakra e Tivarit është më e veçanta, sepse ajo ka ndodhur ndaj popullit shqiptar të Kosovës, por jashtë territorit të Kosovës. Masakra dhe gjenocid mbi popullin shqiptar në shekuj ka kryer Serbia pushtuese.

Para Luftës së Dytë Botërore, gjatë saj, por edhe gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Serbia pushtuese ka kryer masakra në truallin e Kosovës.

Nuk i mjaftonte vrasja e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, por organizonte vrasjen e tyre edhe jashtë saj, ngjashëm sikur gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që i vriste shqiptarët në Kosovë dhe i zhvarroste nga vend ekzekutimet, dhe i varroste në Serbi në varreza masive ose i gjuante në lumin Danub, ashtu sikur flasin faktet Propaganda pushtuese, armiqësore dhe antikombëtare shqiptare, propaganda e gjakut të zi, të prishur e tradhtar shqiptar, ka arritur në masë të shpërndajë me anë të falangave të saja, se një masakër të tillë të madhe antishqiptare e antinjerëzore, në Tivar në Malit të Zi, ku u vranë e u prenë gjatë

Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare mbi 3277 burra, partizanë e luftëtarë shqiptarë nga Kosova dhe viset e saja, kinse e ka kryer Shqipëria.

Duhet të jesh mendje dhe figurë pro-serbe, duhet të jesh armiqësor e tradhtar, që edhe pse e din se nuk është ashtu, vazhdon ta plasosh e ta argumentosh si të vërtetë. Masakrat dhe gjenocidi i Serbisë pushtuese, kundër popullit shqiptar të Kosovës edhe pas vdekjes së Enver Hoxhës, i cili paturpësisht akuzohet për masakrën e Tivarit, nuk u ndalën, ato përkundrazi në luftën titanike e heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e gjatë bombardimeve të NATO-s u rritën në numër edhe më shumë se sa ato të së kaluarës. Serbia historikisht ka qenë dhe mbetet antishqiptare, prandaj ajo financon e furnizon fushatë për denigrim të fitoreve të popullit shqiptar.

Masakrën e Tivarit e kanë pranuar që e kanë bërë jugosllavët dhe janë dënuar udhëheqësit kriminelë serbë e malazezë. Beogradi e ka paraqitur si ngjarje tragjike duke zvogëluar shumë numrin e shqiptarëve të vrarë e të plagosur. Turp është shqiptari të mos i bëjë fajtorë gjakpirësit jugosllavë, në përgjithësi e serb në veçanti.

Masakra mbi shqiptarët e mobilizuar për frontin e Adriatikut, ka qenë e përbërë nga tri eshalone: Njëri eshaloni ishte nga Drenica dhe Vushtrria i përbërë prej 1700 rekrutëve. Eshaloni tjetër ka qenë i përbërë prej shqiptarëve nga Llapi dhe Gallapi, me 750 rekrutëve. Dhe eshalloni i tretë ka qenë i përbërë prej shqiptarëve të Dukagjinit dhe pjesë tjera, prej 440 rekrutëve.

Konventa Jugosllavo - Turke, për shpërnguljen e shqiptarëve ishte e vitit 1938, programin e zbatimit të së cilës në kohë lufte, e kanë marrë për detyrë ta realizonin Millovan Gjillas dhe Aleksander Rankoviq, për faktin se në Vis të Kroacisë me 26 Gusht 1944 ishte mbajtur takimi me përfaqësuesit e Shqipërisë, Koçi Xoxe, Ramadan Citaku dhe Bedri Spahiu, të cilët u morën vesh me Titon, dhe pasoi marrëveshja xhentëlmenë: nëse Shqipëria ndërton pas mbarimit të luftës sistem socialist, Kosova shkon me Shqipëri; nëse Shqipëria pas mbarimit të

luftës ndërton sistem kapitalist Kosova i takon Jugosllavisë. Këtë akord e kishin dëgjuar Gjillas dhe Rankoviq dhe të dy kanë reaguar si në kor: "shoku Marshall, çka është kjo marrëveshje?" Tito si dinak e antishqiptar që ishte, ju është përgjigjur, kjo marrëveshje vlen deri sa të largohen këta të delegacionit nga Shqipëria nga ujdhesa.

Dhe meqenëse Kosova çlirohet gjatë nëntorit të vitit 1944, menjëherë fillon, aksioni për mobilizim për me e zbrazë Kosovën nga djalëria. Ndërsa në anën tjetër tri divizione serbe, dy brigada malazeze dhe një brigade maqedonase, i kanë sjellë në Kosovë. Pra në njërin anë Kosova zbrazej nga shqiptarët, dhe në të njëjtën kohë vijnë forcat jugosllave në përbërje serb dhe malazeze e maqedonas, të cilat fillojnë e bëjnë krime nëpër fshatra.

Ndaj këtyre krimeve, është reaguar me 14 Janar 1945 nga ana e drejtuesve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare nga Kosova, se çetnikët dhe partizanët nga Serbia janë bërë një dhe po maltretojnë e po vrasin shqiptarë. Faktet historike dëshmojnë se për një njeri nëse ka qenë i dyshuar e kanë maltretuar tërë fshatin.

Me ato veprime ushtria partizane jugosllave e Titos barazohej me ushtrinë e kralit serb. Te mobilizuar për në frontin e Sremit kanë qenë nën drejtimin e Shaban Haxhisë Komandant dhe Qamil Brovinës Komisar. Ky eshalon i nisur për në frontin e Sremit në mes të Krushumlisë dhe Prikuples kishte një tentim asgjësimi, sepse ishte menduar me e rrokullisë trenin, por oficeri gjakovar Efen-diu, i asgjëson dy çetnik serb që tentuan ndarjen e vagonëve nga lokomotiva. Nga ky eshalon të gjithë kaluan nëpër Serbi, pa u ndodhur asgjë.

Për frontin e Adriatikut, plani i Rankoviqit dhe Gjillasit, ka qenë që tragjedia ndaj rekrutëve shqiptar, pa e përcaktuar cili eshalon, ka qenë i paraparë të ndodhë në tokën shqiptare në Shkodër, gjithnjë në marrëveshje me komandantin e brigadës së 10-të malazeze, i cili ishte i ngarkuar me atë detyrë, sepse deri në vitin 1942, kishte qenë në lëvizjen çetnike, dhe ky i zgjodhi luftëtarët më të përgatitur, që të jenë përcjellës të eshaloneve shqiptare, në rrugën Prizren-Kukës-Shkodër.

Gjatë rrugës ka pasur raste që janë ekzekutuar rekrutët aty për aty, një incident i vogël, ka ndodhur në urën e Zogut në Shqipëri, ndërsa në Shkodër, ka pasuar një incident shumë i organizuar mirë, i cili sipas urdhrit të komandantit, një ushtar malazez përcjellës, në pjesën ku afrohet toka me ujët e Liqenit të Shkodrës, për të kaluar Bunën, e shtynë ushtarin malazez që të laget, aty është hapur zjarr

ndaj rekrutëve shqiptar, të cilët nuk dihet se sa janë vrarë nga eshaloni i parë.

Në ato momente tragjike reagon fuqishëm oficeri i ushtrisë së Enver Hoxhë Hysni Vula dhe nga Kosova Sokol Nimani, vëlla i Xhavit Nimanit, dhe menjëherë ndërpritet gjuajtja ndaj rekrutëve. Meqenëse drenicakët dhe vushtrriasit nëpër Ulqin, kur arritën në Tivar, kishin mbajtur fjalime anti-jugosllave në Shkodër, aty bëhet ndryshimi, i renditjes së eshaloneve.

Eshaloni i Drenicës dhe i Vushtrrisë del i pari sepse ai ishte i dyti, ndërsa në Prizren ishte caktuar që eshaloni i parë të ishte i Llapit. Meqe Llapjanët nuk ditën të mbanin fjalime në Shkodër u caktuan të dytët. Tragjedinë e Tivarit, e ka organizuar pas ideimit të Rankoviqit dhe Gjillasit, nga komandanti i Brigadës 10-të malazeze.

Në Tivar në një moment pa kurrfarë paralajmërimi mitralozat e Brigadës 10-të malazeze, kanë filluar breshëritë nga të gjitha anët. Ata që janë gjetur në rrugë, gati të gjithë janë likuiduar. Ndërsa ata që arritën të hyjnë në ndërtesën e depos së Duhanit, mbi ta u hodhën bomba dore dhe vdiqën të gjithë. Tash ishte problemi se si të humben gjurmët e të vrarëve, në këto rrethana, me 1 Prill 1945, ka ardhur një mision anglo-amerikan dhe e ka incizuar detalisht tërë tragjedinë.

Ky film dokumentar, nuk është transmetuar kurrë, prandaj duhet të hulumtohet e të gjendet dhe të transmetohet dhe të dalë në shesh e vërteta e madhe e ekzekutimit të shqiptarëve të pafajshëm nga Kosova në Tivar. Nga Gjyqi ushtarak në Titograd janë dënua 11 veta, 10 ushtar dhe komandanti i Brigadës 10-të, të cilët janë amnistuar më vonë personalisht nga Tito. Komandanti dhe 3 të tjerë kanë qenë të dënua me pushkatim, por nuk janë ekzekutuar sepse intervenon Peka Dapçeviq Komandant i Frontit të 3-të Adriatikut.

Për asanacionin, pastrimin e kufomave është angazhuar eshaloni i Llapit. Ky është një tmerr i vërtetë. Të gjithë të vrarëve ua kanë lidhur nga një gur ne qafë dhe i kane hedhur në det. Këtë e ke kryer eshaloni llapjan, që ka qenë i detyruar. Prandaj ata janë ngrënë nga gjallesat e peshkaqenët. Ndryshe këto të dhëna dhe shumë tjera i ka shpjeguar realisht, në 32 faqe tekst makine Prof. Dr. Hakif Bajrami me titull: “Mizoritë jugosllave në Tivar, me 15 Maj 1985.”

Në fund lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e demaskon çdo tendencë se shqiptarët kryejnë masakra mbi shqiptarët, sepse ato i kanë kryer dhe i kanë bërë serbët.

REAGIMI

Protesta e studentëve shqiptarë në RMV, media bullgare: Mickoski zgjodhi rrugën e intrigave politike

SHKUPI PËRZIEN BOTËN SERBE ME ALBANOFOBINË

- **Media bullgare, BGNES nuk u kursye, duke e nisur artikullin e saj me titullin: “Shkupi përzien botën serbe me albanofobinë” dhe më pas vazhdon duke shkruar: “Mickoski zgjodhi rrugën e mashtrimeve politike”.**



Foto nga protesta e studentëve shqiptarë në RMV

Protesta e studentëve shqiptarë për gjuhën shqipe në Shkup, ku përveç atyre të Maqedonisë së Veriut, pjesë u bënë edhe ata nga Kosova e Shqipëria, ka marrë një vëmendje të madhe edhe jashtë RMV-së.

Media bullgare, **BGNES** nuk u kursye, duke e nisur artikullin e saj me titullin: “Shkupi përzien botën serbe me albanofobinë” dhe më pas vazhdon duke shkruar: “Mickoski zgjodhi rrugën e mashtrimeve politike”.

“Ditët e fundit, Maqedonia e Veriut ka qenë skenë e një krize politike, etnike dhe diplomatike që po thellohet. Kërkesa e studentëve shqiptarë të drejtësisë për të dhënë provimin shtetëror të jurisprudencës në gjuhën e tyre amtare është bërë katalizator për ngjarje që zbulojnë çarje të thella në shoqëri. Reagimet e aparatit shtetëror në Shkup – nga ndalimi i të rinjve pranë kufirit serb deri te një demarsh diplomatik – paraqesin një pamje shqetësuese të albanofobisë në rritje, të përzier me reflekset gjeopolitike nga e kaluara”, shkruhet në artikull.

Media bullgare vijon më pas me rolin e am-

basadorit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Denion Meidanin, ku shkruan se ai u bë cak i presionit institucional dhe sulmeve të shëmtuara online. Ministria e Punëve të Jashtme në Shkup thirri misionin diplomatik shqiptar për të dhënë një demarsh verbal mbi deklaratat e Meidanit në mbështetje të protestave studentore.

Shkupi i përshkroi veprimet e tij si “ndërhyrje të mundshme në punët e brendshme”. Faqet nacionaliste maqedonase në mediat sociale shpërthyen me fyerje vulgare dhe thirrje që ambasadori të shkonte në shtëpi. U shfaqën informacione jozyrtare se Meidani do të tërhiqej herët nën presionin e VMRO-DPMNE dhe koalicionit Vredi, të cilët janë të pakënaqur me qëndrimin e tij aktiv mbi të drejtat e shqiptarëve.

Portali bullgar u ndal gjithashtu dhe te deklarata e shkrimtarit dhe publicistit Kim Mehmeti, duke e quajtur një thirrje skandaloze kur tha se shqiptarët duhet të ndalojnë së mësuari dhe foluri maqedonisht.

“Ekziston një mënyrë shumë praktike për të barazuar gjuhën shqipe me gjuhën maqedonase: të sillemi tamam si bashkëqytetarët tanë maqedonas që nuk studiojnë dhe nuk flasin shqip... Të kemi institucionet tona, ku ata do të vijnë me përkthyes në gjuhën e tyre, dhe ne do të vijmë tek ata me përkthyes në tonën.

Ndoshta ata që e duan vetëm shqipen e vdekur dhe që nuk duan një Maqedoni ku flitet edhe shqip, do ta kuptojnë vetëm këtë ‘gjuhë’! Dhe ndoshta vetëm në këtë mënyrë qarqet antishqiptare maqedonase do ta kuptojnë se mirësia jonë në njohjen e të gjitha karakteristikave të tyre etnike dhe gjuhësore nuk është dobësi, as nënshtrim ndaj autoriteteve maqedonase. Ndërkohë, duhet pranuar se sundimtarët maqedonas i trajtojnë shqiptarët këtu me përbuzje, sepse vasalët nga Vredi bëjnë politikë me pantallona ulur!”, tha Mehmeti.

“Ngjarjet e ditëve të fundit tregojnë qartë se

përpyjekjet për të shtypur të drejtat gjuhësore të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut nuk çojnë në integritim, por në konflikte të ashpra. Kombinimi i arbitraritetit policor në kufij, drejtimi i qytetarëve të huaj në kufirin serb, skandaleve diplomatike dhe radikalizimit të diskursit publik krijon një precedent të rrezikshëm. Shkupi po merr rrezikun e zgjimit të fantazmave të vjetra të ndarjes etnike, duke përzier refleksët e një modeli të kaluar autoritar dhe pro-serb me albanofobinë e hapur institucionale”, shkruan BGNES.

Portali shton se simbioza midis shqipes dhe shërbimit ndaj interesave të huaja gjeopolitike është më qartësisht e dukshme në standardin e dyfishtë të qeverisë së Hristijan Mickoskit. Kërkesat e studentëve shqiptarë dhe mbështetja

diplomatike për ta cilësohen si “ndërhyrje e huaj” e rrezikshme, prandaj bllokohen kufijtë dhe thirren ambasadorët, ndërsa në të njëjtën kohë Shkupi mbyll sytë ndaj operacionalizimit të drejt-përdrejtë të “Botës Serbe” në tokën maqedonase.

“Në vend të një përgjigjeje të vendosur shtetërore ndaj këtij rrjeti të huaj ndikimi, Kryeministri Mickoski zgjodhi rrugën e intrigave politike. I detyruar të komentonte mbi skandalin, ai u fsheh pas frazave boshe se qeveria “nuk ka ndërmend të ndërhyjë në politikat e pavarura të vendeve të tjera”, duke e shfrytëzuar me nxitim rastin për të sulmuar përsëri opozitën shqiptare (BDI), duke e fajësuar atë për problemin 20-vjeçar të pazgjidhur të studentëve”, shkruan portali.

AKADEMIA SHQIPTARO-AMERIKANE E SHKENCAVE DHE ARTEVE MBËSHTET PROTESTËN E STUDENTËVE SHQIPTARË NË MAQEDONINË E VERIUT

Akademia Shqiptaro - Amerikane e Shkencave dhe Arteve mbështet protestën e studentëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, kërkesa kryesore e të cilëve mbetet zhvillimi i provimit të jurisprudencës në gjuhën shqipe.

Bordi Drejtues i AAAS e konsideron këtë një të drejtë themelore dhe pjesë të garantuar të barazisë në arsim dhe administratë, duke theksuar rëndësinë e respektimit të gjuhës amtare në procesin e formimit profesional.

Në mbështetje të tyre ka reaguar Kryetari i AAAS akademik Prof. dr. Skënder Kodra, i cili deklaroi se mbështetja e këtij institucioni akademik që Ai drejton ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave gjuhësore dhe arsimore, të cilat sipas tij janë fituar edhe përmes proceseve ndërkombëtare.

Prof. Kodra thekson se studentët shqiptarë nuk po kërkojnë privilegje, por zbatimin e një të drejte bazike për të studiuar dhe për t’u vlerësuar në gjuhën e tyre amtare, në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare.

Kreu i AAAS vlerëson se, gjuha përfaqëson një element thelbësor të identitetit dhe dinjitetit kombëtar, ndërsa shoqëritë demokratike maten nga mënyra se si trajtojnë komunitetet dhe garantojnë barazinë para ligjit. Prof. Kodra nënvizon se kërkesa e studentëve është legjitime dhe duhet të trajtohet me zbatim konkret të ligjit, jo me justifikime administrative.

REAGIMI

AAAS, përherë pjesë e protestave në Nju Jork dhe Çikago, për alarmimin e pozitës së rënduar të shqiptarëve në Maqedoni

PADREJTËSIA HISTORIKE E EVROPËS NDAJ SHQIPTARËVE



Shahbaze VISHAJ- GRAJÇEVCI

- **Akademia Shqiptaro Amerikane e Shkencave dhe Arteve, në kry me Prof.Dr. Skënder Kodra - kryetar, po ndjek me shqetësim të madh situatën e fundit në Kumanovë, ndaj kërkohet që partitë kombëtare shqiptare dhe spektri i gjerë i intelektualëve dhe personaliteteve të pastra publike në Maqedoni, të bashkohen si kurrë më parë dhe të bisedojnë konkretisht për kërkesat legjitime me dekada të tëra të shqiptarëve, të cilat edhe pas marrëveshjes së Ohrit, nuk u implementuan kurrë, por mbeten të mbyllura në sirtarë**

Shpesh flitet për normalizimin e rajonit të Ballkanit dhe integrimin e shpejtë në BE, por një gjë e tillë është larg sepse nuk janë zgjidhur çështjet e popujve që përbejnë shtetet e Ballkanit. Siç shihet Padrejtësia historike e Evropës ndaj shqiptarëve është plagë që duhet të shërohet urgjentisht, në të kundërtën pasojat do të jenë të pabara edhe për vetë- Evropën. Zgjidhja e çështjes së shqiptarëve përkundër kompromiseve të bëra nuk ofrojë zgjidhjen për stabilitet të qëndrueshëm në këtë Gadishull. Fundja, stabilitet s'mund të ketë kur të gjithë janë kundër shqiptarëve dhe

të drejtave të tyre në shtetet ku jetojnë? Andaj situata destabilizuese e sponsorizuar nga faktori politik, përkatësisht Qeveria e Maqedonisë, kërkon reagim të menjëhershëm të faktorit ndërkombëtarë dhe dorëheqjen e parevokueshme të Gruevskit me të tjerë.

Akademia Shqiptaro Amerikane e Shkencave dhe Arteve, në kry me Prof.Dr. Skënder Kodra - kryetar, po ndjek me shqetësim të madh situatën e fundit në Kumanovë, ndaj kërkohet që partitë kombëtare shqiptare dhe spektri i gjerë i intelektualëve dhe personaliteteve të pastra publike në Maqedoni, të bashkohen si kurrë më parë dhe të bisedojnë konkretisht për kërkesat legjitime me dekada të tëra të shqiptarëve, të cilat edhe pas marrëveshjes së Ohrit, nuk u implementuan kurrë, por mbeten të mbyllura në sirtarë. Shqiptarët janë me rrënjë të lashta dhe se as Mbretër e as Krajli s'kanë mund t'i" zhdukim", e lërë më Z. Janukollovska me bashkëpunëtorë e bashkëmendimtarë. Ajo me të tillë ka sjell tragjedi, dhunë, tmerr, situatë të jashtëzakonshme dhe pasoja të paparashikueshme për vendin, për të cilat duhet të marrë dënimin e merituar. Unifikimi dhe bashkërendimi i kërkesave të shqiptarëve është i dimosdoshëm, ndaj hapërimi drejt së ardhmes është i pandalshëm.

Prof.dr. Skender Kodra, kryetar i Akademisë Shqiptare – Amerikane të Shkencave (The Albanian American Academy of Science – AAAS) theksoi se ka reaguar edhe para ngjarjeve të fundit (ndodhur para rastit Kumanova), lidhur me tensionimet e situatës në Maqedoni dhe gjendjen e shqiptarëve atje. Kjo Akademi ishte dhe do të jetë përherë pjesë e protestave në Nju Jork dhe Çikago, për alarmimin e pozitës së rënduar të shqiptarëve në Maqedoni.

REAGIMI

KUR TRANZICIONI BËHET SISTEM



Agred Tafaj Avokat në Londër*

Për më shumë se tre dekada, pothuajse çdo problem i Shqipërisë është justifikuar me të njëjtën shprehje: jemi ende në tranzicion. Në teori, tranzicioni ishte menduar si një periudhë kalimtare, një etapë e domosdoshme për ta nxjerrë vendin nga sistemi i vjetër dhe për ta çuar drejt një demokracie funksionale. Por, pas më shumë se tridhjetë vitesh, pyetja që shtrohet natyrshëm është: a jemi ende në tranzicion, apo tranzicioni është bërë vetë sistemi?

Një tranzicion nuk matet me kalimin e viteve, por me arritjen e objektivave të tij. Ai përfundon kur shteti ndërtohet mbi ligjin dhe jo mbi individët, kur institucionet funksionojnë pavarësisht se kush qeveris dhe kur qytetari ndihet i mbrojtur nga sistemi, jo i varur prej tij. Nga shprehja e pakënaqësive të protestuesve sot, duket se ende, shumë prej objektivave mbeten ende të parealizuara. Sot, jetojmë në një sstem hibrid, ku ekonomikisht pretendojmë tregun e lirë, politikisht pretendojmë demokracinë, por praktikisht vazhdojmë të përballemi me institucione të varura nga drejtues politikë, drejtësi të kontestuar dhe një kulturë politike ku pushteti ka treguar se ka më shumë forcë se ligji. Forma ka ndryshuar, por mekanizmat e kontrollit kanë mbetur të njëjtë.

Në komunizëm, kontrolli ushtrohej hapur përmes partisë, censurës dhe ekonomisë së centralizuar. Në demokraci, pushteti duhet të kufizohet nga ligji, institucionet e pavarura dhe konkurrenca e lirë. Shqipëria sot mbetet një sistem hibrid: zhvillojmë zgjedhje dhe kemi ekonomi tregu, por ndikimi politik mbi administratën, punësimet publike, shpërndarjen e fondeve dhe presioni ndaj institucioneve të varura e të pavarura tregojnë se pushteti vazhdon të ketë më shumë forcë se rreg-

ullat që duhet ta kufizojnë atë. Nëse dikur dhuna ishte ideologjike, sot ajo shfaqet në forma më të sofistikuar, si ajo psikologjike dhe ekonomike.

Në thelb, tranzicioni shqiptar nuk ka qenë vetëm një proces transformimi. Ai është kthyer në një mekanizëm që riprodhon vazhdimisht vet-veten. Çdo krizë politike, çdo valë emigrimi, çdo protestë apo zhgënjim qytetar rikthen të njëjtën pyetje: pse ende nuk kemi arritur atë ku duhet të kishim mbërritur prej kohësh? Ndoshta sepse një tranzicion i përfunduar do të nënkuptonte institucione më të forta se individët, ligj më të fortë se pushteti dhe qytetarë më të lirë nga varësitë politike. Dhe pikërisht këtu qëndron paradoksi: sa më gjatë zgjat tranzicioni, aq më shumë përfitojnë ata që e menaxhojnë atë.

Prandaj, sfida jonë sot nuk është të reformojmë tranzicionin, por ta mbyllim atë. Dita e 6 e protestës po tregon se ne nuk po dalim në protestë vetëm për Projektin e Zvërnecit apo Ndërtimet e Rriollit, apo paketën e maleve. Ne po dalim për gjithçka që nuk ka ndryshuar prej vitesh. Po dalim sepse pas më shumë se tre dekadash tranzicion, shumë prej nesh ende ndihen të pambrojtur përballë shtetit, të papërfaqësuar nga politika dhe të zhgënjyer nga institucionet. Protesta është zëri i një pakënaqësie që është mbledhur ndër vite. Është reagimi i atyre që besojnë se tranzicioni, i cili duhej të sillte demokraci funksionale dhe shtet ligjor, është kthyer në një gjendje të përherëshme ku premtimet përsëriten, por problemet mbeten të njëjta. Dhe ndërsa ngremë zërin kundër kësaj gjendjeje, a jemi gati të kërkojmë jo vetëm fundin e një padrejtësie, por fundin e vetë tranzicionit që e ka prodhuar atë? Sepse asnjë shoqëri nuk mund të ndërtojë të ardhmen duke jetuar pafundësisht në një gjendje kalimtare. Një komb nuk mund të ecë përpara kur çdo brez rritet me premtimin se ndryshimi i vërtetë do të vijë nesër.

Dhe nëse pas më shumë se tridhjetë vitesh vazhdojmë të jetojmë ende në tranzicion, a nuk është koha të pyesim nëse ai ka dështuar të përfundojë, apo është mbajtur qëllimisht i papërfunduar?

**Ish student protestues i protestes studentore 2018.*

REAGIMI

180 vjetori i datëlindjes të madhit Naim Frashëri

BASHKIA PËRMET SHPALL QYTETAR NDERI XHEVAT LIMANIN!

PO STRUGA ÇFARË PRET?!!!



Akademik Agim Dauti

Është 180 vjetori i lindjes së poetit tonë të madh Naim Frashëri!

Veç vitit jubilar dhe manifestimit të mbajtur për nder të të madhit Naim në Përmet, një manifestim që na nderon jashtë mase, nder dhe krenari për mbarë kombin në veçanti për Strugën ishte sepse Bashkia Përmet shpalli QYTETAR NDERI aktorin, regjisorin, poetin shkrimtarin dhe atdhetarin MBRETI I SKENËS Xhevat Limani !

I nderuar Xhevat, të nderoi Presidenti i Shqipërisë dhe të DEKOROI me çmimin më të lartë KALORSI I URDHËRIT TË SKËNDERBEUT, të shpallin Qytetar Nderi gati të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe Kosovës, të nderojnë dhe dekorojnë me tituj dhe Mirënjohje të ndryshme vëllezërit arbëreshë, të nderon Franca dhe Anglia, Gjermanija dhe Spanja, po Shkupi çfarë pret, kur veprat flasin vetë sepse Teatrin Shqiptar në Shkup e mbajte gjallë me dekada, edhe atëherë kur Presidentë të ndryshëm të ofruan kolltuqe mëndafshi dhe një llogari ekstra në bankë, ti ngelle i varfëri më i pasur prej gjithë botës! Atëherë të nderuan me atentat, ty nuk t'u dridh qerpiku!

Po i lë të gjithë këto Shkup e Tetovë, Gostivar dhe Kërçovë, të faltë Perëndija po Struga çfarë suksesi tjetër pret që t'i sjellësh! E kuptova ish udhëheqësin e vjetër, po pres këtë të riun, ndoshta e bën një hap atdhetarije, ska gjë mos u mërzi TI JE NJERI PERENDIJE!

E moj Strugë, Ti nuk e di çfarë pasurie ke...

PAK NGA CV E XHEVAT LIMANIT

Xhevat Limani, u lind më 1 janar 1953 në Fierishtë të Strugës (Maqedoni).

Diplomoi në Akademinë e Arteve të Bukura në Prishtinë.

Ka luajtur në një varg rolesh në teatër dhe në disa filma artistikë.

Është skenarist dhe regjisor i filmit të parë shqiptarë në Maqedoni, me titull "Fatprerët".

Është pedagog i lëndës së aktrimit në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit të Tetovës.

Ka fituar një varg çmimesh dhe mirënjohesh



kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prej vitit 2002 punon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku ka realizuar disa shfaqje.

DISA PREJ VEPRAVE LETRARE

Xhevat Limani ka shkruar, botuar dhe promovuar disa vepra letrare: prozë, poezi, drama etj, të vlerësuara nga lexuesi e kritika letrare, disa prej të cilave janë:

"Nuk ishin vetëm" (film dokumentar për shqiptarët e Amerikës në luftën e UÇK-së).

"Pranverë dimërore" - poezi;

"Albaniada" - dramë;

"Artisti pa Atdhe" (roman);

"Dodona" - dramë;

"Ora shqiptare";

"Demoniada";

"Antimemorandum";

"Anatema";

"Hijet";

"Gjergj Kastrioti - Skenderbeu";

"Muri i lotëve";

"Unë Adem Jashari".

INTEGRIMI

Nga korridoret e Brukselit te prova reale e shtetit shqiptar

SHQIPËRIA NË PRAGUN E EVROPËS



Nga Spartak Fikaj
Bruksel | 26 Maj 2026

- **Pas buzëqeshjeve ceremoniale dhe gjuhës së kontrolluar diplomatike, mesazhi real ishte shumë më i thellë: Brukseli po sinjalizonte se Shqipëria nuk trajtohet më vetëm si një vend kandidat nën monitorim, por si një pjesë potenciale e arkitekturës strategjike të Bashkimit Evropian. Dhe kjo ndryshon rrënjësisht natyrën e negociatave**



Në zemër të lagjes evropiane të Brukselit, aty ku burokracia shpesh mbulon historinë me gjuhë teknike dhe formulime diplomatike, Shqipëria hyri këtë javë në një nga momentet më delikate dhe më domethënëse të rrugëtimit të saj drejt Bashkimit Evropian.

Në pamje të parë, Konferenca e 8-të Ndërqeveritare Shqipëri-BE dukej si një tjetër takim rutinë mes diplomatëve evropianë dhe delegacionit shqiptar. Kamerat ishin vendosur në hyrje të ndërtesës së Këshillit të BE-së, gazetarët prisnin deklaratat zyrtare, ndërsa delegacionet hynin dhe dilnin mes protokollit të zakonshëm evropian.

Por pas buzëqeshjeve ceremoniale dhe gjuhës së kontrolluar diplomatike, mesazhi real ishte shumë

më i thellë: Brukseli po sinjalizonte se Shqipëria nuk trajtohet më vetëm si një vend kandidat nën monitorim, por si një pjesë potenciale e arkitekturës strategjike të Bashkimit Evropian. Dhe kjo ndryshon rrënjësisht natyrën e negociatave.

Një fjali që kaloi pa u kuptuar në Shqipëri

Deklarata më e rëndësishme e ditës nuk erdhi nga Tirana. Ajo erdhi nga Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian. Marilena Raouna, zv/ministre për Çështjet Evropiane e Qipros, deklaroi: “Enlargement is a geopolitical necessity for the EU.” Në shqip: “Zgjerimi është një domosdoshmëri gjeopolitike për Bashkimin Evropian”.

Në Bruksel, fjalët peshohen me kujdes ekstrem. Dhe kjo fjali tregon një ndryshim historik në mënyrën se si BE e sheh Ballkanin Perëndimor. Dhjetë vite më parë, zgjerimi diskutohej si proces teknik: reforma, kapituj, standarde, administratë. Sot, pas luftës në Ukrainë dhe tensioneve në rritje globale, zgjerimi shihet si çështje sigurie strategjike. Në korridoret evropiane ndihej qartë se Ballkani nuk po diskutohej më vetëm si projekt integrimi, por si pjesë e mbrojtjes politike dhe gjeostrategjike të kontinentit. Kjo është arsyeja pse Shqipëria ka fituar një rëndësi të re në sytë e Brukselit.

Çfarë ndodhi realisht në konferencë?

Në aspektin teknik, Bashkimi Evropian konfirmoi se Shqipëria ka përmbushur të ashtuquajturat: “Interim Benchmarks” për Klasterin 1 — “Themeloret”.

Për publikun e zakonshëm, kjo mund të tingëllojë si terminologji burokratike pa shumë kuptim.

Por në strukturën e negociatave evropiane, ky është një nga momentet më kritike të gjithë procesit të anëtarësimit. Sepse “Themeloret” nuk janë thjesht një grup kapitujsh.

Ato janë zemra politike e negociatave.

Brenda këtij klasteri ndodhen: drejtësia, shteti ligjor, korrupsioni, institucionet demokratike, administrata publike, ekonomia funksionale, liria, siguria, dhe të drejtat themelore.

Pikërisht këto fusha kanë qenë për vite të tëra

pika më e dobët e Shqipërisë në raport me Bashkimin Evropian. Dhe pikërisht këtu Brukseli ka qenë më skeptik.

Momenti që ndryshon gjithçka

Ajo që shumë media shqiptare nuk e shpjeguan mjaftueshëm është rëndësia reale politike e këtij vendimi. Deri tani, Shqipëria ndodhej në fazën e hapjes së kapitujve. Pas kësaj konference, Shqipëria hyn në fazën e mbylljes së tyre. Dhe në negociatat evropiane ekziston një rregull i pashkruar që diplomatët në Bruksel e përsërisin shpesh: “Kapitujt mund të hapen politikisht. Por mbyllen vetëm me prova.” Kjo është arsyeja pse dokumenti zyrtar i BE-së përdor me shumë kujdes shprehjen: “solid track records and lasting results.” Në gjuhën diplomatike të Brukselit kjo do të thotë: jo më reforma në letër, jo më premtime politike, jo më retorikë për Evropën, por rezultate konkrete dhe të qëndrueshme. Dënime reale. Institucione funksionale. Pavarësi e drejtësisë. Luftë e vazhdueshme kundër korrupsionit. Jo për disa muaj. Por për vite.

“SPAK”, fjala që dëgjohej më shpesh në bisedat informale

Në deklaratat publike, zyrtarët evropianë ruajtën gjuhën klasike diplomatike. Por në diskutimet joformale mes gazetarëve, diplomatëve dhe analistëve në Bruksel, një emër përmendej vazhdimisht: SPAK.

Për vite me radhë, Shqipëria është perceptuar në Evropë si një shtet ku korrupsioni politik dhe ndikimi mbi institucionet ishin pjesë strukturore e sistemit.

Reforma në drejtësi dhe krijimi i SPAK-ut kanë ndryshuar pjesërisht këtë perceptim. Megjithatë, skepticizmi nuk ka zhdukur. Përkundrazi. Shumë diplomatë evropianë besojnë se testi i vërtetë fillon tani: nëse institucionet anti-korrupsion do të mund të funksionojnë të pavarura edhe kur përballen me presione të mëdha politike dhe ekonomike.

Pikërisht për këtë arsye, deklaratat e Komisioneres për Zgjerimin, Marta Kos, u interpretuan në Bruksel si një mbështetje e kujdesshme — por jo si një çek i bardhë për Tiranën. Mesazhi i saj ishte i qartë: Reformat duhet të vazhdojnë. Dhe rezultatet duhet të jenë të pakthyeshme.

Deklarata e Edi Ramës dhe mesazhi i fshehur për Evropën

Një nga momentet më interesante të ditës erdhi gjatë komunikimit të Kryeministrit Edi Rama me

mediat.

Kur u pyet mbi debatet e brendshme në Bashkimin Evropian për të drejtën e vetos së shteteve të ardhshme anëtare, Rama deklaroi: “Ne jemi fanatikë të Bashkimit Evropian.” Në Shqipëri, kjo fjali u interpretua kryesisht si deklaratë politike pro-evropiane.

Në Bruksel, ajo u lexua ndryshe. Ajo ishte një sinjal i drejtpërdrejtë për vendet skeptike të Evropës: Francën, Holandën dhe disa shtete veriore, që kanë frikë se zgjerimi mund të sjellë brenda Unionit vende problematike apo destabilizuese.

Në thelb, Rama po përpiqej t’i siguronte partnerët evropianë se Shqipëria nuk synon të bëhet një “Hungari e re” brenda BE-së. Ishte një mesazh i menduar me kujdes. Dhe në Bruksel, mesazhe të tilla dëgjohej me shumë vëmendje.

Lufta reale sapo ka filluar

Pavarësisht atmosferës optimiste të konferencës, askush në institucionet evropiane nuk po flet për anëtarësim të afërt automatik. Përkundrazi. Shumë zyrtarë evropianë e shohin këtë moment si hyrjen e Shqipërisë në fazën më të vështirë të negociatave. Sepse tani Bashkimi Evropian nuk do të gjykojë më premtimet politike.

Do të gjykojë: funksionimin real të shtetit, rezistencën e reformave, pavarësinë institucionale, dhe aftësinë e Shqipërisë për të ndërtuar standarde evropiane të qëndrueshme.

Në Bruksel ekziston ende një pyetje që shumë diplomatë nuk e bëjnë publikisht, por që ndihet në çdo diskutim serioz mbi Shqipërinë: A janë reformat shqiptare të forta mjaftueshëm për t’i mbijetur ar presionit politik të së ardhmes?

Pikërisht kjo pyetje do të përcaktojë ritmin e kapitujve që do të mbyllen në vitet e ardhshme.

Një moment historik - por jo fundi i historisë

Konferenca e 8-të Ndërqeveritare nuk ishte fundi i rrugës evropiane të Shqipërisë.

Ajo ishte momenti kur Bashkimi Evropian i tha Tiranës: “Ju keni hyrë në fazën ku fjalët nuk mjaftojnë më.” Dhe ndoshta për herë të parë pas shumë vitesh, pyetja në Bruksel nuk është më:

“A dëshiron Shqipëria të bëhet pjesë e Evropës?”

Pyetja reale tani është shumë më e vështirë: A është Shqipëria gati të funksionojë si një shtet evropian — edhe kur askush nuk e sheh?

OPINION

KOSOVA NË NATO, KËSHTJELLË E INTERESAVE TË SHBA NË RAJON



Gjeneral[®] Piro Ahmetaj

- **Anëtarësimin në NATO, mbrojtjen e sovranit të Kosovës, si dhe zhvillimin e interesave gjeopolitike (kombëtare) në rajon, dy shtetet sovraane, pra RSh dhe Kosova, do mund t'i realizojnë vetëm duke forcuar më tej bashkëpunimin strategjik me ShBA**

E kam ndjekur me vëmendje të shtuar rezolutën e prezantuar më 30 prill në Kongresin Amerikan nga kongresmeni republikan Keith Self, së bashku me dy kolegët e mirënjohur, Ritchie Torres dhe Mike Laëler, e cila në thelbin e saj argumenton rëndësinë strategjike që mbart për ShBA anëtarësimi i Kosovës në NATO!

Me këtë rast, nuk mund të mos shpreh revoltën, për të mos thënë neverinë, ndaj mungesës cinike të vëmendjes që mori nga politika e ditës, si dhe mediat në Prishtinë dhe Tiranë kjo rezolutë historike për ardhmërinë në NATO, si dhe interesat gjeopolitike të Kosovës.

Por në pamundësi për përgjigje të dedikuar studiove televizive, gazetave dhe portaleve të interesuara, në vijim gjeni përmbledhje rreth peshës gjeopolitike që mbart kjo rezolutë jo vetëm për anëtarësimin e Kosovës në NATO, paqen dhe stabilitetin demokratik të rajonit, por edhe për mbrojtjen e statusques/interesave gjeopolitike të SHBA në Ballkanin Perëndimor: Nga njëra anë, konsideruar kohën, mjedisin e sigurisë si dhe përmbajtjen e “mençur”, citojmë: “..anëtarësimi i Kosovës në NATO do të shërbente si kundërpërgjigje e domosdoshme për

të penguar përpjekjet armiqësore si dhe për të parandaluar shpërthimin e një katastrofe tjetër globale në Ballkan”, këtë rezolute e çmoj si: “konfirmim të besimit dhe peshës që mbart Republika e Kosovës për të mbrojtur supremacinë afatgjatë të ShBA ndaj Rusisë dhe Kinës, si dhe për të zhvilluar interesat gjeopolitike të USA në Ballkanin Perëndimor”.

Kështu, kjo rezolutë, që e sheh anëtarësimin e Kosovës në NATO (krahas RSh) si qendrën e gravitetit, nuk është një akt i shkëputur i 3 kongresmenëve, as një rezolutë e ngjashme 1 vit më parë, por demonstron vendosmërinë strategjike të SHBA, si dhe projektin Trump-2: “Interesat e USA mbi gjithçka, amerikanët mbi të gjitha”! Si shëmbull ilustrues të këtij zinxhiri vazhdimësie, mjafton të sjellim në kujtesë edhe “marreveshjen Trump-1”, nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në shtator 2020, ose paketën me: “njohjen nga Izraeli, autostradën e paqes Beograd-Prishtinë, Port në ujërat e thella të Adriatikut, etj”.

Nga ana tjetër, këtë rezolutë nuk e gjej kurresesi rrufe në qiell të hapur; as produkt të (pa) fuqisë së lobeve shqiptare në Ëashington DC (të cila/ët përtej protagonizmit folklorik prodhojnë produkte shumë të dobëta), aq më pak si: “si qokë të SHBA ndaj kryeministrit në detyrë Kurti apo si dhuratë pa-fuqisë së konkurrentëve të pushtetit në Prishtinë”, POR si: “përgjegjësi të shtuar të Prishtinës zyrtare (imediatisht edhe për Tiranën) për të tejkaluar krizën politike, luftën staliniste për pushtet, si dhe rikthimin e besimit te demokracia funksionale, ardhmëria euroatlantike e Kosovës si dhe interesave kombëtare (fatmirësisht) të ndërthurur edhe me interesat e SHBA në rajon dhe Mesdhe”.

Prandaj, duke përsëritur përueljen për gjakun e derdhur në shekuj, si dhe nderimin për sakrificat sublime të shqiptarëve të Kosovës, nuk mund të mos e shtojmë edhe këtë rezolutë historike, ose mbështetjen (për anëtarësimin e Kosovës në NATO) në murin e mirënjohjes kombëtare ndaj “çlirimtarëve të vërtetë të Kosovës”, edhe për vetë

peshën kritike që ato/SHBA-të vijnë ende të mbajnë jo vetëm për ardhmërinë euroatlantike të Kosovës, por edhe për bashkëjetesën paqesore dhe stabilitetin demokratik të rajonit.

Në shtesë, kjo rezolutë historike konfirmon Kosovën si qëndër të gravitetit/fortesë të SHBA-ve ndaj kundërshtarëve gjeopolitikë, ose armiqve potencialë (Kremlinit & Pekinit), shërben edhe si mesazh/ofertë Euroatlantike ndaj 4 vëndeve anëtare të NATO-s që nuk kanë njohur ende Kosovën (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja), duke nën/mirëkuptuar faktin që pa votën e qoftë njërit prej tyre, anëtarësi i Kosovës në NATO mbetet gjithësesi mision i pamundur. Ndaj posaçërisht dalldosjes të Vuçiç-it nga “marrëveshja mes Kroacisë, Kosovës dhe RSh”, mbështetja e SHBA për rritjen e fuqisë mbrojtëse (modernizimin e FSK me raketa Javelin), përfshi nga kjo rezolutë për anëtarësimin në NATO, shërbejnë edhe si një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj “armatosjes deri në dhëmbë të Serbisë”, me tanke, 18 Mig-29, 12 Rafale, Mi-35, raketa, dronë sulmi të gjeneratës së fundit etj!?. Gjithësesi, jo vetëm për oshilacionet e neo-milloshëve në Beograd, më duhet ta përsëris edhe më qartë se: “për sa kohë të ketë prezencë të SHBA (Bondsteel), agresioni ushtarak kundër sovranitetit të Kosovës (njëherësh përgjegjësi e KFOR-it), përveçse aventurë vetëvrasëse mbetet mision tërësisht i pamundur”.

Në vijim, gjeni edhe: “pesë gjetje dhe rekomandime gjeo-strategjike”:

- Anëtarësimin në NATO, mbrojtjen e sovranitetit të Kosovës, si dhe zhvillimin e interesave gjeopolitike (kombëtare) në rajon, 2 shtetet sovraane, pra RSh dhe Kosova, do mund t’i realizojnë vetëm duke forcuar më tej bashkëpunimin strategjik me SHBA. Kështu, edhe për Enveristët e vetëmbrojtjes sovraane, ngrihet një pyetje e thjeshtë: “Nëse përkundërt të mbështetjes së SHB, konfirmohet tërheqja e trupave ushtarake Amerikane/NATO nga Kosova (që sigurisht një ditë do të ndodhë), kush është opsioni 2 i Prishtinës zyrtare për të mbrojtur integritetin teritorial dhe interesat gjeopolitike të kombit”!?
- Prishtina zyrtare nuk duhet kurrësesi të ndër-



marrë vendimmarrje që minojnë themelet dhe klimën e (mirë) besimit me “çlirimtarët e vërtetë”, pra me SHBA-të që ende mbajnë peshë kritike për paqen, sigurinë, stabilitetin demokratik, për ardhmërinë euroatlantike të Kosovës dhe interesat kombëtare.

- Mbetet emergjencë nr. 1 ngritja e një “grupi të urtësh/ëise group”, me personalitete/elita të mirënjohura dhe gjerësisht pranuar, që përtej luftës staliniste apo pazareve për pushtet, të përuhen para interesave kombëtare dhe përgjegjësive shtetërore për ta jetësuar platformën: “2-shtete sovraane, 1-komb i vetëm”.
- Për faktorët, aktorët dhe strategjistët/kolegët në Ëashington, do sugjeroja që perspektivën e dialogut Kosovë–Serbi ta para-kushtëzojnë jo me “deliret bolshevike të pushtetarëve që venë e vijnë”, por mbi një matricë masash të mirëbesimit reciprok (CSBM), me 3 kushtet e sipërpërmendura.
- Së fundmi (5), besoj edhe më fort që kjo rezolutë, për rrjedhojë anëtarësimi i Republikës së Kosovës në NATO, do të shërbejë jo vetëm si kontribut i shtuar për ndërtimin e paqes, bashkëjetesën paqesore, si dhe ardhmërinë euroatlantike (NATO/BE) të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe si “kështjellë e përparuar” për mbrojtjen e statusques si dhe promovimin e interesave amerikane në rajon dhe mesdhe.

*Autori: Gjeneral * Piro Ahmetaj;
Senior Ekspert për Sigurinë Kombëtare,
Ballkanit si dhe marrëdhëniet me SHBA/NATO,
Ish: zv/SHSHP, Këshilltar i Presidentit si dhe,
Themelues i Përfaqësisë së RSh në SHAPE/
NATO!*

ADEM JASHARI, HEROI I LIRISË



Prof. dr. Akademik Flori Bruçi

- **Komandanti legjendar tani ishte kudo me UÇK-në, të dalë në skenë, që më 28 Nëntor 1997, në Llaushë, një ushtri që u bë shpresë për popullin dhe tmerr për armikun. S’mund të ishte ndryshe, sepse Adem Jashari kishte prejardhje nga një botë e lavdishme, që madhërisht po hynte dhe në legjendë**



Adem Jashari

Prishtinë, 2 mars 2026 -Nuk e mban mend kush në histori, që të flijohet gati një familje e tërë për lirinë e vendit. Dhe ja, ORA, urdhri për Liri a Vdekje tek erdhi në familjen Jashari të Prekazit. E tashmë të gjithë e dinë se festa e Flamurit është 28 Nëntori.

Mirëpo, kjo datë shënohet edhe si ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jashari, i lindur më 28 nëntor 1955. Në atë gëzim, të porsalindurin e mbuluan me flamurin e Skënderbeut.

Luftëtari i ardhshëm i lirisë u rrit dhe u edukua me frymën e atdhedashurisë nga babai Shaban Jashari, dhe duke dëgjuar për ngjarjet me përmasa kombëtare, si dhe këngë për heronj të mëdhenj. Ai nuk e duronte dot robërinë. E dinte kur duhej të fliste dhe të heshte. Një veti e luftëtarëve të mëdhenj të Kosovës dhe gjithandej trojeve etnike shqiptare. Amanetin e tyre për çlirimin e vendit do ta për-

jetësojë në luftën çlirimtare, me një emër tashmë emblemë: UÇK. Atëherë, duke ndërë se Kosova kishte shumë nevojë për t’u çliruar nga pushtuesi i tmerrshëm, Adem Jashari tuboi rreth vetes ndër djemtë më trima, të cilët kapën armët për të luftuar gjer në fitore.

Luftëtari i lirisë, ishte shfaqur edhe në vitet ’80-ta kur patën plasur demonstratat, ndërsa të ’90-tatë po hynte në aureolën e lavdisë për të shënuar një epokë të re në historinë e Kosovës. Ishte një strateg dhe komandant i zoti, ndërsa sikur ta kishin të tjerët do t’ia kishin lakminë dhe do ta kishin ngritur gjer në qiell.

Të rrosh apo të mos rrosh, këtë dilemë hamletiane, Adem Jashari s’e kishte dot në mendje. Ishte mëngjes i hershëm, me ankthe, i 30 dhjetorit 1991, kur armiku me një makineri të tërë policore kishte rrethuar lagjen e Jasharëve dhe kërkonte dorëzimin e komandantit. Por, ai me tërë familjen, me të afërmit dhe me shokë të luftës, armikut iu përgjigjen me breshëri armësh. Ishte kjo pushka e parë që krisi në Drenicë. Komandanti legjendar tani ishte kudo me UÇK-në, të dalë në skenë, që më 28 Nëntor 1997, në Llaushë, një ushtri që u bë shpresë për popullin dhe tmerr për armikun. S’mund të ishte ndryshe, sepse Adem Jashari kishte prejardhje nga një botë e lavdishme, që madhërisht po hynte dhe në legjendë.

Ai si Tezeu ia futi armikut frikën në shpirt, duke e sulmuar grykave, udhëkryqeve, stacioneve famëkeqe policore dhe kudo. Mirëpo, pushtuesi i tmerrshëm prapë në mëngjesin e 5 marsit 1998, ndërmoi edhe një sulm me forca të mëdha policore dhe ushtarake. Adem Jashari me familjen e vet, me Jasharët e tjerë, me ata që ndodheshin në ato momente rreth tij, sulmuan nga çdo anë; as jepeshin dot; dhe lufta zgjati tri ditë e tri net. Luftëtari i lirisë ndriti me ditë, duke dalë si nga baladat. Pas asaj lufte të tmerrshme, armiku dogji shtëpi, shkatërroi kullën e trimit dhe lagjen e Jasharëve, vrau madje dhe fëmijë, por kurrë vendosmërinë për të vazhduar luftën.

Në çastet më të ndjeshme, ai luftoi duke kënduar gjer në rënie; dhe nuk ishte vetëm. Jo, vdekja e tij nuk është vdekje. Ushtria Çlirimtare e Kosovës humbi prijësin e saj të madh, por fitoi komandantin legjendar, përgjithmonë i pavdekshëm, përgjithmonë në kujtesën e paharrueshme të popullit shqiptar. Tani çdo gjë është përjetësi...

ESSE

Para se të gjymtohej nga predhat e serbëve invalidi kishte qenë një lis i gjatë **INVALIDI I UÇK -SË I FIKSUAR NË NJË FOTOGRAFI NË SHESHIN “SKËNDERBEJ”?**

Kolonel Sefer PASHA

Në rreshtin e parë të protestës kundër Gjykatës së Hagës në mbrojtje të komandantëve të UÇK -së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, mes qindra dhe mijëra vetëve, ishin dhe invalidët e betejave me serbët. Ata ishin shumë dhe nuk munda që t'i numëroja.

Kur po fliste Alfred Moisiu munda të bëj një foto me një nga këta invalidë, i cili qe ulur në një stol dhe mezi mbahej mbi proteza. Fola me të. Nga tregimet e tij u trishtova. Ai më solli në sheshin “Skënderbej” betejat me serbët në Junik, Koshare, Gjakovë, Pashtrik dhe Reçak.

Para se të gjymtohej nga predhat e serbëve invalidi kishte qenë një lis i gjatë. Ishte martuar me një grua gjithashtu të bukur si vetja. Pas tragjedisë ai dhe e shoqja e vuanin masakrimin. Invalidi nuk ishte më ai i pashmi i Prishtinës, që kur kalonte të gjithë kthenin kokën.

Tek e dëgjoja rrëfimin e tij mu kujtua heroi Kanan Mazja, të cilin në Luftën e Vlorës të vitit 1920 italianët e plagosën dhe një plumb ja ndau më dysh nofullat e gojës. Pas operacionit

Kanan Mazja kurrë nuk i bashkoi të dyja nofullat. Dhe populli i Vlorës kur e pa të gjymtuar i këndoi: “*Kanan Mazja nga Shkoza//Me një nofull copa - copa//Kanan tu prish bukuria// Le të rrojë Shqipëria//Shqipëria le të rrojë//Çka se mbeta unë pa gojë*”.

E dëgjoja invalidin mes thirrjeve kundër padrejtësisë në Gjykatën e Hagës dhe belbëzoja me vete se nuk kisha hasur motiv më ngjethës se sa ky i këtyre minutave mes këtij sheshi, që gjëmon-te nga brohoritjet për luftën e UÇK -së. Në ato çaste mua më ngjante sikur këndohej kënga e Kanan Mazes dhe e invalidit nga Prishtina. Njëra në Vlorë për trimin pa nofulla dhe tjetri në Reçak me këmbët të sharruara nga mitralozi i serbve.

Në mes të brohoritjeve të mëdha mua më kërkuan që të bëja një fotografi me djalin e Hashim Thaçit dhe u largova. Por kur u ktheva invalidin nuk e gjeta më. E kishin marrë se ndjente dhimbje nga plagët e plumbave të serbve. U brengosa. Unë do të shkruaja një reportazh, ku në qendër do të ishte kënga e Kanan Mazes dhe ajo e pashkruara për invalidin e Reçakut në sheshin “Skënderbej”.

Po unë nuk i shënova dot as emrin, i thashë vetes me sytë nga tribuna ku po fliste Ali Ahmeti. Ku ta gjeja mes mijëra njerëzve heroin e reportazhit tim? Në asnjë skicë të thjeshtë letrare nuk më kishte ndodhur një “aksident” kaq i çuditshëm. Më humbi emri i personazhit kryesor. Fabula nuk më duhej më. Dhe nisa të vrapoj pas invalidëve që ishin të shumtë. Dhe nuk munda që ta gjeja dot. Por më shpëtoj fotoja që kisha bërë më të. Foton do ta shpërndaja. Ku i dihet? Mbase do t'i bjerë mi-kut tim dhe pastaj do të shkruajmë, jo një reportazh, por ndofta një roman.



ESSE

“Ishim ne, të djeshmit, të sotmit, të nesërmit/ Ishim ne Skënderbeu”

Fatos Arapi

KËNGËT E HIMARËS DHE POEZIA E FATOS ARAPIT PËR ZVËRNECIN



Nga Sefer Pasha

Të parët e mi në Mallakastër kanë punuar si bujq në bregdetin e jugut dhe dasmat hapeshin me këngë të krijuara në fshatrat e bregut të detit. Brigjeve të Himarës ata mësuan dhe shumë këngë. Qysh kur isha i vogël dëgjoja gjyshin të këndonte këngën:- /Kush je ti o Lule - djali?//Që na vjen nga Shqipëria?//Unë jan Smail Qemali//Prapa më vjen historia/. Për shkak të simbolikës po e përmend këtë këngë që në krye të herës se në historiografinë e botës së Ismail Qemalit vetëm këngët e asaj periudhe mbajnë kurorën e artë dhe se aureola e këtyre këngëve shërben si forca tërheqëse e dy poleve, paçka se si në Vlorë dhe Himarë është e njëjta mitologji aristokrate autentike pa ngjyrimë të veçanta. Dramaciteti i këtyre këngëve të trondit. Nuk ka piper në këtë qyp me mjalt. Me forcën e ftohtë sipërore, vidhë pas vidhë, në këtë ese do të meremi me këngët e Himarës dhe ato përqark saj. Agallarët e Himarës dhe të Kaninës i paguanin mirë të parët e mi. Në odën e burrave tregohej dhe një ngjarje e cila u kishte ndodhur bujqërve të fshatit tim. Një grup kishte shkuar të korrte elb në Himarë. Ishte zi buke. Bën pazarin me aganë e tokës të mbjell me elb. Dhe filluan të kornnin elbin, por qe e pamundur. E gjithë ara ishte e mbushur me ferra. Bujqërve ju bën duart me gjak. Dhe ata e lanë punën dhe në hijen e një gorrice ja morën këngës:

- /Kush është lule e vilajetit?//Himara në breg të detit/!. Agai himarjot e mori vesh se çfarë ndodhi dhe bujqërit e largët i ftoi në konak. Himarjoti i pagaoi pa bërë asnjë punë dhe ja mori këngës:- /Bijë Fterre//Nuse Çorre//Djalin më të mirë more//Po çë

do nuk u gëzove//Nga shkëmbinj të u lëshove/.

Një shoku im i fëmijësisë Astrit Çelaj banon në Himarë. Babi i tij qe martuar me një minoritare. Punonte në Himarë dhe në Mallakastër. Këto ditë që erdhi Ministri i Mbrojtjes i Greqisë Nikos Den-dias çelanjaku qe shumë kureshtar. Vet ministri i grek tha se ai ishte nga Himara. Prejadhja e tij e herëshme është Vuno. Kishte lindur në Korfuz. Kjo është normale u përgjigjem pyetjeve të shumta. Në Vuno ka lindur dhe është vrasë Zaho Koka, i dashuri i Ramize Gjebresë. Në odat e Himarës dhe të gjithë Labërisë këndohej kënga kushtuar Zaho Kokës:- / Bataljonet bëjnë fjalë//Lule Zaho, Lule djalë//Në Vuno e kanë vrasë//Vajton nëna me ngadalë//Mos ma thoni këtë fjalë//Se Zahon e kam të gjallë/. Në Himarë dhe në të gjithë labërinë këndohen këngë për dëshmorët e tjerë si Teli Ndni, Kastriot Muço, Shyqyri Alimerko, Fejzo Gjomemaj, Mitat Dauti, Lefter Sallata, Pirro Palla, Fiqiri Muka, Jani Mone, Fadil Dauti. Hajro Çakërri, Hysen Çino, Sulo Didi, Dardan Dajlani dhe trimi nga Gjilani i Kosovës Xheladin Beqiri. Pikërisht për emrin e mirë që gëzonte ky bir i Vunoit emri Zaho është i preferuar në Himatrë dhe në të gjithë Labërinë. Edhe një politikan që është njëkohësisht dhe piktor djalit ja vuri emrin Zaho. Nga hlumtimet e shumta del se jeta e himarjotëve është pothuajse biblike ashtu siç u tha që ministri grek i mbrojtjes i kishte rrënjët në Vuno. Njerëzit kanë qenë të lirë. Gruaja e famëshme suljote Dhespua ka bërë emër në Greqi. Në librin “Arvanitasit” të Aristidh Kolës në faqen 258 thuhet se “Dhespua nga nëna e saj e kish origjinën nga fisi i Shehëve. Dhe ish Kryeministri i Shqipërisë Mehmet Shehu ish nga kjo farë, pra pasardhës i saj”. Popullata në shekuj ka lëvizur. Toka mbetet aty me historinë e saj. Si tapi mbeten këngët, tregimet, legjendat e baladat. Vetëm shovinstët gërmojnë në varreza të paqëna, në enigma piramidash, lumenjesh e detesh. Ata i urrejnë këngët siç janë ato që i kanë krijuar në shekuj himarjotët. Për Gjergj Elez Alinë kanë treguar bijtë e Himarës. Në dasmat e Himarës është kënduar kënga: - /“Një kala në anë të gjollit//I ktheu gjoksin Stambollit//Një kala në anë të detit//I dolli

karshi dovetit/. Një nga këngët më të hershme të Himarës bën fjalë për Sulltan Sulejmanin e Dytë, i cili erdhi në vitin 1537 në krye të një ekspedite për të shtypur kryengritjen e popullit shqiptar. Kënga thotë: - /Ndalu Sulltan Sulejman// Nuk i njeh mirë këto anë//Me bixhak ta marin xhan/.

Kënga në formën e një poeme përmend vende konkrete si Qeparoi e Palasa ku janë zhvilluar luftimet. Të gjithëve na erdhi mirë kur dëgjuam se ministri i Mbrojtjes i Greqisë Nikos Dendias, i cili kishte lindur në Korfuz ishte me prejardhje nga Vunoi i Himarës në Shqipëri. Pra në dejet e ministrit grek kishte gjak shqiptari. Në rininë time kur botoja ndonjë poezi poeti tragjik nga Çorrajt Viktor Qurku botoi poemën “Dielli dhe rrëkerat”. Viktori më recitonte këngët e vjetra të cilat këndoheshin dhe në Vunoi. Viktori e kishte pikë të dobët figurën mitologjike të Maro Kondës e cila i shëmbëllente Miro Tërbaçit, që për të marë hakën e të vëllait të vvarë nga turqit vajti tek berberi dhe i shkurtroi flokët si djal. Kur takoheshim me poetin tragjik ai ja merte labçe këngës himarjote të Maro Kodës. - /Turqit përpara ç’i more//S’more një po dy taborre// Në përrua i lëshove//Gjithë Çorrajt i nderove/. Maro Konda është një figurë mitologjike. Armiqtë e kishin zënë Maron duke mbushur ujë në majat e malit të Çikës dhe i kishin kërkuar të tregonte se ku fshiheshin fshatarët. Marua i tërhoqi në një kthesë dhe i gremisi në një hon. Edhe vet u hodh në hon. Edhe sot i thonë Honi i Maro Kondës. Marua kishte lindur në Ftërrë dhe qe martuar në Çorraj.

Këngët kushtuar Himarës janë pabarim. Ato që të gjitha fillojnë me vargun “Himarë e zeza Himrë!”. Ja disa nga vargjet:- /Himarë e zeza Himarë//Prapë e xheshe me Sulltanë//Qëndro si e ke zananë/. Një këngë e vitit 1930 e krijuar në Qeparo ka ca vargje që i kushtohen kapedanit Spiro Priftit: -/Kapedan o Spiro Prifti//Në hell të shkoi evgjiti// Evgjiti Isuf Arapi//të pikoi me dhjam cjapi//Dhjam e dyll të pikoi//Po dot besën nuk ta ndërroi/. Këngët e krijuara në Qeparo janë të shumta.- /Pashkë e Krishtit mos ardh kurrë//As për turq, as për kaurë// Se na e bëre detin urë//Korfuz të raftë tërmeti//Se nga ti na erdhi rënga//Na e solle hasmin brenda./ Dhe më poshtë thuhet:- /Seç na zuri malli//Malli na ka marë//O për vendet tona//Të zezën Himarë/.

Të gjitha luftërat shënojnë qartas këngët e lirisë që kanë hyrë në përjetësi e që gëlojnë tragjeditet si visare të rralla. Assesi ja disa nga vargjet kushtuar heronjëve të viseve të jugut si në motërzime në kufirin e mbramë e që janë shëmbëlltërrë e guximit - /Hajredini kalasjot//Dhe Kumiu i nivicjot//Stefan Prifti i Shënasjot//Qesko Hila i lukovjot//Milo Gjini piqerasjot//Hodo Beu i borshjot//Jano Milua himarjot//Kiço Koka nga Vunoi//Spiro Gjik Qeparoi//

Sot t’i gjejmë kararë//Prapë të jemi të pandarë// Si vëllezër shqipëtarë/. Dhe më poshtë një këngë tjetër trimash: -/Vjen hordhia nga Janina//Mbahu o Shahin Bej Delvina//Shahin bej o djalë mbreti//Ke taraf Bregun e detit. Në vargun e krijusve të bregut të detit të Himarës është dhe poeti universal Fatos Arapi, i cili ka lindur në Zvërnec të Vlorës. Këtë ai e përshkruan në poezinë autobiografike me titull:

- “Ecën nata e Zvërnecit tek unë”, ku midis të tjerave poeti shkruan: -/Ecën nata e Zvërnecit tek unë//Murmurimë e errët e siluetave të ullinjëve// Kërkon shtegun e humbur ku kaloi dje/. Më poshtë poeti i rrallë thotë se: -/Për ata të panumërtit që emër nuk kanë.....//Që në thirrjen e Gjergjit për lirinë ranë//...../Atdheu është dhimbje, është dhimbje// Një prill i pikëlluar në shpirt//Atdheu është kryqi, është kryqi//E mban - dhe të mban ty -në shpirt/. Ja dhe amaneti i poetit nga Zvërneci: -/Dhe kur të vdes//S’dua asgjë//Veç një varr të thjeshtë//...../Atje në breg të detit//Ku nëpër net//bisedojnë yjet me qeparisat/. Zvërnecasi Fatos Arapi merët me figurën e Skënderbëut, me Vrana Kontin, Moisi Golemin, Lekë Dukagjinin e të tjerë që “ishin kudo, ku ishte rreziku/. Kur përshkruan Skënderbeun poeti shkruan: - /Të tjerët kishin kështjella, principata, ndërsa ai kishte vetëm zëmërën e shpatës. Në këtë optikë të pashoqe këngët e Himarës me dritë të prushtë i këndojnë figurave historike: -/U ngre flamuri në Vlorë//Fol Ismail Vlora, folë!//...../Fushat me lule// Malet me dëborë//Qaj moj Himarë//Uluri e gjorë/. Në këngën: - “Vajmedet Çika me borë” thuhet:- / Nashti që të erdhi liria//Ti veshe rrobat e zisë//Se të pllakosi Greqia//Në bregdet të Shqipërisë//...../ Le ta dinë të gjithë armiqtë//Dhe Spiro Milo rrufjani//Se këtu ka zot vatani/. Kënga bën fjalë për shovinistët grek të cilët donin ta shpallnin Himarën si “Eparaqi autonome”..../Përposh deti e sipër mali// Vjen marshalli nga Himara//Në dyqan tek Kiço Sharra//Kapetan o Nase Labi/.

[Bëhet fjalë për kapetanin Nase Labin nga Vunoi, i cili nuk u dorëzua dhe armiqtë e vranë.

Nga hulumtimet për këngët e Himarës del se shumë këngë janë krijuar në fshatin Qeparo. Ja një këngë herëshme:- /O ju male me dëborë//Pse s’qani hallet e mija?//Që njeri s’më flet me gojë// Që nuk më do as njerëzia/. Ose: - /O kusure mos u soçi//U bëfshi sa mos u njofshi/. Shumë këngë fillojnë me fjalën “lule”. Me lulen bëhet krahasimi. Himarjotët siç i thonë në këngën për Zaho Kokën: - / “Lule Zaho, Lule djalë” kështu i thonë dhe Sofo Meksit nga Labova e Gjiroksters për të cilin Arben Duka ka shkruar një libër. Sofo Meksi u vra 19 vjeç në epopenë e Borshit. Ja dhe kënga e himarjotëve: - /Mu tek Borshi në të dalë//Lule Sofo, Lule djal// Seç të ra mortaja pranë/.

REFLEKSIONE

ÇAMËRIA NUK ËSHTË THJESHT NJË KUJTIM NË HISTORI



Akademik Arjan HAMITI

Çamëria nuk është thjesht një kujtim në histori. Është plagë në zemrën e çdo shqiptari që nuk harron rrënjët, gjakun dhe dhimbjen e të parëve të vet.

Sot, ndërsa zhvillohen vizita dhe buzëqeshje diplomatike, mijëra zemra çame vazhdojnë të presin një fjalë drejtësie, një pranim të së vërtetës dhe një shenjë respekti për ata që u dëbuan nga trojet e tyre vetëm pse ishin shqiptarë.

Ne nuk kërkojmë urrejtje ndaj askujt. Por nuk mund të pranojmë heshtjen ndaj një padrejtësie historike. Nuk mund të ndërtohet e ardhmja duke varrosur kujtesën e një populli.

Çamëria jeton në gjuhën tonë, në këngët tona, në lotët e gjyshërve tanë dhe në krenarinë që nuk u shua kurrë. Sa të ketë shqiptarë, do të ketë zë për Çamërinë.

Mbas vitit 1992, filluan shkrimet e para për ndriçimin e të vërtetave të hidhura për shqiptarët e Çamërisë; të tjetërsuara; të fshehura: të heshtura; të censuruara; të përndjekura, nga antikombëtarët, armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Në fillimet e viteve 90-të, siç thashë, filluan të botoheshin me ndrojtje shkrimet e para.

Vitet e fundit shkruhen e lexohen artikuj të shumtë, që vazhdojnë të plotësojnë boshllëqet historike të atij komuniteti (përfshi edhe përsëritjet) i goditur shumë rëndë dhe padrejtësisht nga egoja etno-fetare.

Drejtësia mund të vonojë, por kujtesa e një kombi nuk vdes kurrë.

Boshti kyresor i çështjes çame është drejtësia

për vrasjet, dëbimin dhe shpronësimin e shqiptarëve çamë nga autoritetet greke gjatë viteve 1912-1946.

Bilanci i muajve qershor-tetor 1944 në fund të Luftës së Dytë Botërore në Çamëri është:

- rreth 2.900 të vvarë të pafajshëm
- rreth 40.000 njerëz të dëbuar me dhunë
- 68 fshatra e qytete të grabitura e të djegura
- objekte të kultit (islam) të rrënuara



Më 30 qershor 1994, kuvendi shqiptar miraton ligjin 7839 "Për shpalljen e datës 27 qershor në kalendarin kombëtar si dita përkujtimore e genocidit të shovinistëve grekë ndaj shqiptarëve të Çamërisë". Dita e zgjedhur përkon me masakrën e 27 qershorit 1944 në Çamëri.

Në vitin 2004, kuvendi shqiptar miratoi një rezolutë që e detyron qeverinë të ngrejë çështjen çame në marrëdhëniet me Greqinë.

Në ndërgjegjen historike shqiptare, kjo çështje është ruajtur si një kauzë kombëtare. Por për ta kthyer këtë në realitet diplomatik, kërkohet një strategji shumë më serioze dhe konsistente nga shteti shqiptar. Vetëm përmes diplomacisë së durueshme, bashkëpunimit rajonal dhe presionit ndërkombëtar, çështja mund të ringjallet dhe të trajtohet në mënyrë të drejtë.

Çështja Çame nuk është vetëm histori – është një dëshmi e qartë e mënyrës se si padrejtësitë e së shkuarës mund të mbeten plagë të hapura për të ardhmen.

ARGUMENTE SHKENCORE

Analizë antropologjike mjekoligjore dhe sipas legjislacionit ndërkombëtar

VARREZAT E USHTARËVE GREKË NË SHQIPËRI DUHET TË TRANFEROHEN NË GREQI

Prof.Dr.Bardhyl Çipi

Anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Artit

- **Zbulimi i varreve të panjohura dhe identifikimi i mbetjeve të ushtarëve grekë të vrarë në Shqipëri, në luftën Italo-Greke të viteve 1940-1941, përbën pa dyshim një çështje që i takon shkencës së antropologjisë mjekoligjore, ku duhen respektuar gjithashtu një sërë rregullash që jepen me hollësi në literaturën bashkëkohore përkatëse**



Çështja e vendvarrimeve të mbetjeve të ushtarëve të vrarë në luftë dhe ndryshme, diskutohet gjerësisht në kohën e sotme, sepse respektimi i personave të rënë në luftë i bën shumë të ndjeshëm njerëzit që i vizitojnë monumentet dhe varrezat përkujtimore ku prehen mbetjet e tyre.

Sot në të gjithë botën ka shumë memoriale dhe varreza të tilla, që i bëjnë të njohur të rënë në luftë. Nga ana tjetër, mosrespektimi i të vrarëve në beteja ushtarake krijon ndjenja dëshpërimi në popujt e vendeve të ndryshme.

Në ekzaminimet e eshtrave njerëzore për qëllime të ndryshme: mjekoligjore, historike, antropologjike, arkeologjike etj., një rol me rëndësi ka respektimi i një sërë rregullash dhe parimesh etike.

Ato përshkruhen me hollësi në literaturën përkatëse dhe janë zbatuar nga ana jonë në të gjitha ekzaminimet identifikuese të mbetjeve humane në vendin tonë të rasteve kriminale dhe zbulimit të viktimave të regjimit komunist, apo të

ndonjë rasti të veçantë të mbetjeve të ndonjë ushtaraku italian të vrarë në luftën Italo-Greke 1940-1941.

Kohët e fundit në Shqipëri janë kryer zhvarrimet e kufo-mave të pazbuluara deri tani të ushtarëve grekë, të vrarë në luftën Italo-Greke të viteve 1940 – 1941.

Kryerja e këtyre veprimeve është mbështetur në një marrëveshje midis qeverive të Greqisë

dhe Shqipërisë, e shoqëruar me krijimin e një komisioni të përbashkët, të pasuar me këqyrjet identifikuese nga disa mjekë specialistë grekë si dhe mjekë ligjorë të institutit të mjekësisë ligjore në Tiranë.

Rregullat e antropologjisë mjekoligjore në ekzaminimet e mbetjeve të ushtarëve grekë të luftës Italo-Greke 1940-1941

Zbulimi i varreve të panjohura dhe identifikimi i mbetjeve të ushtarëve grekë të vrarë në Shqipëri, në luftën Italo-Greke të viteve 1940-1941, përbën pa dyshim një çështje që i takon shkencës së antropologjisë mjekoligjore, ku duhen respektuar gjithashtu një sërë rregullash që jepen me hollësi në literaturën bashkëkohore përkatëse.

Këto rregulla etike ne i kemi pasur parasysh gjatë ushtrimit nga ana jonë për një kohë shumë të gjatë të këtyre lloje ekzaminimesh.

Cilat janë këto rregulla dhe a janë marrë ato në konsideratë në këto identifikime mbetjesh kockore që drejtohen nga ana e mjekëve ligjorë Grekë, apo të specialistëve të tjerë të huaj të caktuar prej tyre?

Siç dihet, rregullat etika në përgjithësi shqyrton rregullat e sjelljes, që në rastin e osteologjisë antropologjike mjekoligjore, duhen respektuar në këto ekzaminime kockore.

Por nuk duhet harruar fakti, se ekspertët e këtyre rasteve gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre gjenden zakonisht nën presionin e rreptë të mediave, brenda një kuadri të caktuar ligjor, politik, social dhe ekonomik, ku të dhënat e këqyrjeve të tyre mund të keqinterpretohen, apo shtrembërohen.

Prandaj, ata në punën e tyre duhet të udhëhiqen më shumë në të dhënat shkencore, duke shmangur spekulimet, supersticionet, interesat politike apo ekonomike.

Nga ana tjetër, këta mjekë specialistë duhet t'i shmangen kapërcimit të njohurive të tyre, që mund të japin rezultate të gabuara. Pra, këto vlerësime në lidhje me përcaktimin e origjinës njerëzore të eshtrave, moshës, seksit, shtatit, racës, identifikimit individual duhet të kryhen brenda kufijve të këtyre njohurive. Gjithashtu, ata duhet të vënë në dukje kufizimet dhe pasaktësitë e metodave të përdorura. Në të kundërtën, mund të arrihen konkluzione të pasakta.

Në literaturë përmendet konflikti në Azinë Jugë lindore, i shoqëruar me vdekjen e qindra-mijëzave njerëzve, midis të cilëve bënë pjesë edhe shumë ushtarakë Amerikanë. Nga këta, viktimat që nuk u kthyen ose nuk u arritën të gjenden, u konsideruan si persona të humbur në veprime ushtarake, ose missing in action (MIA).

Në vitin 1972, një helikopter Amerikan AC-130 u rrëzua në Laos dhe 13 ushtarakët Amerikanë që udhëtonin me të, u shpallën si persona të humbur në veprime ushtarake. Dhjetë vite më vonë, nga gërmimi i vendit ku kishte ndodhur përplasja e helikopterit pas rrëzimit, u zbuluan 50000 copa kockash, ku më e madhja prej tyre ishte 13 cm e gjatë dhe shumica ishte me madhësi rreth 1cm.

Pas ekzaminimit osteologjik mjekoligjor, i mbështetur vetëm në përshkrimin anatomik të eshtrave, u shpall identifikimi pozitiv i mbetjeve skeletike të 13 viktimave, të cilat ju dërguan familjeve për varrimin e tyre.

Por të afërmit e viktimave i kundërshtuan rezultatet e këtij identifikimi. Për këtë arsye, u krye një ekzaminim i ri nga një ekip tjetër specialistësh, i cili vërtetoi se konkluzionet e ekspertimit të parë në lidhje me moshën, seksin dhe racën e viktimave kishin qenë të gabuara, sepse ishin kryer duke kapërcyer kufijtë e kompetencave të tyre.

Pra, mungesa e njohurive, pasaktësia e metodave të përdorura, mund të shpjegojnë në shkelje të parimit të paanshmërisë, i cili duhet t'i karakterizojë ta specialistë antropologë mjekoligjorë.

Përveç kësaj, këta specialistë duhet të jenë të pavarur në punën e tyre, d.m.th. nuk duhet t'u përkasin palëve të çështjeve që mund të jenë në konflikt midis tyre.

Në ekzaminimet e fundit për identifikimin e mbetjeve të ushtarëve Grekë të rënë në luftën Italo-Greke të viteve 1940-1941, ka mjaft dyshime që këto parime të mos jenë respektuar siç duhet.

Kështu, kryerja e tyre nën drejtimin e specialistëve Grekë, që kanë interes që të identifikojnë

sa më shpejt dhe sa më shumë bashkëkombas të tyre të vrarë në këtë luftë, mund të ketë ndikuar që të mos jetë zbatuar parimi i paanshmërisë.

Ky dyshim shtohet edhe më shumë nga fakti që në këto këqyrje u përfshinë në fillim edhe eshtrat e fshatit Kosinë të rrethit të Përmetit.

Këto eshtra të ekzaminuara shumë vite më parë, nga dy prej ekspertëve mjekoligjorë më me përvojë të vendit tonë, për të cilat pretendohet se ishin të ushtarëve grekë të vrarë në luftën Italo-Greke 1940 – 1941, ato rezultuan se i përkisnin kryesisht grave dhe fëmijëve shqiptarë. Pra, një skandal i vërtetë !

Specialistët Grekë, tani ka shumë mundësi të jenë ndikuar më shumë sesa duhet nga interesat politike në lidhje me pretendimet Greke ndaj Shqipërisë, gjë që mund të ketë çuar në kapërcimin e kompetencave shkencore të tyre, mosrespektimit të parimit të paanshmërisë dhe për këto arsye nuk përjashtohet mundësia që këto të jenë shoqëruar me identifikime të gabuara të këtyre rasteve.

Për këtë dëshmoi në fillim edhe nxitimi i tyre në varrimin sa më të shpejtë të këtyre mbetjeve në varrezat që janë ndërtuar tashmë në Shqipëri.

Edhe për analizën e ADN-së që është deklaruar se është përdorur nga pala Greke gjatë këtyre ekzaminimeve, shpesh jepen opinione nga disa prej specialistëve më të shquar të antropologjisë mjekoligjore, sipas të cilave jo rrallë kjo metodë u jep familjarëve të viktimave shpresa të pabazuara, gjë që bën që të shmanget përdorimi i metodave të tjera shkencore të identifikimit.

Përveç kësaj, metoda e ADN-së mund të shoqërohet me gabime të shumta laboratorike nga kontaminimet e shumta eventuale, përdorimit të standardeve joadekuate, ngatërrimit të mostrave. Për këtë arsye në këto rrethana do të jetë e detyrueshme të përdoren edhe metodat tradicionale identifikuese.

Në praktikën tonë të gjatë shumëvjeçare të antropologjisë mjekoligjore, ne kemi këqyruar me dhjetra raste të çështjeve kriminale, identifikime të viktimave të regjimit komunist, raste civile të transferimit të varrezave, përfshirë edhe raste të identifikimit të mbetjeve të dëshmorëve të luftës nacional çlirimtare, apo edhe të disa ushtarakëve italianë të vrarë në luftën Italo-Greke 1940-1941. Për secilin nga këto ekspertime të panumërta

antropologjike mjekoligjore, ne kemi punuar një kohë shumë të gjatë me javë dhe me muaj, duke kryer këqyrje dhe matje antropologjike të panumërta për përcaktimet e shumta që bëhen në këto raste, duke përfshirë edhe dëmtimet e kockave për së gjalli ose pas vdekjes etj.

Ndërsa për veprimet që po kryhen tani për mbetjet e ushtarëve Grekë të vrarë në luftën Italo-Greke të viteve 1940-1941, ne nuk kemi asnjë dijeni nëse janë kryer ose jo këto ekzaminime të hollësishme antropologjike, dyshim ky që shtohet edhe nga nxitimi i palës Greke që u tregua në fillim, për një varrim sa më të shpejtë të këtyre mbetjeve në tokën Shqiptare.

Pra vihet re një mungesë transparence nga ana e palës Greke në veprimet e saj, gjë që ka penguar një peer review (vlerësim i punës nga një ose më shumë specialistë të tjerë me kompetenca të ngjashme me ato të atij që e ka kryer këtë punë), duke penguar kështu vendosjen e një standardi publik për këto ekzaminime.

Përveç kësaj, kjo marrëveshje midis Shqipërisë dhe Greqisë nuk është e rregullt, sepse këto zhvarrime që po kryhen i përkasin luftës Italo-Greke të viteve 1940-1941. Ushtarët Grekë janë vrarë në përlëshje apo në beteja me ushtarët Italianë. Prandaj në këtë marrëveshje ka qenë e detyrueshme edhe përfshirja e palës Italiane.

Ne mendojmë se për këto raste duhet të kryhet një riekzaminim i ri, nga specialistë të pavarur, të caktuar nga një organizmë ndërkombëtare që merret me këto probleme, siç ka vepruar p.sh. ICRC (International Committee of Red Cross), që u përfshi si ndërmjetës neutral midis palëve luftuese, në konfliktin midis Izraelit dhe Hezbollah në korrik 2008.

Vetëm kështu, duke u zbatuar me përpikmëri parimet e antropologjisë mjekoligjore, kjo shkencë do të arrijë të përmbushë misionin e saj kryesor, për të cilin një studjues shprehet se: “ eshtrat konsiderohen shpesh si dëshmitarët tonë të fundit dhe më të mirë, që nuk gënjejnë dhe nuk harrojnë kurrë (bones are often our last and best witnesses, they never lie, and they never forget).

Në këtë mënyrë do të bëhet një vlerësim human sa më i drejtë i mbetjeve të ushtarëve Grekë të rënë në luftën e viteve 1940 – 1941, duke u respektuar njëkohësisht ndjenjat e të afërmeve dhe pullit Grek ndaj tyre.

* * *

Një problem tjetër ka të bëjë me atë, se ku duhet të ndërtohen vendvarrimet e ushtarëve grekë të vrarë në luftën italo-greke 1940–1941.

Për këtë ekziston edhe një legjislacion i pasur ndërkombëtar, ku vëndin kryesor e zënë konventat e Gjenevës (GC) dhe protokollet shtesë të tyre (Protocol additional to the Geneva Convention of 12 August 1949).

Sipas tyre, vendet në konflikt duhet të përpiqen të lehtësojnë kthimin e mbetjeve të të vrarëve me kërkesën e palës që i përket ose të afërmeve të viktimave.

Në fakt, gjatë përgatitjes së draftit të GC1 dhe GC2, u kërkua nga disa delegacione që mundësia e transferimit të trupave në vendet e tyre, mos të përmendej, sepse ata donin që luftëtarët e tyre të varroseshin në teatrin e luftës ku ata kishin rënë. Disa të tjerë kërkuan madje që të gjendej një shkak thelbësor që i vdekuri të varrosej në vëndin ku ishte vrarë. Për të vendosur një balancë midis këtyre pikëpamjeve të kundërta, kjo çështje u la fakultative.

Por në GC III dhe GC IV përmendet vetëm varianti i kthimit të eshtrave në vëndin e tyre.

Kështu, p.sh. këto vitet e fundit në SHBA po kthehen mbetjet e ushtarëve nga Korea e Veriut, të vrarë në luftën e Koresë në vitin 1950, apo mbetjet e ushtarëve Amerikanë të panjohur, të vrarë në Francë në luftën e dytë botërore.

Pra, tendenca e përgjithshme sot, në bazë të këtij legjislacioni është që këto mbetje mortore të transferohen në vëndin e origjinës së tyre.

Për këtë arsye, marrëveshja ndërshtetërore Shqipëri – Greqi, që i jep të drejtë shtetit Grek të ndërtojë varreza kolektive në tokën Shqiptare, është shumë e padrejtë, në dëm të sovranitetit dhe dinjitetit të vëndit tonë.

Siç u përmend më lart, gjatë përpilimit të konventës së Gjenevës, ndërtimi i varrezave të ushtarëve të një vëndi tjetër, në vëndin ku ishin vrarë, kërkohet nëse kishte një arsye thelbësore, që në rastin e ushtarëve Grekë të luftës 1940-1941, për palën Greke kjo arsye do të ishte pikërisht ajo që këto varreza të shërbenin në të ardhmen si pika mbështetjeje të pretendimeve Greke ndaj pjesës jugore të Shqipërisë.

Kjo u vërtetua edhe nga ngjarja e varrezave Greke në fshatin Bularat të Shqipërisë, para disa

vitesh, ku ekstremistët Grekë, arritën të kryejnë një mësymje të armatosur kundër policisë Shqiptare, duke pasur si pretekst “nderimet për ushtarët e rënë”.

Argumentet kryesisht historike që kundërshtojnë ndërtimin e këtyre varrezave kolektive Greke në vëndin tonë janë disa:

-Ushtria greke në tokën shqiptare në luftën Italo-Greke të viteve 1940- 1941, u fut për ta pushtuar pjesën e jugut të vëndit tonë, sepse Greqia gjithmonë më parë ka pasur si qëllim të aneksoj jugun e Shqipërisë, i ashtuquajtur “Vorio Epir”. Prandaj këta ushtarë grekë të rënë në këtë luftë nuk kanë asnjë të drejtë morale të prehen në tokën shqiptare. Në të kundërtën, varret e tyre në të ardhmen mund të kthehen në vende pelegrinazhi në Shqipëri për përkrahësit grekë të “Vorio Epirit”.

-Nga ana tjetër, nuk dihet nëse këta ushtarë grekë të vrarë, e kanë shprehur dëshirën përpara vdekjes së tyre për t’u prehur në Shqipëri, apo në mungesë, të saj, kjo dëshirë të jetë shprehur nga familjet e tyre.

-Përveç kësaj, në këtë marrëveshje ndërshtetërore, nuk është zbatuar një nga parimet kryesore të marrëdhënieve midis vendeve sovraane: reciprociteti, sipas të cilit në këtë rast, edhe në tokën greke, sidomos në pjesën veriore të saj, të hapen varreza të ushtarëve shqiptarë të vrarë në po atë luftë, apo në mungesë të tyre, të popullsisë çame të masakruar dhe vrarë nga grekët, në atë periudhë kohore, gjatë spastrimit etnik nga trojet e tyre.

Prandaj, duhet që sa më shpejt marrëveshja midis shteteve tona për këto varreza të shfuqizohet nga ana e shtetit tonë, sikurse ndodhi në Estoni, ku në bazë të një vëndimi qeveritar u prishën varrezat e ushtarëve rusë të rënë atje në luftë kundër Gjermanisë Naziste, sepse për popullin estonez, çlirimi i vëndit të tyre prej fashizmit nga ushtarët sovjetikë konsiderohej si fillim i një pushtimi të ri.

Vetëm në këtë mënyrë, do bëhet e mundur që mbetjet kockore të këtyre varrezave Greke, pas një ekzaminimi të ri nga një ekip i paanshëm, të dërgohen për t’u varrosur me nderimet dhe respektin përkatës në vëndin e tyre në Greqi, gjë që padyshim do të ndikonte pozitivisht edhe në marrëdhëniet e vëndit tonë me Greqinë.

PERSONALITETE


Mbi rrugëtimin vetmitar, kalvarin jetësor dhe kontributin e jashtëzakonshëm të poetit

JERONIM DE RADA: ARKITEKTI I RILINDJES SHPIRTËRORE SHQIPTARE



Nga Alban Daci

Në një mbrëmje të ftohtë e të heshtur të vitit 1903, në një shtëpi të thjeshtë e të zhveshur në Macchia Albanese të Kalabrisë, mbylli sytë një plak mjekërgjatë, i varfër, i vetmuar dhe pothuajse i harruar nga bota mbarë, burri i madh që mbante mbi shpatullat e tij të kërrusura peshën shpirtërore të një kombi të tërë. Jeronim De Rada vdiq në varfëri të plotë, duke lënë pas vetëm një tryezë druri të vjetër, disa fletë letre të shkruara media-tikisht me një bojë që po zbehej prej kohës dhe një ëndërr të madhe e të palëkundur që kapërcente detin: lirinë dhe zgjimin e Shqipërisë. Ai nuk ishte thjesht një poet apo një shkrimtar i rëndomtë; ai përfaqësonte arkitektin e parë ideologjik dhe kulturor që guxoi të imagjinonte një Shqipëri të pavarur e europiane, në një kohë kur vendi lëngonte nën thundrën e rëndë pesëshekullore osmane dhe gjuha shqipe rrezikonte të tjetërsohej apo të harrohej përgjithmonë nën shtresat e harresës historike. Ndoshta asnjë dëshmi nuk e lartëson më mirë përmasën e tij të jashtëzakonshme sesa letrat e poetit dhe burrështetit të madh francez, Alfonso de Lamartine, i cili i shkruante De Radës me një admirim të thellë: "Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja... Unë gëzohem për këtë rilindje të gjenit tuaj kombëtar". Ky vlerësim nuk ishte thjesht një kortezi letrare, por një pranim i faktit se ai po e fuste Shqipërinë në hartën kulturore të Europës moderne.



1. "Këngët e Milosaos" dhe agimi i një letërsie të re kombëtare

Përpara se penëartit arbëresh të hidhte bojën e parë mbi letër, shkrimi i gjuhës shqipe ishte i mbyllur pothuajse tërësisht brenda mureve të kishave dhe manastireve, i kufizuar rreptësisht në tekste fetare, katekizma dhe përkthime liturgjike të ngurta. Por në vitin 1836, me botimin e kryeveprës së tij gjeniale "Këngët e Milosaos", Jeronim De Rada bëri një revolucion të vërtetë radikal kulturor duke thyer çdo konventë dhe rregull të kohës. Ai solli për herë të parë letërsinë laike, ndjenjën e pastër njerëzore, erotizmin elegant dhe muzikalitetin e pashoq të gjuhës shqipe. Poema hapet me një imazh të mrekullueshëm, ku zgjimi i natyrës dhe i pranverës shërben si një metaforë e fuqishme për zgjimin e vetë vetëdijes kombëtare shqiptare:

"Bota kish ndërruar lisa,
uji i ri në det kaltronte
në ditën e re..."

Në qendër të kësaj bote poetike është Milosao, djali i guximshëm i sundimtarit të Shkodrës, i cili dashurohet marrëzisht me Rininë, vajzën e varfër e të thjeshtë të bariut Kollogre. Përmes këtij rrëfimi, poeti ndërton një konflikt të madh dramatik: dashuria romantike që guxon të thejë

barrierat e ngurta klasore dhe shoqërore ndeshet me një thirrje akoma më të madhe e të shenjtë—detyrën supreme ndaj atdheut që po lëngon. Kur trumbetat e luftës bien dhe Arbri thërret bijtë e tij për t'u mbrojtur nga pushtuesi, rehatia dhe lumturia vetjake marrin fund. Heroi rreshtohet pa hezituar në betejë, duke shpallur me vargje monumentale se liria bashkë me fatin e vendit vijnë përpara çdo interesi apo dashurie personale:

"Erdhi dita e Arbrit!

Doemos do vdesim...

Veç në sy të shihemi,

pa dhe bota të përmbysset."



Përmes kësaj lirike me fuqi universale, ai jo vetëm që lindi romantizmin shqiptar, por i provoi mbarë opinionit intelektual evropian se gjuha shqipe zotëronte një finesë, një forcë dhe një potencial estetik të barabartë me gjuhët e mëdha të qytetërimit të kohës.

2. Ringjallja e mitit të Skënderbeut si busull e bashkimit

Jeronim De Rada e kuptonte me një mprehtësi të rrallë politike dhe filozofike se një popull që ka humbur kujtesën e tij historike është i dënuar të mbetet i skllavëruar dhe nuk mund të ndër-

tojë kurrë një të ardhme si komb shtetformues. Për të zgjuar një popullatë të përgjumur dhe të përçarë nën sundimin otman, ai vendosi të gërmonte thellë në shekujt e shkuar dhe të nxirrte që andej epokën më të lavdishme të qëndresës: shekullin e artë të XV dhe figurën legjendare të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Kështu lindi poema e tij monumentale, komplekse dhe jetësore "Skënderbeu i pafan" (Skënderbeu i fatkeq), një vepër mbi të cilën ai punoi pa rreshtur për plot gjashtë dekada me radhë (1837–1896).

Në këtë poemë të gjatë dhe fragmentare, ai nuk bën thjesht një kronikë të ftohtë apo rreshtim datash historike. Ai e kthen Skënderbeun në një simbol të gjallë të bashkimit kombëtar, të krenarisë etnike dhe të qëndresës mbarëevropiane, duke e përshkruar atë përmes vargjeve që populli dhe rapsodët i mbronin në shpirt:

"Trim mbi trima ai Gjergj Kastrioti,

Forcë të madhe që m'i dhënka Zoti,

S'e djeg flaka, as s'e djeg baroti..."

Udhërrëfyes i këtij rrugëtimi epik dhe i tërë ekzistencës së tij mbetet koncepti i tij i pavdekshëm filozofik:

"Gjaku i shprishur që vete e kthehet te rrënjët." Ai besonte me një fe të patundur se kudo që të ishin shpërndarë shqiptarët nëpër botë, valët e historisë do t'i kthenin herët a vonë rreth të njëjtit trung dhe të njëjtit identitet kombëtar.

3. Zëri i Shqipërisë në Evropë: gazetaria, publicistika dhe diplomacia kulturore

Por shkrimtari i madh nuk ishte vetëm një poet melankolik i mbyllur në kullën e tij të fildishtë apo në bibliotekat e vjetra të Kalabrisë. Ai kishte temperamentin e një luftëtari të vërtetë të mendimit përparimtar, i cili e kuptonte se fitorja e kauzës shqiptare kërkonte edhe një armë tjetër moderne e të fuqishme: shtypin e lirë dhe publicistikën politike. Në vitin 1848, kur Europa po dridhej nga vala e revolucioneve liberale e kombëtare ("Pranvera e Popujve"), ai themeloi "L'Albanese d'Italia" (Shqiptari i Italisë), e cila mbetet zyrtarisht gazeta e parë në historinë e shtypit shqiptar. Ky ishte një akt i pashembullt guximi intelektual, ku idetë e lirisë dhe kushtetutshmërisë evropiane gërshetoheshin organ-

ikisht me të drejtat politike dhe kombëtare të shqiptarëve.

Më vonë, në vitin 1883, në një moshë më të pjekur por me të njëjtin pasion rinor, ai krijoi revistën "Fiamuri i Arbërit" (Flamuri i Shqipërisë). Kjo revistë u kthye shpejt në vatrën kryesore kulturore dhe politike ku mblidheshin, debatonin dhe dëgjoheshin mendjet më të ndritura të Rilindjes sonë kombëtare, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Përmes këtyre fletëve, De Rada mbante ndezur flakën e autonomisë dhe pavarësisë, duke u kthyer në një ambasador të palodhshëm kulturor të një shteti që ende nuk ekzistonte në hartë. Ai shkëmbeu letra dhe mbajti korrespondencë me kolosë të tillë si Viktor Hygo, mjaft gjuhëtarë e filologë të shquar gjermanë e austriakë, duke u provuar kancelarive evropiane se në Ballkan po rilindte një popull me histori të lashtë, i cili kërkonte mediatikisht me dinjitet të drejtën e tij legjitime për vetëvendosje dhe liri.

4. Shpëtimtari i këngëve të lashta dhe gjenit popullor

Dashuria e pakufishme e De Radës për atdheun nuk ushqej nga teoritë abstrakte, buronte drejtpërdrejt përmes zërit, vuajtjeve dhe gëzimeve të njerëzve të thjeshtë. Ai ishte thellësisht i bindur se shpirti i vërtetë i një kombi, historia e tij e patreguar zyrtarisht dhe pastërtia e gjuhës fshiheshin te folklori, te ato këngë dhe rapsondi që gjyshet u këndonin fëmijëve pranë oxhakut në netët e gjata të mërgimit. Me një bllok shënimesh në dorë dhe i shtyrë nga një pasion thuajse i shenjtë, ai kaloi vite të tëra duke shëtitur më këmbë nëpër fshatrat e izoluar dhe malorë arbëreshë të Italisë Jugore, duke dëgjuar pleq e fëmijë dhe duke hedhur me kujdes në letër rapsonditë e vjetra që rrezikonin të humbisnin përgjithmonë nën presionin e asimilimit.

Në vitin 1866, ai korri frytin e kësaj pune titanike duke botuar veprën monumentale "Rapsodie d'un poema albanese" (Rapsodi të një poeme shqiptare). Libri u botua i pajisur me një përkthim besnik në gjuhën italishte, me synimin e qartë që opinioni botëror dhe studiuesit e huaj të lexonin e të kuptonin se ky popull i mërguar

kishte marrë me vete nga Shqipëria një pasuri mitologjike, gjuhësore dhe historike me vlerë të pallogaritshme. Përmes këtij vëllimi, ai i tregoi botës shkencore se shqiptarët zotëronin një epikë popullore po aq dinjitoze, të pasur e madhështore sa edhe poemën e lashtë të Homerit apo epikat e mëdha europiane.

Një Trashëgimi e Pavdekshme dhe Kalvari i një Gjeniu

Jeta e Jeronim De Radës ishte sa madhështore në përmasa kulturore, aq edhe tragjike në sferën personale. Ai përjetoi dhimbje që pak njerëz mund t'i mbanin: pa të vdisnin me radhë të gjithë djemtë e tij të dashur dhe bashkëshortja, duke mbetur krejtësisht i vetëm në muzgun e jetës së tij.

Megjithatë, asnjë tragjedi familjare dhe asnjë skamje ekonomike nuk arriti ta thyente vullnetin e tij apo ta zbehte dashurinë e tij mistike për Shqipërinë.

Kur u nda nga jeta në vitin 1903, ai kishte vetëdijen e pastër të një profeti që e kishte kryer me sukses misionin e tij mbi tokë. Ai nuk arriti ta shihte dot me sytë e tij fizikë ditën e madhe të 28 Nëntorit 1912, kur në Vlorë do të ngrihej përfundimisht flamuri i pavarësisë, por ajo liri dhe ai shtet mbanin padyshim vulën e pashlyeshme të shpirtit dhe mendjes së tij vizionare.

Siç do të deklaronte me të drejtë kritika e mëvonshme letrare: "Pa De Radën, romantizmi dhe zgjimi kulturor shqiptar do të kishin humbur agjimen e tyre të parë."

Pa kontributin e jashtëzakonshëm e shumëdimensional të këtij kolosi të Macchia Albanese-s, rrugëtimi kulturor, arsimor, gjuhësor dhe identitar i Shqipërisë drejt familjes së popujve të lirë evropiane do të kishte qenë shumë më i errët, më i vonuar dhe plot pikëpyetje.

Ai nuk krijoi thjesht vargje; ai krijoi vetëdijen kombëtare. Jeronim De Rada mbetet përjetësisht "Kthesa e Madhe" e historisë sonë, patriarku i letrave shqipe dhe drita udhëheqëse që i tregoi një kombi të tërë rrugën sesi të kthehet me krenari te rrënjët e veta.

60-VJETORI

TAKIM MBRESËLËNËS I MATURANTËVE TË VITEVE 1965 - 1966 NË “UNIVERSITETIN E DIBRËS”

NJË VIZITË MALLËNGJYESE NË QYTETIN E PESHKOPISË

Akademik Xhavit LASHI



Një grup ish - maturantë të viteve 1965-1966, me rastin e 60- vjetorit të përfundimit të Shkollës Pedagogjike të Peshkopisë organizuan një vizitë njëditore në qytetin e Peshkopisë. Për të mbërritur në këtë qytet mahnitës rrugëtuan nëpërmjet Rrugës së Arbërit.

Pas mbërritjes, urimi i përbashkët ishte: “Gëzuar 60 - vjetorin e mbarimit të Shkollës Pedagogjike të nderuar ish – pedagogjikas!.

Kemi qenë të nderuar dhe me fat që kemi përfunduar studimet në këtë shkollë që është quajtur “UNIVERSITETI I DIBRËS”.

Meritojnë përgëzime të veçanta ish – pedagogjikasit: Hamit Lumi, Imer Gjana e Murat Halili që kishin ardhur enkas nga Italia; Sanie Sula Zeneli, ardhur nga Gjermania, Bajram Kraja ardhur nga Hasi, Xhide Fide Hoxha, Bashkim Axhami, Xhelal Meta ardhur nga Durrësi.

Sëbashku me ne ishin profesorët Bajram Xhafa e Hasan Shehu.

Takimin e parë e bëmë në lulishten e Turizmit të qytetit, ku na pritën shokët tanë ish - maturantët nga qyteti dhe fshatrat e Dibrës, duke na uruar mirëseardhjen me kafën e rakinë dibrane.

Në vazhdim bëmë një foto te pllakata e vendosur që tregon se: "Në shtator 1948, në këtë godinë u çel SHKOLLA PEDAGOGJIKE E PESHKOPISË."

Tek ish - ndertesa e Shkollës Pedagogjike na priti drejtoresha zj.Marsida Vyshka Neziri.

Gjatë vizitës në klasat e kabinetet kujtuam me plot nostalgji dhe emocione vitet shkollore, ku kishim mësuar, mjediset e mencës dhe fjetores, klasat e Ushtrimores ku bënim praktikën pedagogjike. Në disa prej klasave u ulëm si ish - nxënësit e dikurshëm.



Në vazhdim u vendosëm në sallën e bukur të konferencave. Fillimisht, me një minutë heshtje nderuam shokët tanë dhe pedagogët e nderuar që nuk jetojnë më.

U NDRITTE SHPIRTI I TYRE NË PARAJSË!

Në vazhdim, drejtoresha e shkollës na informoi për arritjet dhe rezultatet e shkollës, me lëvizjet dhe iniciativat e tyre. Pastaj diskutuan: Xhavit Lashi, Kamber Faruku, Hilmi Cani, Sanie Sula, Pjeter Marku.

Me kënaqësi të madhe bëmë një shëtitje në bulevardin “Elez Isufi” nën hijen e blinave e aromën e erën mahnitëse të luleve të blirit.

Në radhën e veprimtarive, një pritje të veçantë na rezervoi Prefekti Qarkut Dibrë z. Nexhbedin Shehu. Takimi me të kaloi në një atmosferë tepër të gëzuar e miqësore.

U takofshim dhe në përvjetorë të tjerë.

Me respekt e mirënjohje,

Xhavit Lashi.

PERSONAZH

ING. IKBAL KURTI, GRUAJA QË NDËRTOI MATIN - DREJTUESE, BASHKËSHORTE E NËNË SHEMBULLORE

Kimete BERISHA

- Profili i Ing. Ikbale Kurti është jo vetëm ai i drejtueses së talentuar, por edhe i gruas e zonjës me inteligjencë e fisnikëri të rrallë. Me shpirt krijues, talent e përkushtim maksimal ajo la gjurmë të thella në vepra monumentale të Matit, ashtu si edhe këto vite në metropolin shqiptar....



Në librin e tij “Një jetë në shërbim të njerëzve”, Prof.dr. akademik Sali Kurti (*libër të cilin Kritika letrare e ka konsideruar si modelin e shkrimit të një monografie*), një kapitull më vehte përbën “Krijimi i strehëzës së re familjare”.

Këtu gjen mishërim të plotë sentenca se “pas një burri të suksesshëm qëndron një grua e fortë”. Autori i kësaj vepre dinjitoze, ndër të tjera e quan fat njohjen dhe krijimin e familjes me Ikbalen, bijë e familjes së njohur korçare Alizoti, që ndryshe nga bashkëmohataret e saj, që në vitin e largët 1966 do të niste studimet në degën e vështirë “Inxhinieri Ndërtimi e Përgjithshme për

Ndërtime Qytetare – Industriale” (Universiteti Shtetëror i Tiranës), nga ku do të diplomohet më 1970, për të kryer sërish pas një viti kurs specializimi pasuniversitar për urat dhe rrugët.

Ikbalja, një grua gjeneroze, me kulturë, plot vitalitet, e veçantë në çdo aspekt të jetës së vet, ishte po ashtu ndër të rrallat moshatare të asaj kohe, që do të linte qytetin e Lushnjës (*ku babai i saj Fehmiu punonte si bahçevan në Institutin e kërkimeve Bujqësore*) për t’u martuar më 1973 me doktorin stomatolog Sali Kurti nga fshati Karicë e Matit. Nisi kështu për të një jetë sa e bukur bashkëshortore e dashuruar me doKtor Saliun, aq dhe e vështirë për atë kohë.

Inxhinierja e re e sapomartuar do të ecte çdo ditë të nga dy orë më këmbë për mëse një vit nga Karica në qytetin e Burrelit, për të drejtuar për katër vjet (1973-1977), me kompetencë e profesionalizëm si Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës dhe projektimit në ish-Komitetin Ekzekutiv të KP të rrethit të Matit.

Në fillim të karrierës së saj ajo do të ishte inçiuese dhe drejtuese e veprave të rëndësishme infrastrukturore, jo vetëm në qytetin e Burrelit, por në gjithë rrethin e Matit, deri në skajet më të largëta.

Bashkëkohësit e mbajnë mend se si gjatë kësaj periudhe, sëbashku me ekipin e saj drejtues, arkitektët Valentin Voshtina, Shpresa Kote, Ramiz Pepa e Fitore Selmani hartuan planet rregulluese të qendrave të banuara Klos, Krastë e Ulëz, si dhe të fshatrave të rrethit. Me talent të spikatur e shpirt të rrallë krijues Ikbalja drejtoi gjithashtu projektimin dhe drejtimin e objekteve të rëndësishme, si Poliklinikën dhe bllokun e banesave në qendër të qytetit të Burrelit, të lidhura këto me bllokun e dyqaneve. Dhe jo vetëm këto, por në harkun kohor të atyre viteve, firmën e saj mbajnë edhe disa banesa pesë katëshe me strehim poshtë, çerdhe, kopshte, hangar-oficinë për ish SMT etj.

Pikërisht për këto arritje ajo do të dekorohet

nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me Medaljen “Për shërbime të shquara Shtetërore e Shoqërore” me motivacionin: “Për rezultate të mira të arritura në plotësimin e detyrës së ngarkuar dhe në zgjidhjen e detyrës të dektorit” (Dekret nr.5472, datë 29.10.1976).



DREJTUESE E TALENTUAR, ZONJË ME INTELIGJENCË E FISNIKËRI TË RRALLË

Profili i Ing. Ikbale Kurti është jo vetëm ai i drejtueses së talentuar, por edhe i gruas e zonjës me inteligjencë e fisnikëri të rrallë. Me shpirt krijues, talent e përkushtim maksimal ajo la gjurmë të thella në vepra monumentale të Matit, ashtu si edhe këto vite në metropolin shqiptar. Dëshëm kjo në harkun kohor të katër viteve, 1977-1980, kur si kryeinxhinere e Ndërmarrjes së Ndërtimit Mat spikati në drejtimin e punimeve për ndërtimin e Uzinës së Ferrokromit Koms; Ujës-jellësin për qytetin e Burrelit dhe uzinën e ferrokromit (pra linjën Vinjoll-Burrel-Uzinë e Ferrokromit, rreth 15 km e gjatë me prurje rreth 100 l/sek.

Është koha kur Ing.Ikbale Kurti merrej si referencë vlerash dhe përkushtimi në punë e drejtim, konkretizuar kjo në vetëm punë pa orar, mbledhje, konsultime, kontrole, zgjidhje prob-

lemesh dhe angazhime të tjera suplementare. E kësisoj ajo do të drejtonte edhe ndërtimin e ujës-jellësit Shutre – Uzina e Ferrokromit rreth 17 km me kapacitet 70 l/sek me gjithë veprat tjera përkatëse si puse shuarje, depo e ujit 1000 dhe 4000 m³ etj.

Brenda këtij bilanci mjaftë pozitiv janë dhe ndërtimi i Parkut Automobilistik të Mallrave Burrel dhe ofiçina e këtij parku, disa objekte të minierës së kromit Krastë si dhe një sërë objektesh të tjera si banesa 5 katëshe, çerdhe, kopshte etj.

Gjatë kohës si kryeinxhinere e ndërmarrjes së ndërtimin Mat Ikbaleja drejtoi gjithashtu ndërtimin e rrjetit të rrugëve të brendshme të Uzinës së Ferrokromit rreth 5 km; disa rrugë të shfrytëzimit pyjor në Mbas Dejë, Xirë e Llapush.

KOHA KUR DREJTONTE NJË PREJ SEKSIONEVE MË TË RËNDËSISHME TË KOMITETIT EKZEKUTIV MAT

Kontributi i Ing. Ikbale Kurti në transformimin rrënjësor të infrastrukturës së rrethit Mat ka qenë i jashtëzakonshëm. Ajo ishte dhe mbetet personifikimi më i shkëlqyer i gruas drejtuese të asaj kohe, kur vështirësitë ishin të panumërta.

Veçanërisht për dekadën e fundit të sistemit monist (1980-1990) Ikbaleja mbahet mend për drejtimin me kompetencë e profesionalizëm të spikatur si Shefe e Seksionit Ndërtim -Komunale – Tregti të ish – Komitetit Ekzekutiv të KP Mat dhe Drejtoreshë e Ndërmarrjes Komunale Banesa e këtij rrethi. Është koha që ajo mbahet mend nga bashkëqytetarët e Burrelit dhe pothuajse në çdo krahinë të Matit për shembullin se si punohet dhe si drejtohet, edhe në rrethana tepër të vështira të një izolimi total të vendit.

Seksioni i Ndërtim – Komunale – Tregti ishte seksioni më me pëshë, me ndikim të drejtpërdrejtë në sektorët më jetikë. Por falë profesionalizmit dhe përkushtimit qytetar ajo ja doli të përballojë me dinjitet problemet e plotësimit të nevojave të popullit me shërbimet tregtare e komunale, si furnizimim e popullatës në të gjithë rrethin, duke ndërtuar disa ujës-jellësa, si ujës-jellësin e fshatit Val të krahinës Martanesh, ndër fshatrat më të largët të rrethit Mat, ku ekzistonte vetëm një pus që e administronte njëri nga banorët e fshatit. U ndërtuan gjithashtu ujës-jellësat: German, Karicë,

Madhesh, Shopet, Urakë, shlli-Shqefën-Urxallë-Derjan, Krastë, Stavec, Cërujë, Patin, duke përfshirë edhe katër qytetet: Burrel, Ulëz, Klos e Krastë. Megjithë vështirësitë e tejskajshme të asaj kohe nën drejtimin e saj u punua me aksion për ndërtimin e ujësjellësave të Martaneshit, Shkopetit etj.

Si e vetmja shefe seksioni, njëherësh edhe anëtare e ish-Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Mat, Ikbajla do të dallohej për mendimin e saj kualitativ në këtë organ vendimmarrës.



Me të njejtin përkushtim Ing.Ikbale Kurti punon edhe në vitet 1991-1997 si inxhinierë në Drejtorinë Arsimore të rrethit të Matit, ku dha shembullin e saj si profesioniste e talentuar në projektimin, ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave të këtij rrethi me fondet e Komunitetit European, fondet buxhetore e ndihma të tjera.

ME VIZION BASHKËKOHOR EDHE NË KËTO VITE TË TRANZICIONIT TË TEJZGJATUR

Ing. Ikbale Kurti, përgatjen profesionale, talentin dhe përkushtimin ndaj punës do ti dëshmonte më së miri edhe në këto më se tri dekada të këtij tranzicioni të tejzgjatur. Me vizion bash-

këkohor ajo do t'i përshtatej demokratizimit të sistemit që fatmirësisht ka ndikuar pozitivisht edhe në demokratizimin e familjes e shoqërisë. Është për t'u vlerësuar përkushtimi i saj edhe gjatë këtyre 30 viteve kur si kryeinxhinierë e Shoqërisë “SIGERS” Sh.p.k ka drejtuar punimet në dhjetra objekte të rëndësishme të metropolit shqiptar, si ndërtim tregjesh: tregu elektro – shtëpiak; tregun e gjësë së gjallë, tregun fruta-perime në rrugën “Mine Peza”; tregun ushqimor te Qyteti i Nxënësve etj. Po ashtu ka drejtuar punimet në ndërtimin e disa objekteve socialkulturore, si shkolla, ambiente zyresh (Si Qendra e Vizitorëve në Malin e Dajtit), qendra shëndetësore, antena televizive, ndërtim ujësjellës, ndërtim e asfaltim rrugësh, stacione pompimi për mbrojtjen lumore, ndërtimin e rrjetit shpërndarës 20 kv kabllor, të TM TU kabllor dhe ajror dhe kabinat përkatëse, etj, etj.

Mbas vitit 2005 Shoqëria “SIGERS” SH.P.K me Administrator Z. Muharem Pllaçi, realizoi ndërtime pallatesh me investimet e veta. Nga kjo shoqëri u ndërtuan pallate 5 – 6 – 7 katëshe me papafingo + një kat parkim dhe konkretisht, pallati 2 seksionesh në Selitë, pranë liqenit Artificial të Tiranës, blloku i pallateve poshtë Teleferikut, blloku i pallateve pranë Thesarit të shtetit Dajt, Rruga “M.Deliu” si dhe dy hidrocentrale me kontratë kocensionare të fituar me tender, si Heci i Lenes Martanesh dhe Heci I Germanit.

NË PROFILIN E INTELEKTUALES BASHKËKOHORE IKBALE KURTI SPIKASIN VLERAT NJERËZORE

Jeta ka sfida dhe sakrifica, por Ing. Ikbale Kurti është gjithnjë motivuese dhe pretenduese në karrierën e saj. Në përditshmërinë e saj ajo është shembulli më i mirë për shoqërinë, si modele frymëzuese e mbresëlënëse që lë gjurmë të pashlyeshme tek çdokush. Shembuj të shumtë pozitiv e frymëzues e kanë shoqëruar përgjatë gjithë trajektores së jetës, duke ndërë jo vetëm admirim, por edhe vlerësim e respekt të thellë nga shoqëria e saj e shumtë, kudo në Lushnjë, Mat e Tiranë. Kësisoj Ing. Ikbale Kurti është më shumë se një fenomen njerëzor. Imazhi i mrekullueshëm i kësaj gruaje me shtat të vogël e të brishtë, me fytyrën paqësore e të dhembshur, gjithmonë më ka magjepsur e frymëzuar. Portreti i saj amësor, i butë



e i ëmbël, i shoqëruar me gjeste të përkushtimit dhe përulesisë njerëzore ka inspiruar shoqërinë e saj kudo ajo ka punuar e drejtuar, duke ndikuar ndjeshëm në formëzimin e karakterit dhe të personalitetit njerëzor si qenie humane. Ajo mbetet padyshim etalon i gruas së përveçme, e destinuar për të qenë një misionare e patjetërsueshme e krijesës njerëzore. Së pari, bashkëshorte e nënë shembullore e dy fëmijëve të mrekullshëm, vajzës Greta e djalit Elti.

Ikbalja, inxhinierë, drejtore e shefe seksioni në Komitetin Ekzekutiv, kushedi sa herë iu ka munguar kur ata ishin të vegjël për t’i ushqyer e vënë në gjumë, për t’i përcjell në shkollë e pritur përsëri. Por ndonëse, ajo dhe bashkëshorti ideal dr. Saliu, sakrifkuan gjithçka për punën dhe detyrat, edhe Greta e Elti u bënë të mirë, të shkolluar, të ditur, të aftë dhe të njohur, të përkushtuar në detyrat që mbajnë, modele të shkëlqyer i dy prindërve të vet, duke ju dhuruar nipër e mbesa që ua shtojnë gëzimin, harenë e lumturinë.

Veç të tjerash, në profilin e Ing. Ikbale Kurtit spikasin vlerat njerëzore. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të realizimit të programit zhvillimor të rrethit të Matit. Ishte nga të parat që i fali shpirtin

dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri, ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare.

Dhe jo vetëm kaq, si intelektuale bashkëkohore, demokracinë e konsideronte dhe e konsideron sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të saj ishte dhe është vetëm konkurrenca në vlera. Ajo besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme.

E qetë, e pjekur, shumë e kulturuar, nuk pajtohej dhe nuk pajtohet me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore. Shpërthyes dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte dhe qëndron në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kuptohet, ajo ishte dhe është individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t’i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dhe po i manifeston dukshëm edhe tani në sistemin e ekonomisë së tregut.




PROMOVIMI

Shkrimtarë matjanë, dibranë, kurbinas e lezhjane vlerësojnë librin e autorit Hamdi Hysuka

DR. SALI KURTI – PORTRETI I NJERIUT FISNIK

- **Elita krijuese: Rugës për në fshatin Karicë të Matit t’i vihet emri i tij**



Dy vjet më parë, do t’i gëzoheshim vendimit të Klubit Letrar “Pjetër Budi” për t’i dhënë titullin “Anëtar Nderi i këtij Klubi”, Dr. Sali Kurtit, me motivacionin “Mjek stomatolog, autor i librit “Një jetë në shërbim të të tjerëve”, Mjeshtër i madh”, “Qytetar Nderi” i Bashkisë Mat, “Njeriu i Vitit 2023” i Federatës së Paqes Universale Shqipëri, themelues dhe drejtues i Klinikës “Mat Dental”.

Këtij gjerdani të artë dekoratash, medaljesh dhe titujsh, në gjoksin e Dr. Sali Kurtit, ndër më të nderuarit e të vlerësuarit e rrethit të Matit e të metropolit shqiptar, gjatë dy viteve të fundit i janë shtuar tituj e medalje tjera, si ‘Mirënjohja’ e

Këshillit të Qarkut Dibër dhe titulli “Akademik që ju dha fundvitin e kaluar, (me propozimin tim), nga Akademia Shqiptaro-amerikane e Shkencave dhe Arteve Nju Jork (ku sërish unë isha organizator i ceremonisë së dhënies së këtij titulli).

Dy vjet më pas, miku ynë Hamdi Hysuka, pikërisht bazuar në këto vlerësime nga institucione prestigjioze kombëtare, ndërkombëtare e lokale, vjen me librin “Dr. Sali Kurti, ikonë e stomatologjisë shqiptare”.

Në këndvështrimin tim analitik, ky libër përmbush mjeshtërisht standardet e një monografie të mirëfilltë letrare, e cila zë vend nderi në fondin e letërsisë sonë dokumentare.

Pikërisht si i tillë u vlerësua dhe në promovimin e të shtunës së 30 qershorit 2026 në Pallatin e Kulturës “Sh.Doda” Burrel, nga dhjetra shkrimtarë dhe artistë matjanë, dibranë, kurbinas e lezhjanë, të pranishëm në këtë event mbresëlënës.

Fillimisht u ndoq me vëmendje dhe interes dokumentari televiziv i realizuar me mjeshtri të rrallë artistike nga gazetari e montazhieri i talentuar Edmond Sufaj, në të cilin përcilleshin artistikisht detaje nga jeta dhe rrugëtimi i suksesshëm i Dr. Sali Kurtit.

Më pas përshëndetje të ngrohta e të sinqerta nga përfaqësues të pushtetit vendor: kryetarja e këshillit të Bashkisë Mat, Znj. Anila Stafhasani dhe zëvendësprefekti i Qarkut Dibër, gazetari e shkrimtari i mirënjohur Hasan Pasha. Përshëndetjen gjithashtu përzmërsisht punonjës të Klinikës Dentare “Mat Dental”, Sanie Meta, familjarë, si dhe titullari i monografisë, Dr. Sali Kurti.

Monografia e kreut të Klubit Letrar “Pjetër Budi”, shkrimtarit të mirënjohur matjan Hamdi Hysuka u vlerësua nga Prof. as. Jolanda Lila (njëherësh redaktore e librit); poetja, prozatorja dhe analistja e letërsisë Emrie Krosi, nga shkrimtarët e poetët: Faik Xhani, Luftar Pepmarku, Er-



mal Lala, Imer Hysa, Vilma Nika, Elona Basha, Setki Q. Jashari, gazetarët Zef Shtjefni dhe Fatmir Neli.

MONOGRAFI ME DETAJE TË PREKSHME JETËSORE

Në të vërtetë, Hamdi Hysuka, ashtu si Jolanda Lila, për librin e saj “DR.SALI KURTI, MJEKU QE JETËSOI ÇDO ËNDERR” dhe unë që e kam personazh kryesor në tre librat e mi “*Të fitosh titullin njeri*”, “*Zëra bashkëkohore*” e “*Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave*”, si dhe Hasan Pasha për librin “*Fisnikët e Matit*”, nuk e kemi patur të vështirë skalitjen e portretit të njeriut fisnik, Dr.Saliut, pasi mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet... E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën prof. dr. Sali Kurti, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.



I frymëzuar nga profesionalizmi i spikatur dhe humanizmi i pashoq, unë e kam patur Dr. Saliun personazh edhe në disa shkrime që kam botuar në të përditshmen më të madhe shqiptare “PANORAMA”, në të përjavshmen letrare e kulturore “NACIONAL”, në prestigjiozen *fjalaelire.com&Albanian Post*, etj, dhe sot ndjej kënaqësi të veçantë kur konstatoj se miku ynë Hamdiu, i ka bërë ato pjesë të librit “*Dr. Sali Kurti, ikonë e stomatologjisë shqiptare*”, që u promovua të shtunën e kaluar.

Sërish dua të them se nuk e kemi patur të vështirë edhe për faktin se shkrimin e këtyre librave na e ka bërë të lehtë vetë dr. Saliu. Mjaf-ton ti referohesh librit të tij “*Një jetë në shërbim të të tjerëve*”, ku në 294 faqet e tij gjejmë detaje për vitet e vështira të fëmijërisë, pemën gjenealogjike, jetën konviktore dhe studentore në Politeknikumin Mjekësor e Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, krijimin e strehëzës familjare, punën si drejtor i Shërbimit Stomatologjik të rrethit të Matit, pasionin për teatrin dhe të bukurën në përgjithësi, bekimin si “prind”, magjinë si “gjysh”, dhe në tërësi rrugëtimin e tij të suksesshëm e fisnik në profesionin e stomatologut. Njëzetëetë artikujt e këtij libri që është modeli i shkrimit të një monografie, janë vërtetë një përmbajtje e pasur lëndore me një tematike mjaftë të larmishme.

Në të njejtën linjë, edhe Hamdi Hysuka, në këtë monografi, duke përshkruar mjeshtërisht

rrugëtimin e dr. Sali Kurtit në shtatë dekada, nxjerr nga pluhuri i harresës, momente, histori jetësore, detaje, njerëz, ngjarje, vende e hapësira, të cilat së bashku shpalosin botën e brendshme dhe të jashtme të personazhit të librit të tij.



VLERËSIME NGA PERSONALITETE TË LETRAVE

Libri “*Dr. Sali Kurti, ikonë e stomatologjisë shqiptare*”, nuk është vetëm një përmbledhje faktesh dhe vlerësimesh, por është një dëshmi e gjallë e një jete të jetuar me përvullësi, dashuri dhe devotshmëri të palodhur ndaj njerëzve. Kjo sipas redaktores Jolanda Lila për faktin se për prof. Sali Kurtin janë shkruar shumë artikuj dhe libra, por shumë e më shumë është folur dhe vijon të flitet për veprat e tij humane. Për ta rrokur një pjesë të asaj që thuhet për këtë figurë, vjen ky libër i shkruar nga autori Hamdi Hysuka. Ai ka pasur një qëllim: të mbledhë në një vend të vetëm, copëzat e shumta të vlerësimeve që e kanë shoqëruar ndër vite prof. Sali Kurtin.

Në nalizën e Prof. as. Jolanda Lilës libri është konceptuar dhe ndarë në tre pjesë kryesore. Në

pjesën e parë bëhet një përmbledhje e jetës së prof. Sali Kurtit. Kjo përmbledhje është paraqitur në mënyrë kronologjike dhe pa u ndalur në detaje e hollësi.

“Është parë e udhës paraqitja në mënyrë koncize, duke u udhëhequr nga arsytimi se ekzistojnë dy libra që e paraqesin në formë të hollësishme gjithë rrugëtimin jetësor të deritanishëm të prof. Saliut, libri autobiografik ‘*Një jetë në shërbim të njerëzve*’, si dhe biografia e letrarizuar ‘*Sali Kurti, mjeku që jetësoi çdo ëndërr*’. Këto libra, së bashku me intervistën dhe bisedat me dr. Saliun, autori i ka përdorur si bazë dokumentare për hartimin e pjesës së parë të librit”, shkruan znj. Lila. Duke u ndalur në strukturën e librit ajo vlerëson se në pjesën e dytë, janë paraqitur të gjitha vlerësimet që ai ka marrë ndër vite për punën e tij të palodhur si mjek stomatolog dhe si kontribues i çmuar në jetën shoqërore. Renditja e këtyre titujve, duke nisur nga “*Mjeshtër i Madh*”, “*Qytetar Nderi*” dhe “*Njeriu i Vitit 2023*”, vijonë në libër si tregues i arritjeve të tij dhe i mirënjohjes së thellë që gëzon në komunitet, si profesionist dhe si njeri me vlera të larta njerëzore.

Referuar analizës së redaktores Lila, në pjesën e tretë janë përfshirë një sërë shkrimesh dhe refleksimesh mbi veprimtarinë e tij. Këto shkrime janë hartuar nga gazetarë, miq, kolegë, dashamirës, ish-studentë dhe bashkëpunëtorë të panumërt të tij, të cilët paraqesin dëshmi interesante për anën e tij profesionale dhe humane. Pjesa më e madhe e shkrimeve janë marrë nga organe të ndryshme të shtypit të shkruar, por edhe nga kapituj apo sythe librash në trajtë bibliografish mbi njerëz të shquar të bashkëkohësisë, ku pa dyshim, emri i prof. Saliut renditet përherë, në mos i pari, patjetër si një ndër emrat më të rëndësishëm. Këto shkrime shtrihen në kohë prej vitit 1989 deri në



ditët e sotme.

“Përmbledhja e tyre, sidomos pas kaq shumë vitesh është një punë e mundimshme, e vështirë dhe e pamundur për t’u rrokur tërësisht. Autori Hamdi Hysuka ka përfshirë e përmbledhur pjesën më të rëndësishme të këtyre shkrimeve dhe më të spikaturat. Autorët e këtyre shkrimeve të sinqerta e mbresëlënëse kanë sjellë vlera të shumta nga vepërimitaria e prof. Saliut, duke nxjerrë në pah punën e tij plot dashuri, përkushtim, por edhe vetëmohim në dobi të komunitetit, të mjekësisë e të kulturës shqiptare”. Redaktorja Lila thekson gjithashtu se në këtë pjesë nuk do të mungojnë as intervistat që vetë dr. Saliu ka dhënë në media të ndryshme, të cilat pasqyrojnë mendimet, parimet dhe përkushtimin e tij në vite. “Përmes këtyre intervistave, lexuesi ka mundësinë të njohë më nga afër shpirtin e tij human, përvojat që e kanë formuar dhe idealet që e kanë udhëhequr në jetë”, tha ndër të tjera redaktorja Lila në fjalën e saj gjatë promovimit. Ajo konkludon se përmbledhja e të gjitha vlerësimeve dhe mendimeve që janë botuar ndër vite për prof. Saliun përbën një risi në këndvështrimin dhe në trajtimin nga ana e autorit Hysuka. Për këtë arsye, - tha ajo, ky libër u ofron lexuesve shqiptarë një mozaik të gjallë emocionesh, kujtimesh dhe vlerash. Ndërsa njohja e mëtejshme me figurën e prof. Saliut sjell një model të denjë referimi dhe të imponon nderim për një jetë të ndriçuar jo vetëm nga drita e dijes, por edhe nga drita e zemrës.

Kështu edhe për Emrie Krosin, një zë i veçantë i analizës së letërsisë, poete dhe prozatore e mirënjohur, promovimi i monografisë kushtuar Dr. Sali Kurtit ishte më shumë se një veprimtari letrare; ishte një festë e vlerave njerëzore, profesionale dhe qytetare.

Po ashtu, sipas gazetarit të Mat Tv Fatmir Neli, përmes një rrëfimi të ngrohtë, të mbështetur në dëshmi, kujtime dhe vlerësime autentike, autori Hysuka ka ngritur portretin e një mjeku që ndërtoi emrin e tij me punë, përkushtim dhe fisnikëri shpirtërore.

DR. SALI KURTI STOMATOLOG I SUKSESSHËM, MODEL QYTETARIE DHE FISNIKËRIE NJERËZORE

“Dr. Sali Kurti nuk është vetëm një stomatolog i suksesshëm, por një model qytetarie dhe

fisnikërie njerëzore. Në çdo dëshmi, kujtim apo vlerësim që mbledha, gjeta respektin dhe mirënjohjen e njerëzve për një mjek që ka ditur të shërojë jo vetëm dhembjen fizike, por edhe plagët shpirtërore të shumë njerëzve”, tha ndër të tjera autori i librit Hamdi Hysuka, fjala e të cilit u mirëprit dhe u ndoq me interes të veçantë. Ai e konsideroi këtë botim si detyrim moral për të dokumentuar një jetë të ndritur, një histori suksesi të ndërtuar mbi sakrificë, punë të ndershme dhe dashuri për njeriun.

Me daljen në qarkullim të librit, autori Hysuka ka ndërjerë dhe ndien emocion dhe përgjegjësi të veçantë shpirtërore. Sepse kjo vepër nuk është thjesht një biografi, por një përpjekje e sinqertë për të sjellë para lexuesit jetën dhe veprën e një njeriu që i ka shërbyer shoqërisë me dije, përkushtim dhe humanizëm të rrallë.

“Teksa punoja mbi këtë libër, kuptova se ky botim ishte detyrim moral për të dokumentuar një jetë të ndritur, një histori suksesi të ndërtuar mbi sakrificë, punë të ndershme dhe dashuri për njeriun. Besoj se figura e Dr. Sali Kurtit meritonte të mbetej e shkruar në kujtesën tonë kolektive, si frymëzim për brezat e rinj dhe si dëshmi, se vlerat njerëzore janë pasuria më e madhe e një shoqërie”, tha z.Hysuka. Veçanërisht prekëse është mënyra se si libri e sjell Dr. Sali Kurtin jo thjesht si profesionist të talentuar, por si njeri që di të dëgjojë dhembjen njerëzore dhe të fitojë besimin e njerëzve me përlulësi e dashuri. Nga Karica e Matit deri te titujt më të lartë kombëtarë e ndër-kombëtarë, rrugëtimi i tij mbetet frymëzim për brezat.

PERSONALITETI I DR. SALI KURTIT SI SIMBOL I PËRKUSHTIMIT, FISNIKËRIE DHE HUMANIZMIT

Si edhe në promovimin e librave tjerë kushtuar Dr.Sali Kurtit, salla komode e pallatit të kulturës të qytetit të Burrelit jehoi fuqishëm gjatë interpretimit mjeshtëror të këngës “Ti i fale jetë çdo ëndrre”, me tekst të Jorgo Papingjit, interpretuar nga Esat Ruka: këngëtar, instrumentist dhe krijues popullor, botues dhe studiues i etnokulturës, këngë kjo që i këndohet jo vetëm mjekut, por njeriut që le gjurmë në zemrat e njerëzve.

Ndaj dhe autori i librit H. Hysuka vlerëson se figura e Dr. Sali Kurtit del si simbol i përkushti-

mit, fisnikërisë dhe humanizmit matjan.

Veçanërisht të ndjeshme janë vargjet: *“Çdo pacient që ti kuron/ pasanik a hallexhi/ ti buzëqeshjen i dhuron/ të buzëqesh ai përgjithnji.”*. Këtu poeti dhe këngëtar i ngrejnë profesionin e mjekut në një mision njerëzor, ku dhembja shërohet me zemër po aq sa me dije. Edhe metafora: *“Zemër bardhë si mal me borë/ rrënjë e degë bleron si lis...”*, sipas shkrimtarit matjan Hamdi Hysuka e lidh figurën e doktorit me natyrën dhe karakterin e fortë të Matit, duke e bërë një portret të gjallë shqiptar. Mbyllja është urtësi që mbetet:



*“Njerëzit lindin edhe shuhen,
vetëm veprat mbeten gjallë.”*

Në këtë këngë dr. Sali Kurti nuk paraqitet thjesht si një mjek me bluzë të bardhë, por si një njeri që i jep dritë fytyrës së njerëzve dhe shpresë zemrave të tyre. Ai vjen si biri i sakrificës, që nga plagët e jetës ndërtoi urën e mirësisë për të tjerët. *“Në vargjet e Jorgo Papingjit, doktori shndërrohet në një figurë pothuaj legjendare: një lis matjan me rrënjë të thella në humanizëm dhe me degë që mbulojnë çdo njeri pa dallim. Kjo këngë nuk i këndohet vetëm mjeshtrit të stomatologjisë shqiptare, por njeriut që buzëqeshjen e ka mision. Ai nuk shëron vetëm dhëmbët, por edhe drojën, dhembjen dhe heshtjen e njerëzve. Prandaj poeti e sheh me ‘diell në sy, sepse drita e njeriut të mirë nuk shuhet nga koha’”,* shprehet shkrimtari Hysuka. Për të, *“Figura e Dr. Sali Kurtit mbetet si ato burimet*



malore që rrjedhin qetë e pastër: sa më shumë kalojnë vitet, aq më shumë njerëzit e kuptojnë vlerën e ujit të tyre. E tillë është edhe vepra e tij, e thjeshtë në pamje, por e madhe në shpirt. Ndaj kënga tingëllon si mirënjohje popullore, si një kurorë respekti që ia vendos zemra e njerëzve dhe jo vetëm profesioni. Sepse disa njerëz jetojnë gjatë në kujtesë jo nga fama, por nga mirësia që lanë pas. Dhe Dr. Sali Kurti është njëri prej tyre. Një figurë si Dr. Sali Kurti meriton fjalë që burojnë nga zemra, ashtu siç vetë ai ka lënë gjurmë në zemrat e njerëzve”.

Vilma Nika, një tjetër poete matjane erdhi në këtë promovim me këngën e saj *“Jam Matjan”*. Tekstin e kësaj poeteje të talentuar, me muzikë të Misol Fasës, e orkestruar nga Alfred Qemalja e solli mjaftë këndshëm për pjesëmarrësit në këtë promovim këngëtar i ri Marius Saliaj. Performanca e tij artistike spikati dukshëm veçanërisht në refrenin e këngës: *“Hej, hej/ Jam matjan/ Jam matjan njihem që moti/ gjak e besë, gjak e besë/ Gjak e besë prej kastrioti/ Babë e gjyshër ku m’jan rrit/ sofra mikun ku e ka prit...”*

Të larmishëm e bënë këtë aktivitet promovues edhe grupi i valleve të Pallatit të Kulturës “Sh. Doda” Burrel, si dhe Behar Neli që në meloditë e këndshme që ai luajti me bilbil dukej sikur ka zbritur gjithë eposi dhe historia e jetës baritore dhe rustike e indentitetit tonë që nga paganizmi deri më sot... Ndaj dhe Emi Krosi, e emocionuar shprehet se në këtë promovim të moderuar me mjeshtri artistike e talent të rrallë, me një elegancë gjuhësore dhe komunikim elekuent nga Defrim Methasani, fjalët, muzika dhe kujtimet u bashkuan si rrjedha të një lumi që derdhet në detin e kujtesës.



MIRËNJOHJA E PERSONAZHIT TË LIBRIT

Titullari i librit, Dr. Sali Kurti, me përvëlës, falenderoi përzemërsisht, të gjithë pjesëmarrësit pa përjashtim që ia bënë më të lumtur këtë ditë të shënuar të jetës së tij. Mirënjohje të veçantë ai shprehu për autorin Hamdi Hysuka që shkroi dhe botoi këtë libër duke skalitur mjeshhtërisht biografinë e tij, që nga lindja e deri këtu ku ka arritur, si themelues dhe drejtues i klinikës “Mat Dental”.

Respekt dhe mirënjohje shprehu dr. Saliu për deputetin Agron Malaj, për mbështetjen dhe vlerësimin që i ka dhënë kur ishte kryetar i bashkisë Mat. Po ashtu edhe për kryebashkiakun aktual, Altin Bojni, i cili së bashku me Agronin e kanë shndërruar Bashkinë në shtëpinë identitare të të gjithë qytetarëve autoktonë matjanë, por edhe e të gjithë atyre që ndajnë denjësisht me ta vlerat dhe parimet e një shoqërie të zhvilluar e mikpritëse, tolerante e të virtytshme, të përparuar në ide e të qëndrueshme në cilësi.

Dhe s’kish si të mos falenderonte dr. Saliu mi-kun tone të përbashkët, Mjeshtrin e Madh Defrim Methasani – ikonë e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv; - jo vetëm për moderimin me mjeshtri të rrallë artistike të këtij event, por për mbështetjen dhe promovimin që i ka bërë në vijimësi prej vitesh, në takime e salla moderne, në praninë e personaliteteve me rrezatim kombëtar. Ai sot, falë talentit të rrallë është bërë ndër

moderatorët më të preferuar, jo vetëm në Shqipëri por kudo në hapësirën mbarëshqiptare në botë. Dhe me këtë rast Dr. Saliu përulet me respekt dhe mirënjohje të thellë edhe për babain e tij, Shuaip Methasani – mishërues dhe përçues i urtësisë dhe mençurisë dibrane.

Pikërisht nga podiumi i këtij event, në cilësinë edhe të kryetarit të Federatës së Paqes Shqipëri, z. Defrim Methasani i propozoi kryetares së këshillit të Bashkisë Mat, Znj. Anila Stafhasani (e pranishme në promovim), që ky këshill të vendos emërtimin e rrugës për në fshatin Karicë me emrin e Dr. Sali Kurtit që ka bërë e bën aq shumë për Matin e matjanët, propozim ky që u duartrokit dhe gjeti mbështetjen e miratimin e të gjithë shkrimtarëve dhe artistëve nga Mati, Dibra, Kurbini e Lezha, të pranishëm në këtë event promovues.



Së fundmi, nga radha por jo nga rëndësia, Dr. Sali Kurti falenderoi përzemërsisht familjen e tij, bashkëshorten Ikbalen me të cilën së bashku, për pesë dekada jetë intensive bashkëshortore ia dolën të sfidojnë vështirësi të shumta, sa në Mat edhe në Tiranë për të krijuar një familje solide, vajzën Greta e djalin Erti, nipërit e mbesat e mrekullueshme që i falin për çdo ditë gëzim dhe lumturi të shumëfishtë. Kjo sipas tij për faktin e thjeshtë se pa mbështetjen e tyre do ta kishte të pamundur këtë rrugëtim të suksesshëm jetësor dhe profesional.

KRITIKA LETRARE

Fëmijëria dhe rinia e një vajze që nuk e gjeti kurrë lumturinë, në romanin “historia ime, por jo fundi im”

BUJANA MALAJ – PROFILI I SHKRIMTARES, HUMANISTES DHE MISIONARES SË PAQES



Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

- Dhjetra episodet e këtij libri volumioz me 545 faqe janë në të vërtetë një përmbajtje e pasur lëndore me një tematike mjaft të larmishme. Duke dëshmuar për jetën, autorja Bujana Malaj nxjerr nga pluhuri i harresës, momente, histori jetësore, detaje, njerëz, ngjarje, vende e hapësira, të cilat së bashku shpalosin botën tonë të brendshme dhe të jashtme.

Disa muaj më parë, në një veprimtari mbresëlënëse, Federata e Paqes Universale Shqipëri do të vlerësonte humanisten dhe misionaren e paqes Bujana Malaj me titullin “NJE-RIU I VITIT 2025”. Dhe jo vetëm kaq, shkrimtarja e mirënjohur, po atë ditë do të prezantonte kolanën me 11 librat e saj, nëntë vëllime me poezi, një roman dhe monografinë kushtuar ikonës së kinematografisë shqiptare, të papërsëritshmes Margarita Xhepa – kolanë kjo që do t’i surprizonte dhjetra personalitete akademike e të letrave, që kishin mbushur sallën “Alfred Mosiu” të këtij institucioni ndër më prestigjiozët në Shqipëri e rajonin e Ballkanit.

Befasia konsiston kryesisht te romani autentik i kësaj autoreje tashmë të sprovuar me titullin intrigues “HISTORIA IME, POR JO FUNDI

IM”. Nuk është rrëfim imagjinar por libri i jetës së bijës së një familjeje me tradita atdhetare, që vajzërinë ia vodhi regjimi dikatorial i para ’90-tës. Siç shkruan në parathënie (fq.11) “*ky është një libër i gjallë, i të vërtetave të pamohueshme, ku vetë protagonistja rrëfen jetën e saj, duke shkruar për episode të vështira, aq edhe të rrezikshme*”. Një libër ku rrëfhet jeta e gjashtëdhjetepesë vjeçares, që ka kaluar një kalvar tejet të mundimshëm.



Romani ka një histori të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në 545 faqe me dhjetra episode, ku rrëfohen mjeshtërisht ngjarje njerëzore me personazhe dhe situata reale, jo të trilluara. Është një vepër e gjatë dhe komplekse që tregon për ngjarje njerëzore të personazheve jetësore, kryesisht të një familjeje.

Lexuesi ka kështu në dorë librin e jetës së një vajze të ëndërrave të mëdha, që do të shndrohej në një “vajzë paksa rebele” (fq.25). Rebelizimin e saj ajo e përshkruan në mënyrë të letrarizuar kur rrëfen peripecitë e mosdhënies së një të drejte studimi, ngaqë vëllai i saj dënohet dhe vuan 10 vite burg politik.

Është ky, një rrëfim i çiltër i fëmijërisë së një personazhi që përmes vështirësish të shumta do të ecte e sigurtë në jetë, nga bankat e shkollës, në

martesën në Bellovë të Dibrës, Tiranë e gjer në vitet e mërgimit në Britaninë e Madhe.

DRAMACITETI LIRIKO-TRAGJIK NË LIBRIN E JETËS SË SHKRIMTARES BUJANA MALAJ

Bujana ishte vetëm 10 vjeçe kur gjithshka ndryshon rrjedhën e jetës së saj me burgosjen politike të vëllait të madh i cili në moshën e tij më të bukur dënohet dhe vuan 10 vite burg në burgun famë keq të Spaçit të Mirditës, kur ishte vetëm 22 vjeçar (sepse kërkoi demokraci të parakohëshme).

Teksa ajo kohë duhet të ishte pjesa më e lumtur e jetës së saj ajo kthehet në ferr, “sepse ishte fëmijëria dhe rinia e një vajze që nuk e gjeti kurrë lumturinë”, (fq.9). Gjithsesi, ajo nuk do t’i dorëzohet fatit, por ndoshta si askush tjetër i moshës së saj fëmijërore, nuk do të mposhtej, por do ta tregonte me forcën e dinjitetit rebelizimin e saj.



Dimensionin metaforik ajo e shfaq qoftë dhe në përshkrimin e takimit me ish sekretarin e Komitetit të Partisë të Tropojës, kur shkon ta takojë për të përfituar të drejtën e studimit. Dukshëm shfaqet ky në perifraximin e mëposhtëm: “Unë nuk i tregova për momentin se e kujt isha, sepse e dija që do më nxirrnin direkt nga zyra, por e zgjata duke i shtruar kërkesat e mia. Atij i bëri përshtypje se si një vajzë e mitur 14 vjeçe kishte ardhur vetëm. Sa mbaroi së shkruari përsëri më pyeti: -E kujt je? Atëhere u detyrova me sy të përplotur, por plot krenari të thashë:- jam vajza e filanit..Ai menjëherë më bërtiti e ofendoi me fjalët: Si guxon, ti vajza e një të deklasuari, të vish në Komitetin e Partisë?! “

Dhe sërish ajo, edhe pse e demoralizuar skajshëm vazhdon me rebelizimin e saj si shpërthim

i brendshëm. Kështu ajo përshkruan në librin e saj të jetës mes një antraksioni të një dramaciteti liriko-tragjik, rastin e e aventurës për të shkuar të takojë vëllanë në burgun e Spaçit, një rrugëtim i vështirë me një palë sandale që ja kishte blerë babai kur punonte në Fierzë.

“Ai vëlla vdiq shumë shpejt, pasi doli nga burgu. Por ende në veshët e mi tingëllon zëri çiftelisë në dhomën e burgut, kur e takova me lotët e një fëmije 15 vjeçare dhe më detyroi të kërcëja nën ritmet e çiftelisë, siç kërcëja kur isha e vogël (“O kce moj çike” që e kondonte nëpër dasma me zërin e tij prej bilbili. Dhe regjimi i dogji gjithçka kishte të inçizuar, në radio Kukësi e radio Tirana të asaj kohe, por zërin nuk ja dogjën dot, duke kënduar në burgun e Spaçit”, shkruan autorja. (fq.23).

Rrëfimin romanor, duke shtjelluar po përmes dramacitetit liriko-tragjik, ajo e përshfaq këndshëm edhe në aventurat për të vazhduar domosdoshmërisht shkollën e mesme, duke qëndruar te njerëzit e saj të afërt, në Tropojën e vjetër, me veshjen e saj ekstravagante, siç përshkruan dhe arrestimin e babait Avdi Rexha – misionar i pajtimit kombëtar, për ndërtimin e një shtëpie gjigante, kur ajo ishte në vitin e tretë..



MARTESA ‘MODERNE” BUJANËS

Ne romanin “*Historia ime, por jo fundi im*”, Bujana Malaj pasqyron me përpikmëri jetën dhe zakonet e Malësisë duke sjell një tablo të gjallë të një shoqërie tradicionale, ku nderi, besa dhe mikpritja janë parime themelore. Përmes zhvillimit të ngjarjeve, romani nxjerr në pah vlerat shoqërore dhe e pasqyron realitetin e trishtë të asaj kohe, kur me synimin për t’i shpëtuar përndjekjes “mërgon” brenda vendit, duke pranuar martesën me një djalë me biografi të mirë në Bellovë të Dibrës, 200 kilometra larg vendlindjes.



Këtu dallohet stili i thjeshtë, emocional dhe realist, shpesh me përdorim të folmes autoktone të Malësisë, që i jep veprës afërsi me jetën e njerëzve të këtyre trevave. Me gjuhë të thjeshtë, por figurshëm autorja përshkruan rrugëtimin rraskapitës të asaj kohe kur do të shkonte nuse me autobusin e linjës, nga “Bajram Curri” për në Milot e nga andej për në Peshkopi, ku “dasmorët” prisnin nusen e “bukur” që vinte nga Tropoja e largët.

“*U ndërrova me një fustan tjetër, që e kisha dizenuar vetë. Më hodhën një copë tyli të bardhë, që më shumë dukej si një perde dritaresh e asgjë tjetër. Asgjë nuk desha të dija, më rrinte parasysh fytyra e mërzhitur e nanës time, që më përcolli duke më larë me lotët e saj.*”, shkruan autorja, fq.34). Gjithsesi ajo rrëfen se si e ndërtoi me mund e sakrificë jetën familjare në fshatin e bukur Bellovë, një fshat i bukur, i mbledhur, me shumë traditë e mikpritje, që veçohet për rritjen e pjekjen e mollëve në sobat me dru, ku aroma e mollëve përhapet anë e kënd lagjes.

KALVARI I VITEVE TË MËRGIMIT, BRENDA E JASHTË VENDIT

Dhjetra episodet e këtij libri volumioz me 545 faqe janë në të vërtetë një përmbajtje e pasur lëndore me një tematikë mjaft të larmishme. Duke dëshmuar për jetën, autorja Bujana Malaj nxjerr nga pluhuri i harresës, momente, histori jetësore, detaje, njerëz, ngjarje, vende e hapësira, të cilat së bashku shpalosin botën tonë të brendshme dhe të jashtme. Kështu ajo rrëfen se si në vitin 1990 me ardhjen e pluralizmit në Shqipëri, meqë ishin tregtarë të “fshehtë” të kohës, hapën bizneset e para të vogla në Peshkopi.

Ajo përshkruan shumë ngjarje të dhimshme, por lexuesit do t’i mbetet në mendje data 1 dhjetor 1993, kur mori rrugën e gjatë me taksitë e tragjet, në pikun e dimrit të acartë për të vajtur në funeralin e kobshëm të nënës së saj.

Brenda këtyre episodeve dallojmë stilin e një shkrimtareje me frazë të zgjedhur e gjuhë të pasur, duke e bërë kështu mjaft tërheqës librin e saj. Në “fronin e shkrimit”, Bujana Malaj ka arritur kështu ta skalitë fjalën e shkruar dhe ta vendosë atë në pedestalin e afirmimit të vlerave ideoartistike, si shkruese, ndër më të mirat të një monografie letrare. E ndeshim këtë sidomos në episodet me titujt: “*Pas katër vitesh martesë*”, “*Vitet ‘90-të*”, “*Ishte marsi i atij viti*”, “*Nisja e katërmbëdhjetë me tragjet, në portin e Durrësit*”, “*Kthimi i detyruar në Vlorë*”, “*Dita e tretë e gatitjes për nisje*”, “*Udhëtimet e atij prilli vazhduan gjatë*”, “*Maji 1999, Çertejll, Paris*”, “*Vera e vitit 2008 në Londër*” dhe në ditarët sipas viteve deri në fundin e vitit 2024 dhe nisjen e vitit 2025 të çerekshekullit të XXI-të.

Qoftë dhe nga vetë titujt e këtyre episodeve, lexuesi kupton rrugëtimin e gjatë e të mundimshëm të një gruaje të fortë për të mbritur nga Dibra në Tiranë e nga andej me gomone nëpër detëra për të siguruar një jetë më të mirë për familjen e saj.

Ka në këtë roman autentik momente tronditëse që zbulojnë anët e errëta të rrugëve të mërgimit, pasigurinë, rezikun dhe dhimbjen që fshihet pas ëndrrës për një jetë më të mirë. Autorja sjell kështu një reflektim të thellë mbi fatin e rinisë shqiptare që e ka kërkuar shpëtimin jashtë kufijve, por shpesh është ndeshur me tragjedi e zhgënjim. Përshkruan ajo trajektoren e



rrezikshme të jetës së saj deri në qershor të vitit 1999 kur arritën në Londër bashkë me dy fëmijët dhe të tretin fëmijë e lë “peng” në Ostendë të Belgjikës për 1mijë dollarë që nuk i kishte për të plotësuar pagesën e udhëtimit në maune, të fshehur nëpërmes bandave trafikante të kohës që trafikonin qenie njerzore.

Po ashtu edhe faktin se si mbas tre javësh arrin dhe djali 14 vjeçar “pengu i mërgimit” dhe bashkohet me tre fëmijët. Dhe sesi mbas tre muajsh të tjerë vjen dhe bashkëshorti i saj që nuk ishte i mundur për arsye të ndryshme të ishte pranë familjes në udhëtimin e gjatë tre mujor, e kësajsoj familja bashkohet në Britaninë e Madhe.

Gjithsesi ky kalvar i tejmundimshëm që kaloi gjatë këtij udhëtimi të gjatë është i pamundur të harrohet. Janë ngjarje dhe episode që kanë lënë gjurmë në jetën e saj, sidomos fillimi i një jete të re, kur në vitin 2000 ju shtua familjes së saj edhe një fëmijë tjetër, i cili do të ishte vendimtar për tu paisur me dokumente angleze nëpërmes një amnistie të vitit 2005. Dhe që nga ai vit i largët, ajo është qytetare e dy shtetësive, ku një pjesë të mirë të kohës e kalon në Tiranë e vendlindje, si frymëzuese të krijimtarisë së saj poetike e prozaikë mjaftë produtive e cilësore, e konkretizuar kjo në botimin e 11 librave me poezi e prozë.

Ndërkohë me veprimtari intensive, Bujana Malaj ka fituar edhe statusin e një veprimtareje të shquar shoqërore, si aktiviste e Shoqërisë Civile, ajo është anëtare dhe drejtuese e disa shoqatave dhe agjencive: Ambasadore e Paqes,, Misionare dhje kalorëse e paqes botërore; Nënkrjetare e Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar, etj. Gjithsesi, ajo që e dallon atë është krijimtaria letrare e artistike. Veçanërisht, romani autentik “*Historia ime, por jo fundi im*” (botim i “Arte-Graphic”) është një rrëfim i çiltër i një personazhi që përmes vështirësish të shumta do të ecte e sigurtë në jetë..

Në episodet e tij dallojmë stilin e një shkrimtareje me frazë të zgjedhur e gjuhë të pasur, duke e bërë kështu mjaftë tërheqës librin e saj. Brendia e librit përshkohet me pasqyrimin e mendimit e të vlerave krijuese, për çfarë dëshmon edhe thënia latine “Fjala ikën, e shkrimi mbetet”.

Këtë domosdoshmëri autorja B.Malaj e ka spikatur në fillim të librit, si moto filozofike dhe këshillë për ata që pretendojnë krijimtari të kësaj lëmie, duke na lënë si testament fjale se: “*Harresa, për këdo është shpërblimi më vrapar për mundin e kaq shumë viteve dhe sakrificat e sfidat e përditshme, të cilat ikin e vijnë në valët e jetës sonë*”.

LETRAT

BËLBËZIMA

(ose... Njeriu pushon së qeni plotësisht njeri kur flet pa kuptuar çfarë thotë...)



Tregim nga Fatmir Terziu

Ende bëlbëzonte. Mjekët e ndiqnin me vëmendje monitorin. Pesë vjet kishte qëndruar në koma. Pesë vjet mes jetës dhe mungesës së saj. Kishte hyrë në atë gjendje gjatë një nate vere, në kulmin e një dashurie që atëherë dukej e përjetshme. Askush nuk kishte gjetur një shpjegim të saktë. Trupi i saj ishte zgjuar. Gjuha jo. Ajo nxirrte tinguj të copëzuar, rrokje pa adresë, fragmente që nuk arrinin të bëheshin fjalë.

- Ba... ba... lë... zë...

Një neurolog i ri po mbante shënime.

- Truri po rindërton qendrat e gjuhës, - tha ai.

Por profesori më i vjetër i ekipit nuk foli. Po e vështronte vajzën si të ishte një nga enigmat më të mëdha të profesionit të tij. Sikur të ishte thjesht vetëm pyetje dhe jo një paciente. Ai e vështronte dhe mendonte kështu, sepse në mendje i vinte teoria, se njeriu nuk zgjohet vetëm me zemër. As vetëm me mushkëri. Njeriu zgjohet kur zgjohet gjuha. Dhe çfarë është gjuha? Ajo që na lejon të emërtojmë botën? Apo ajo që na lejon të mos humbasim brenda saj? Në raftin e bibliotekës së spitalit ndodhej ende Humboldt. Më tej Heidegger. Më tej qindra libra të tjerë që flisnin për gjuhën sikur ajo të ishte një mjet. Por ndoshta gjuha nuk është mjet. Ndoshta është shtëpia ku banon vetë njeriu. Dhe atëherë pyetja nuk ishte pse vajza kishte rënë në koma. Pyetja ishte e kuptueshme. A kishte rënë vallë bota në koma

shumë kohë përpara saj?

Jashtë spitalit njerëzit flisnin më shumë se kurrë. Miliona mesazhe. Miliona komente. Miliona deklarata. Por gjithnjë e më pak kuptim. Fjalët qarkullonin me shpejtësinë e dritës dhe vdisnin para se të mbërrinin te tjetri. Bota nuk vuante nga heshtja. Vuante nga tepria e zhurmës. Një mëngjes vajza hapi sytë dhe shqiptoi qartë një fjalë të vetme: - Dëgjo...

Mjekët u afruan. Familjarët shpërthyen në lot. Por ajo nuk tha asgjë tjetër. Vetëm përsëriti: - Dëgjo... Dukej, sikur të kishte sjellë nga thellësitë e komës një lajm që askush nuk donte ta dëgjon-te. Profesori mendonte. Eh, si është kjo punë, eh. Plotë enigma. Mos ndoshta kriza e madhe e njeriut nuk është se nuk flet. As se nuk di të flasë. Kriza e tij fillon në çastin kur ai harron të dëgjojë. Dhe atëherë gjuha nuk bëhet më urë. Bëhet bëlbëzim. Një bëlbëzim kolektiv që e quan veten qytetërim. Profesori u ngrit ngadalë nga karrigia.

Në ekranet e monitorëve vijonin të vallëzonin ritmet e zemrës, valët cerebrale, treguesit e frymëmarrjes. Gjithçka që shkenca mund të maste ishte aty. Por ajo që sapo kishte ndodhur nuk mund të matej.

- Dëgjo... - pëshpëriti përsëri vajza.

Pastaj heshti. Në atë heshtje, profesori kujtoi një fjali të vjetër që e kishte shoqëruar për dekada. Njeriu flet. Flet zgjuar, flet në ëndërr, flet edhe kur hesht. Flet kur lexon, kur dëgjon, kur mendon. Flet sepse gjuha nuk është një mjet që e përdor sipas dëshirës. Ajo është mënyra se si ai banon në botë. Në fund të fundit, nuk është njeriu ai që zotëron gjuhën. Ndoshta është gjuha që zotëron njeriun.

Pesë vjet në koma nuk ia kishin marrë vajzës jetën. As kujtesën. As fytyrën. Por i kishin rrënuar urën që e lidhte me botën e të tjerëve. Dhe vetëm tani, mes bëlbëzimave, ajo po e rindërton-

te atë urë gur pas guri, tingull pas tingulli. Mjekët vazhdonin të kërkonin shkakun e komës. Një hemorragji e fshehtë. Një anomali neurologjike. Një reagim i rrallë biologjik. Ndoshta.

Por profesori kishte filluar të dyshonte se pyetja e vërtetë nuk ishte pse kishte rënë në koma ajo vajzë. Pyetja ishte pse kishin rënë në koma kaq shumë fjalë. Ishte, edhe sepse njerëzit flisnin pa pushim. Ekranet gumëzhinin ditë e natë. Fjalët shumoheshin si insekte në verë. Premtime, akuzat, slogane, deklarata, betime, mallkime. Megjithatë, sa më shumë fletej, aq më pak thuhej.

Dukej sikur gjuha të ishte mbushur me tinguj dhe të ishte zbratur nga kuptimi. Eilhelm von Humboldt kishte shkruar se njeriu është njeri sepse flet. Por ndoshta shekulli ynë po zbulonte diçka edhe më të frikshme. Njeriu pushon së qeni plotësisht njeri kur flet pa kuptuar çfarë thotë.

Vajza hapi sytë. Vështroi dritaren. Përtej saj, qielli i pasdites shtrihej i qetë mbi qytet. Buzët i drodhën lehtë.

- Dëgjo... Vetëm kaq. Dhe profesori e kuptoi se ndoshta fjala e parë e njeriut nuk kishte qenë një emër, as një urdhër, as një lutje. Ndoshta kishte qenë pikërisht kjo kërkesë e thjeshtë, pra: Dëgjo. Pastaj pa diku në thellësi të sallës. Kjo ndoshta ndodh sepse gjuha nuk lind kur ne flasim. Ajo lind kur dikush tjetër është i gatshëm të dëgjojë. Dhe aty ku askush nuk dëgjon më, fjalët nuk janë më gjuhë. Janë vetëm bëlbëzima...

...Janë vetëm bëlbëzima. Profesori nuk lëvizi për disa çaste. Pastaj iu afrua dritares. Në rrugë njerëzit kalonin me telefonat në duar. Flisnin. Shkruanin. Lexonin. Reagonin. Komunikonin më shumë se çdo brez para tyre. Megjithatë, sa më shumë e vështronte botën, aq më tepër i dukej se ajo po humbiste diçka thelbësore. E dinte se gjuha i përket afërsisë më të afërt të qenies së njeriut. Njeriu e gjen atë kudo. Në fjalën e parë të fëmijës. Në britmën e lindjes. Në heshtjen e dashurisë. Në testamentin e të vdekurit. Në lutje. Në poezi. Në urdhër. Në pendesë. Ajo është më pranë nesh sesa vetë lëkura jonë. Megjithatë, pikërisht për këtë arsye, ne rrallë e ndjejmë. Ashtu si peshku nuk e ndjen ujin ku noton, edhe njeriu rrallë e ndjen gjuhën ku jeton. Ai e përdor atë për të emërtuar gjërat, por harron se para se të emërtojë botën, gjuha e ka emërtuar atë vetë.

Para se ai të flasë për ekzistencën, është gjuha ajo që i ka dhënë një vend brenda ekzistencës.

Prandaj reflektimi përpiket të gjejë thelbin e gjuhës. Ta shpjegojë. Ta përkufizojë. Ta vendosë brenda një formule. Të ndërtojë një ide universale për atë që është. Por ndoshta gjuha i shpëton çdo përkufizimi përfundimtar. Fundja, ajo nuk është vetëm një objekt që mund të shqyrtohet. Ajo është vetë hapësira ku ndodh shqyrtimi. Nuk është thjesht një mjet i mendimit. Ajo është banesa e mendimit. Nuk është vetëm mënyra se si njeriu shpreh atë që është. Ajo është mënyra se si njeriu bëhet ajo që është.

Dhe vajza që sapo ishte zgjuar nga koma dukej sikur e kishte prekur këtë të vërtetë në skajin më të brishtë të saj. Për pesë vjet kishte qenë larg botës së fjalëve. Jo larg tingujve. Jo larg zërave. Por larg asaj mrekullie të padukshme që i lidh tingujt me kuptimin. Tani ajo po kthehej në gjuhë, sepse jeta biologjike kishte qenë aty gjatë gjithë kohës. Ajo që po rilindte ishte pjesëmarrja e saj në botën e përbashkët të kuptimit. Në botën ku një fjalë mund të bëhet premtim, ku një emër mund të bëhet kujtim, ku një fjali mund të bëhet histori, ku një pyetje mund të ndryshojë fatin e një njeriu.

Profesori e pa edhe një herë. Ajo buzëqeshi lehtë. Një buzëqeshje e vogël, thuajse e papërfillshme. Pastaj lëvizi buzët. Askush nuk e kuptoi çfarë tha. Ndoshta nuk tha asgjë. Ndoshta ishte ende një bëlbëzim. Por për herë të parë atij bëlbëzimi nuk iu duk si mangësi. Iu duk si fillim. Sepse ndoshta çdo e vërtetë e madhe fillon si bëlbëzim. Çdo poezi. Çdo dashuri. Çdo qytetërim. Çdo përpjekje e njeriut për të kuptuar veten. Dhe ndoshta vetë njerëzimi nuk është gjë tjetër veçse një bëlbëzim i gjatë mijëravjeçar, me të cilin qenia përpiket të thotë diçka për veten e saj. Prandaj pyetja nuk është nëse flasim. Ne flasim gjithmonë. Pyetja është nëse, mes pafundësisë së fjalëve tona, arrijmë ende të dëgjojmë atë që gjuha përpiket të na thotë për qenien. Kjo, - pëshpëriti me vete, Profesori, - në fund të fundit, njeriu nuk banon mbi tokë vetëm me trupin e tij. Ai banon në gjuhë. Dhe kur gjuha humbet kuptimin, edhe bota fillon të humbasë banesën e saj.

@followers
Fatmir Terziu

LETRAT

GURI I SHALËS

Tregim



Nga Sakip Cami

Kalosh Camaj kishte ditë që s’kishte dalë nga shtëpia, nga kulla e vet me tre pode e tridhjetë frengji – dritare. E kulla don bukë, don dru zjarri, don rezerva ushqimore për vehte dhe për mikun. E këto janë harxhuar së tepërmi saqë po troket uria. Nuk mjafton kjo, por vendin e ka pushtuar një hasëm i largët nga stepat e Ruisë dhe të Bullgarisë . Janë dyndur në tokat tona se u kanë pëlqyer shumë. E si të mos pëlqesh tokat e Luginës së Drinit, pjellore e të begata si asnjë tokë tjetër.

Po ç’kërkojnë sllavët në tokat tona? Flet me vehte dhe nëpër dhëmbë Kalosh Camaj dhe ngrihet në kambë drejt derës së kullës. Një bubullimë e madhe është ndjerë farë afër kullës. Një shkrepimë rrufeje e ka shoqëruar atë. Dera e randë e kullës hapet me rropamë. Dimri është në muajin e gjashtë. Nuk del dimri pa i mbushur ditët e veta në këto vise që njohin vetëm dy stinë, verën dhe dimrin. Kërcurin më të madh vendasit e ruajnë për ditën e shëngjergjit më 6 maj.

-Ku ke ndërmend të shkosh në këtë të ftohtë, or burrë, e pyet e shoqja, një grua fisnike nga një derë e shquar.

-Në mal, oj grua, te pylli ynë, të shoh një herë se ç’bëhet dhe të marr një kalë dru se edhe këto të plasmë dru janë mbaruar.

-Pylli asht mbushur me ushtarë të huaj, or burrë. Kërkojnë Mitron, ushtarin që vrave ti,

te pylli ynë. Ma tha edhe Dilja, se asaj i kishte thanë burri i vet.

-Ma baj gati doriun, atë bëj ti, i shfryu të shoqes Kalosh Camaj dhe doli me vrik nga kulla.

Bejazja nuk ja kishte ba dysh kurrë fjalën burrit, doli dhe bani gati kalin e kuq, që i ndriste qimja nga bukuria dhe shëndeti. Malësori edhe vetë rri pa bukë dhe tagjinë kalit nuk ja heq, se kali për malsorin asht jetë, asht punë, asht para’, asht besë, asht burrëri, asht gëzim, asht krenari.

Doriu sikur ta kuptonte se do të dilte me të zot, hingëlliu gjithë gëzim. Kishte ditë të tana pa dalur nga shtëpia dhe, edhe ai po e ndiente se diçka nuk po shkonte mirë me të zotin e tij. Si gjithmonë u përkul për të ja ba sa ma të lehtë të zotit të tij për ta shaluar e për tu nisur për udhë. Kaloshi ngjeshi një kamë të mprehtë në brez, mori edhe hutën e vjetër që kishte trashëguar nga gjyshi dhe u nis. Udha ishte e gjatë, pylli i pafund, hallet e mendimet ishin ba mullar. Por një kalë i mirë e di se ku do ta çojë të zotin e tij edhe pa folur me njëri tjetrin. Kur arritën te Përroi i Mitros kali hingëlliu si për t’ja kujtuar Kaloshit se deri këtu kishin ardhur atë ditë...

Kaloshi nuk bëzan e kali ngjitet monopati, aty ku kishin ngarkuar dru zjarri herën e kaluar dhe u kishte dalur përpara ai ushtar i huaj. Këtu Kaloshi erdhi në vehte .

-Këtu na solle prapë, o dori’ ? pyeti pa e kuptuar as vetë se po fliste me kalin dhe ju fanit ajo ngjarje që u përhap në të gjithë krahinën dhe shkoi deri në Sofie e Moskov.

... Ushtari i huaj ishte ngarkuar për të prerë dru për pushtuesit e dyndur dhe kishte zanë vend te përroi i pyllit të Kaloshit. I pari e pa doriu dhe si gjithmonë kur shikonte gjëra të panjohura, hingëlliu, si për t’ja kujtuar të zot se

dikush i huaj kishte shkelur në pyllin e tij. Kaloshi hodhi sytë atje ku dëgjohej sopata e ushtarit të huaj. Sopata nuk ndalej dhe Kaloshi ndjeu se kjo sopatë po priste qafën e tij, qafën që zgjatej poshtë kokës e qëndronte për të lidhur trurin me zemrën e tij. Por truri dhe zemra, që të dyja nuk ju bindën. Ç’është ky ushtar i huaj që ka shkelur trojet tona dhe po pret dru në zabelin tim, shfryu në çast Kaloshi dhe ju drejtua atij: “Çfarë kërkon o i paudhë në pyjet e mia ? “

Ushtari u tremb në fillim nga kjo thirrje e papritur, por shpejt e mori vehten.

-Këto vise tani janë tonat dhe ju duhet të na bindeni ne, o njeri i këtyre maleve. Në doni të kalojmë në paqe së bashku, binduni, në të kundërt do t’ju zhdukim.

Kaloshit ju ngrit damari i djathtë i qafës, pikërisht ai damar që furnizon trurin me gjak dhe mendoi me vehte se këtu qenka fundi për ty o ushtar i huaj dhe më pas të bëhet edhe hataja. Nxorri me vërtik kamën që mbante në brez dhe sa hap e mbyll sytë ja nguli në zverk, pikërisht te ai damar që të shkakton vdekjen. Ushtari i huaj u rrëzua menjëherë në tokë, zgurdulloi sytë duke mermëritur në gjuhën e tij.

-Mërmërit, mërmërit sa të duash o ushtar i huaj, çfarë kërkoje, atë gjete në Shqipëri, thirrte fort Kalosh Camaj. Preke po deshe pyllin tim, preke, do t’ju ther siç ther dashin për dasëm. Shporruni në viset e juaja !

...Kaloshi u lëkund paksa nga tronditja e kalit që kalonte në një monopat dhe erdhi në vehte. Te çadrat, dori’, te çadrat, i foli kalit. Çadrat ishin pak më tej. Atë pyll e kishte bërë natyra si ombrellë dhe njerëzit i thonin në dialektin e tyre, çadrat.

Kali u ndal edhe një herë te çadrat. Kaloshi hodhi sytë edhe një herë rreth e qark pyllit të çadrave. Gjynah i madh të presësh lisat në këtë pyll të bukur e të pafund, mendoi. Zoti e ka qëndisur këtë mrekulli të natyrës. Këtu te pylli i çadrave nuk të lagte shiu dhe nuk e shikoje as dëborën kur binte.

-Te fushat e gjata, dori, te fushat e gjata, i foli kalit, Kaloshi. Dhe doriu që ja kishte mësuar

edhe fjalët të zotit u nis drejt Fushava të gjata.

Fushat e gjata ishin një vrap pele larg. Vazhdonin pyjet e Kaloshit dhe të fisit të tij. Ai kujdesej për pyjet e tij ashtu si edhe për fëmijët. Kali ecte me trokth. Kaloshi kishte dredhur një cigare dhe ashtu shaluar mendonte që të mbaronte punë sa më shpejt dhe të kthehej në kullë, ku e prisnin fëmijët e tij. Papritmas kali ndaloi. Kaloshi e nguci në vithe për të ecur më tej. Kali turfulloi dhe ktheu kokën drejt të zot, sikur t’i thoshte:”O zoti im, shiko përqark dhe më pas më nguc, më nguc dhe po deshe edhe më vra, por shiko njëherë përqark. Kaloshi e kuptoi që doriu e kishte një hall që ndaloi sepse ai nuk ndalonte kurrë pa shkak. Vështroi përqark dhe pa shumë ushtarë të huaj. Ata ishin shumë, shumë, ishin mbushur shkurret plot me ushtarë. Ata pritnin atë për t’u hakmarrë për Mitron, shokun e tyre, të cilin Kaloshi e kishte vvarë te përroi i pyllit të tij. Hafijet kishin shkuar te kampi i të huajve dhe kishin spiunuar se Mitron e kishte vvarë Kaloshi.

Eh, mendoi Kaloshi, edhe më tha gruaja, mos dil nga shtëpia sot, or burrë, por exhelit dhe hasmit nuk i ruhesh dot kurrë.

Ushtarët e huaj e sulmuan Kaloshin me shpata, kama, e huta. Kaloshi u rrëzua nga kali, i goditur për vdekje. Doriu ishte jo vetëm dëshmitar, por edhe luftëtar. Ai nuk mund të qëndronte sehixhi kur dushmani po i vriste të zot. U sul drejt tyre me shkelma, goditi disa prej tyre. Ushtarët e huaj gjuajtën drejt tyre me huta dhe me shigjeta. Shigjetat e helmatisura ju ngulën në bark, por doriu mbështolli me këmbët e para të zot dhe e ruante atë nga sulmet e të huajve. Nga sytë i dilnin lotë si breshër.

Pasi dhanë shpirt që të dy, Kaloshi dhe doriu, armiqtë u larguan. Bora filloi të binte me struplla. Shkëmbi ku zunë vend doriu dhe Kaloshi ngriu nga akulli dhe nuk shkriu as në verë. Nuk shkriu asnjëherë dhe u shndrrua në një shalë kali.

Kanë kaluar shekuj dhe njerëzit i thonë brez pas brezi Guri i shalës...

LETRAT

TRIPTIK



Poezi nga Emmy Krosi
Poete & prozatore & analiste e letërsisë

IMAZH I NGROHTË NËNE...

Nëna ime vdiq e re
e re fare,
vetëm njëzeteshtatë vjeçe
me rroba të zeza dhe shami të bardhë
në kokën e saj flokzezë,
se ca tipare të saj
i mbaj unë në stinët e mia,
prej rrudhave që saora formohen
dhe të ngrohtë i'a mbaj trupin në grushtin tim
nga banesa hyjnore,
në dhomën e saj futem majëgishtave,
se ajo fle aty përherë
aq qetë
aq sa kam frikë t'a zgjoj,
se në degët e hurmës
në oborr
e gjithë përkora e saj gurgullon
nuk dua t'a zgjoj...
t'a zgjoj...
t'a zgjoj...
pas dyzetepesë vitesh
t'a marr përdore drejt qiejve
të hapur si balonë
se e mugët gjithmonë
ka qenë mungesa e nënës
si një tingull zanor qiellnor
kumbon zëri i saj
një aleluja...aleluja e pafundme!

04. 12. 2021

TRIPTIK

Çdo ditë kopsat e fatit i këpus si sumbulla të
gjelbra
se pema ime e dashurisë
më shveshi nga çdo lumturi
dhe unë braktisa zjarrin
në trupin tim si kërthi të vogël...

* * *

tani,
vetëm ti
ma gris gëzimin
në sy
se kam një zemër të derdhur,
në akuarelin tërësisht gri..

* * *

dashuria epet gjithherë pa çmim
dhe kur na braktisin çdo ditë
si grim koralesh pa ngjyrë
janë të befta
trishtimet e gjelbra,
me miliona pikla lumturie.

20. 05. 2023.

RRËFIMI I NJË PROSTITUTE!

1.

...dhe hijet e natës,
janë muzgje frike,
kurse udhët e saj,
kufoma të pista,
si drunj vegjetativë,
me njolla të murrme hënore...

2.

Trishtimin kam pirë në kupa,
në humbutirat e kohës,
topolake e dehur,
në mejhane të tynta,

me burra të huaj,
zhulsa,
mjekërparruar,
erëdjersë,
të palarë,
mëkatarë,
drogaxhinj,
mjeranë,
brinjar,
vejanë
qelbashë erëpeshk,
me kanoçe birrash,
erëshurrë,
në kthina të ndyra,
qoshe nudo bythëjashtë,
unë joshësja e dehur,
sa mijëra burra kanë hyrë,
dhe dalë brenda meje...!

3.

E lodhur nga ikja,
në planet me identitet klounësh,
hënashurdhe,
dhe detëraqorre,
symbyllur plazheve,
të shterpëta,
vetëm me këmbëzogj pelikanë,
guacka barërash mbi duna rërash,
kam varur brekët tylzi,
me njolla të ndyra spermash,
vitheve me kanë peneluar vitet!
Bordello të pista!

4.

Në urata pa bekime,
protokollet e qirinjve,
që villnin mbi barkun tim,
të çjerrë,
(pa)urime,
prej gjysheje,
prej motre,
prej nipash,
kurse... ardhmëria,
po priste një pikëlimë shiu,
në rrathët e ferrit,
aktet tribush,
që pallojnë ethshëm,
në shëmtinë e tyre mëkatore,

pa gjykim.
Doja një tunel nëntokësor,
deri në Had,
drejtin ta përqafoja lumturisht,
kurse Luçiferin ta dashuroja, marrëzisht!
...mrekulli,
nuk u bëra nënë!

5.

...ndoshta mitra ime,
me plaçenta farërash të huaja,
zbrazi gjoksin tim bosh,
nga ‘mëkati’ i një fëmije,
se shumë burra,
dështakë shurraqë,
të dehur netëve dimërore,
gjurmuan ëndërrat e tyre,
në gremina e thellësive të mia,
pa dritëhije!
Në shpella të vdekura ku gjumi,
s’ka litarë ëndërrash,
që rrokullohet,
hollohet,
pengohet në honet,
e shalëve të mia mëkatore,
e zhveshur,
e hirshme,
e mistershshme,
e ftohtë,
në mërmërima epshesh,
marrësi e shturur,
me shkronja pendimi,
vagabondë kurvarë,
‘u rrëzuan’ të përçartur ,
mbi nënbarkun tim ngjyrëgjak,
se njollat e turpit,
asnjë sapllak nuk i lan,
as me gjak,
e as me ujë!

6.

Qyteteve të ndyra,
Londra,
Parisi
Madridi,
Athina,
Milano,
Tirana,

Berlini dhe Nju Jorku,
unë kurva moderne,
me ID numërhumbur,
pa rregullaloje,
kam ikur dhe prapkthim,
duke kunguar shumëherë,
shpirtin në Danup,
Gang apo Senë,
kur paudhësitë i kam qafuar,
krahëruar,
mbytur në ujin e qelbur të Lanës,
me jashtëqitje ardhacakësh,
kurse brenda vaginës sime,
të gjithë lumenjt e botës,
u përmyten,
gjersa mbeten stalagmite,
me lëkurë qimesh burrash anonimë!

7.

Pikojnë mëngjeset,
në agun yllnor krejt të ftohtë,
në shpirtin e vetmuar,
me shenja cigaresh,
nëpër kofshë,
dhe buzët e tharta,
me gëlbara të qelbura puthjesh,
me aromë alkoli,
lëkurërudhur,
gjiçvarë,
vrapova pas hijes,
së rinisë time në arkëmort,
se lakuriqësia ime,
tingujve të muzgjeve u gris,
pa nënkresa zgjimesh,
zgafellave të humbura,
ku shkëmbinjve okër,
ujëvarat eshtra shkumash,
kanë skalitur,
tango shirash të ngrohta verore.
Tani jam fishkur.
Me njolla në trup,
“tradhëtova” parajsën,
time të virgjër,
në turmat e aeroporteve,
apo trenave të fundnatës,
me përfaqime udhëtarësh të panjohur,
në altare fronash,
perëndish të egra,
hapat e mia askush nuk i njohu!

Me tallën,
më qeshën,
më përçudnuan,
hamejtë e fjalës së thinjur,
tejpërtej kurrizeve të pasqyrave,
kur qesha me veten time,
me ‘protokolle’ të ngarkuara pritjesh.

8.

...dhe thashë do vijë një ditë,
një ditë,
kur do çelë
orkideja ime...
...por përsëri,
mbeta imoraliste,
me ëndërra cigane...
Tani jam lulethinjur,
lëkurërudhur,
petaleplakur.
Vetëm,
epitafi i pasvdekjes,
do të shkruhet:
këtu prehet një prostitutë!

9.

Vetëm,
mua,
askush nuk më dashuroi,
se thuhet: – “kush dashuron,
plagët dhe dhimbjen tënde”,
– të dashuron VËRTETË!

17. 08. 2020.

FUSTANI I BASMËS

Gruaja me çadër të kuqe
hapin derdhur n’erë,
mbi një tabelë reklame
një këngë dashurie pëshpërit mbi buzë
me fustane të pupurta Evash
mbi gjethet e gjiçve të vonë
me takimet
ritakimet me fustanin e ri
të qepur primitivisht,
me tingullin e lugëve në tavolinën e varfër
të pëshpërimave të pashkëve

pa vezë
 pa kryq kungimi,
 se thjesht lavdia e guximit të vajzave
 me fustane basme,
 plot fushina lulësh
 me xhufka
 në ujëvara stinësh
 nënsqetullat krejt djersë ngarkuar me misër,
 me copëra eternale të papërsëritshme qiejsh
 ...dhe shumësia e ditëve
 si tophëne mbi pus varur hija
 e tregtarit të basma me xixëllonja,
 gërsheta yjesh që picirrojnë sytë
 se veli i vajzërisë një dritë e pafundme
 kur luajnë cinglash
 petash, shtëpiash
 kërcej(j)ashtë
 tëhollin fustanin e basmës
 të qepur me dorë,
 gjithherë i larë me sapun dhe finjë
 si kujtim i dalëboje,
 në vitet që kohërat ngushtohen
 ngushtohen deri në grisje.

05.06. 2023.

* * *

Njeriu i shiut
 me çizme të zeza,
 farat e lagështa shkund nga kapuçi
 kërrusur mbi polenat e panjës
 në parkun bosh
 dhe gri,
 se burri i shiut u zhduk,
 dhe parku
 dhe panja
 pas xhamit,
 vizatojnë një gisht pa unazë
 se dhe aroma jote formon
 prefiksën e puthjes pa(a)dresë.

28. 05. 2023.

* * *

Përmatanë,
 përmatanë,
 buzëana në zëdritë
 bishtnon erën si feniks i tharë,
 përmatanë,
 përmatanë,
 deti muzgjeve me suka shkulumash buzëqesh

kur retë thinjen ndër krahë avionësh,
 përmatanë,
 përmatanë,
 zemra si mbërtheckë në drithërima fjalësh
 skuqet,
 përmatanë,
 përmatanë,
 çdo dhimbje është himn
 çdo kumt
 është britmë e mjegullës së bardhë të valëlotit të
 tokës,
 përmatanë
 përmatanë...

06.2023.

* * *

Kam veshur kujtimet me lyrë,
 dhe një numër telefoni i vyshkur,
 që nga koha e largët,
 më zgjon buzëqeshjet,
 ku hiret imtësohen nën vezullimet e qullëta të
 xixëllonjave,
 ku gjithnjë pas derës time,
 beftas,
 një palë atlete burri,
 që presin ikjen pa rikthim...

26. 04. 2023.

* * *

A do më rrëfesh sonte
 për të fshehtë të mëkatit si darka e fundit e
 Jezuit,
 se çdo dashuri
 është e trishtë,
 çdo eposh është i pistë,
 ti...
 kush je ti
 që derdh e mbledh
 rrëfimet mbi eshtrat e mëkatit,
 kur josh me puthje lëngshege,
 dhe pas seksit
 mashkulli yt fle
 dhe femra
 rrokullis sytë
 në tavanet e natës,
 më duaj
 të duan,
 s'më do
 më d...

14. 02. 2023.

REÇENSION

ARTI I ANALIZAVE KRITIKE TË HALIL RAMËS



Prof. dr. Eshref Ymeri

“Kritika kërkon shumë më tepër formim kulturor, sesa krijimtaria”

Oskar Uaild



Në analizat e H.Ramës bie në sy studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive letrare, me pikësnyimin për të evidentuar tiparet e tyre artistike, estetike dhe ideologjike.

Mjeshtri i penës, Halil Rama, njihet si një analist veprash të gjinive të ndryshme. Libri i tij i 27-të “40 vepra letrare të 40 autorëve në ‘skaner’”, është një kaleidoskop idesh, përsiatjesh, faktesh. Janë 40 vepra të gjinive të ndryshme, të 40 autorëve, duke filluar nga vepra biografike e një autoreje amerikane, kushtuar jetës politike dhe artistike të ish-presidentit amerikan Ronald Reagan (Ronald Reagan -1911-2004), dhe duke vazhduar me krijimtarinë e autorëve tanë, të pasqyruar në prozë artistike, në poezi, në letërsi dokumentare, në diplomaci dhe në monografi.

Duke pasur parasysh këndvështrimet mjeshtërore të Halil Ramës, i cili ka një përvojë

mjaft të pasur në fushën e kritikës letrare, lexuesi vëren se aparati i artit të këtij kritiku të talentuar shoqërohet nga tri të dhëna për autorët e veprave që ai analizon:

Së pari, autorët përthithin përshtypjet që kanë nga mjediset që i rrethojnë. Ato përshtypje, si në një fokus, grumbullohen në vetëdijen e tyre. Nga mijëra copëza vëzhgimesh, të shpërndara në hapësirat jetësore, vjen e krijohet diçka e tërësishme. Nga mijëra tiparesh të veçanta, të zbuluara në figurën e njerëzve që hasin në përditshmërinë e tyre dhe që ata i regjistrojnë në kujtesën e vet, vjen e krijohet një tip-pesonazh me vlera përgjithësuese. Nga mijëra pikësnyimesh që ata perceptojnë gjatë endjes së tyre në vorbullat e kohës, vjen e lind një pikësnyim tipik.

Së dyti, emocionet, faktet dhe mendimet e perceptuara, autorët i shndërrojnë në materie të artit.

Së treti, produkti i krijimtarisë së autorëve kthehet mbrapsht po në atë mjedis, prej nga qe vjelë, domethënë te lexuesi.

Çfarë bën kritika e Mjeshtrit të Madh Halil Rama

Ta perceptosh artin e kritikës, është po aq e vështirë, sa edhe ta krijosh atë. Çfarë bën kritika e Mjeshtrit të Madh Halil Rama dhe çfarë duhet të vazhdojë të bëjë ajo në këtë proces?

Me këtë pyetje, lexuesi i kësaj vepre zberthen detyrën e rëndësishme dhe të domosdoshme që ai i ka shtruar vetes: Kritika e tij shërben si shkollë për lexuesit dhe për autorët, ajo shërben si një universitet, si një enciklopedi, me pikësnyimin që ta ngrejë nivelin kulturor të të dyja palëve.

Qëllimi kryesor i analizave të Halil Ramës është vlerësimi i argumentuar i veprave letrare dhe përqendrimi i vëmendjes së lexuesit në kuptimin dhe vlerën e tyre.

Analiza e strukturës dhe e përmbajtjes së veprave është njëri nga parimet themelore të punës së tij hulumtuese, të konkretizuar në trajtimin e hollësishëm të përmbajtjes dhe të ideve të tyre.

Ai e përqendron vëmendjen te elementet e kompozicionit, te zhvillimi i subjektit, te karakteri i heronjve, te stili i rrëfimitarisë dhe te aspekte të tjera, të cilat ushtrojnë ndikim mbi mbresat e përgjithshme të veprave.

Duke u ndalur në tiparet artistike të veprave, autori i ka shtruar vetes detyrën për të nxjerrë në pah dhe për të vlerësuar rolin e tyre edukativ në masën e lexuesve. Ai analizon gjuhën dhe stilin e veprave, aftësinë e autorëve të tyre për të krijuar figura të goditura artistike dhe për të shprehur mendime tejet të qëlluara.

Në këtë punim me vlera enciklopedike, autori Halil Rama u tërheq vëmendjen lexuesve te analiza kontekstuale. Gjatë vlerësimit të veprave të autorëve të ndryshëm, ai ka parasysh kontekstin e zhvillimit të ngjarjeve. Ai studion rrethanat, në të cilat veprat qenë krijuar, veprat e mëparshme të disa prej autorëve, rëndësinë e tyre historike dhe sociale për vlerësimin sidomos të periudhës së diktaturës komuniste dhe të ca dukurive të rënda të periudhës neokomuniste, që pati nisur me vendosjen e demoshëmtisë dhjetoriste. Me analizat kontekstuale, Halil Rama i ndihmon lexuesit të kuptojnë edhe më mirë se çfarë roli luajnë veprat artistike në letërsi dhe në shoqëri.

Diçka tjetër që bie në sy në penën e Halil Ramës, është objektiviteti, një parim ky shumë i rëndësishëm në punën e kritikut letrar. Këtu ai ka parasysh një orientim të përgjithshëm: kritiku duhet ta vlerësojë një vepër artistike, pavarësisht nga parapëlqimet e veta subjektive dhe duhet të marrë parasysh këndvështrimin e lexuesve të ndryshëm; me këtë rast, ai ka të drejtë të shprehë këndvështrimin e vet subjektiv, por ai duhet ta argumentojë bindshëm pozicionin e vet, duke marrë parasysh edhe normat shoqërore dhe kulturore. Pra, në këtë libër, puna e kritikut Halil Rama, mbështetet në analizën, vlerësimin dhe interpretimin e veprave të 40 autorëve, me qëllim që t’u vijë në ndihmë lexuesve të zbërthejnë thelbin e përmbajtjes së tyre.

Studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive

Në analizat e autorit bie në sy studimi sistematik i veprave të të gjitha gjinive letrare, me pikësynimin për të evidentuar tiparet e tyre artistike, estetike dhe ideologjike. Gjatë anal-


izave, ai u është përmbajtur disa metodave të ndryshme origjinale, të cilat po i rendisim në vijim:

Së pari, metoda historike. Me këtë metodë nënkuptohet studimi i veprave në kontekstin e kohës dhe të rrethanave kur janë krijuar. Aty analizohen faktorë historikë dhe kulturorë, të cilët kanë ndikuar mbi autorët në krijimin e veprave në fjalë.

Së dyti, metoda strukturore. Analiza strukturore bazohet në studimin e organizimit dhe të kompozimit të veprave, analizohen elementet strukturore, të tilla, si subjekti, personazhet, gjuha dhe stili, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se si bashkëveprojnë dhe formojnë një të tërë.

Së treti, metoda tematike. Gjatë përdorimit të metodës tematike, autori këtu analizon temat dhe idetë themelore të krejt korpusit të veprave të 40 krijuesve. Përmes kësaj metode, ai ka hulumtuar se si krijuesit në fjalë i kanë trajtuar probleme, çështje dhe koncepte të caktuara dhe se si i kanë lidhur me idenë e përgjithshme të secilës vepër.

Së katërti, metoda psikologjike. Me analizën psikologjike të veprave në fjalë, Halil Rama hedh dritë mbi botën e brendshme të personazheve dhe ecurinë e zhvillimit të tyre psikologjik. Ai ka analizuar motivet dhe komponentët emocionalë të veprave, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se si krijuesit i kanë përcjellë ato përmes personazheve të tyre.





Së shtati, metoda filozofike. Analizën filozofike autori e orienton drejt studimit të ideve filozofike që janë të pranishme në veprat e hulumtuara. Në analizat e tij ai ndalet në çështje fundamentale të të kuptuarit e jetës, të moralit dhe të aspekteve të tjera me rëndësi parësore.

Kjo vepër studimore në fushën e kritikës së veprave në disa gjini letrare, mund të vlerësohet pa asnjë mëdyshje si

Së pesti, metoda sociologjike. Me këtë metodë nënkuptohet përfshirja e aspekteve sociale, ekonomike dhe politike, të cilat janë pasqyruar në veprat e të gjithë krijuesve. Autori e ka vënë theksin te pasqyrimi nga ana e tyre i problemeve, normave dhe vlerave shoqërore.

Së gjashti, metoda krahasuese. Me analizat krahasuese në penën e Halil Ramës nënkuptohet ballafaqimi i veprës së një autori me veprat e tjera ose krahasimi i aspekteve të ndryshme të së njëjtës vepër. Kjo e ndihmon atë të hulumtojë edhe më thellë karakteristikat e veprave të analizuar dhe të zbulojë ngjashmëritë dhe dallimet me tyre.


një dialog mes autorëve dhe lexuesve, ku kritiku Halil Rama shfaqet në rolin e ndërmjetësit që jep një ndihmë tejet të çmuar për të kuptuar dhe interpretuar veprat e kaq shumë autorëve.

Në këtë vepër përvijohet si ide kryesore tema “shkrimtari-kritikulexuesi”, ku detyra e kritikut është sa e mprehtë, aq edhe e rëndësishme. Kjo detyrë ka vetëm një zgjidhje: kritiku e ngre lart edhe kulturën e shkrimtarit, edhe kulturën e lexuesit.

Kur e mbaron së lexuari këtë vepër voluminoze, lexuesit i lind një pyetje e vetvetishme:

Si ka qenë e mundur që autori ka përballuar një punë kaq të madhe për përgatitjen e kësaj vepre të vëllimshme? Çfarë e ka ndihmuar? Shkalla e lartë e arsimimit, horizonti i gjerë kulturor, dëshira, fisnikëria e shpirtit, dashamirësia ndaj krijuesve të talentuar? Sigurisht që këto të gjitha kanë luajtur rolin e tyre të pazëvendësueshëm. Por ka edhe diçka tjetër, shumë të rëndësishme, që zbulohet në përgjigjen e pyetjes së mësipërme. Përgjigjen e ka pas dhënë Presidenti i 30 (1923-1929) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Xhon Kalvin Kulixh (John Calvin Coolidge Jr.-1872-1933), i cili ka thënë:

“Në këtë botë, asgjë nuk mund ta zëvendësojë vullnetin e fortë, këmbënguljen. As gjeniu, gjeniu pa famë dhe i pashpërblyer sështë asgjë. As talenti, asgjë nuk haset më shpesh sesa talenti i dështuar. As arsimimi, bota është plotë me njerëz të arsimuar që janë të braktisur. Vullneti i fortë në arritjen e qëllimit—ja kjo është mrekullia vetë”.



KRYEREDAKTORI

HALIL RAMA

- Ka lindur në Muhurr, Dibër më 28 Tetor 1960.
- Nga 1996 jeton dhe punon në Tiranë.
- Është diplomuar në Jurisprudencë (Bachelor dhe Master Shkencor) dhe pasi ka kryer edhe Shkollën Kombëtare të Avokatisë me rezultate shumë të mira, ka fituar titullin “Avokat” me Nr.Liçense 7979, datë 31.10.2014.





Ka punuar:

- Përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës Muhurr (1980-1981) pasi kreu Kursin e Regjistrës pranë Shtëpisë Qëndrore të Krijimtarisë Popullore, Tiranë (1979);
- Punonjës Socialkulturore në Minierën e Mermerit Muhurr (1985-1988);
- Metodist kulture në Shtëpinë e Oficerëve Bulqizë (1989-1991);
- Shef i Administratës në Këshillin e Rrethit Bulqizë (1992-1997);
- Shef i Sektorit të Marrëdhënive me Publikun të Bashkisë Kamëz dhe Kryeredaktor i gazetës “Kamza” (2010-2012); Specialist në Sektorin e Koordinimit të Marrëdhënive me Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, ku ka fituar Statusin e Nëpunësit Civil (2012-2020 e në vazhdim).
- Fillimet në gazetarinë e shkruar i ka që nga viti 1977 si bashkëpunëtor i gazetës lokale “Ushtima e Maleve” dhe i gazetave qëndrore “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, “Puna” dhe “Luftëtar”.
- Është kryeredaktor i gazetave periodike: “BULQIZA” (1992-1996 dhe nga 2014 e në vazhdim) dhe “VETERANI” (nga 2003 e në vazhdim).
- Nga 2010 boton në vijimësi opinione, dossier, kritikë letrare dhe reportazhe në të përditshmet: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf”, “Koha jonë”, “Dita” dhe “Standard” e në të përjavshmen kulturore-artistike “NACIONAL”.
- Është autor i 30 librave (monografi & refleksione & reportazhe & poezi dhe tregime & kritikë letrare), si dhe redaktor i mëse 30 librave të autorëve të njohur.
- Halil Rama është i martuar me Znj.Kimete Rama (Berisha) dhe ka dy djem, Bledarin dhe Arlindin.

Halil Rama mban titujt:

- “Mjeshtër i Madh”, dhënë nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11723, datë 17.09.2020;
- “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Bulqizë, me vendimin e këshillit të kësaj bashkie nr.. 52, datë 31.07.2024;
- Ambasador i paqes, dhënë nga Federata e Paqes Universale Shqipëri;
- Akademik, dhënë nga Akademia Shqiptaro-amerikane e Shkencave dhe Arteve.





**AAAS ME SELI EDHE NË
PEJË NË “SHTËPINË E
BARDHË”
TË SHABAN GASHIT**



**KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT - LIDER NË
ARSIMIN PROFESIONAL**

Poliklinika - "Mat Dental"

Buzëqesh sic ke ëndërruar

+355 69 44 57 000

info@matdental.com

www.matdental.com

Rruga e Elbasanit, pranë Degës së Thesarit , Tirana, Albania

